



PASKAL MILO

**FUNDI
I NJË
PADREJTËSIE**

949.65
M76

PASKAL MILO

FUNDI
I NJË
PADREJTËSIE

(Rreth çështjes së pranimit të Shqipërisë
në OKB)



SHTËPIA BOTUESE «8 NENTORI»

P A R A T H

Shqipëria doli nga Lufta në një pozitë të qartë e të kombëtare. Por, këtë pozitë ligjshme u përpoqën të tërmetet e Bashkuara të Amerikës dhe të Evropës së Madhe. Ish-aleatët e kohës luftë armiqtë më të betuarë të popullit shqiptar. Ata e detyruan qytetin dhe shtetin tonë që, pavarësisht nga lufta, të po aq antishqiptarë sa në Luftën Botërore.

Qeveria angleze dhe franceze kohësh e ndiqnin me vëmendje ngjarjeve në Shqipëri, në çështje nacionallirimitare, forcat politike të tyre. Për politikën amerikane ndaj Shqipërisë në Luftën Botërore karakterin e saj antishqiptar është evidentuar në tërësi në shokut Enver Hoxha «Enver Hoxha për Shqipërinë», përbërësi i kësaj madh me rëndësi politike të luftës dhe demaskimin e veprave të tyre.

I E N I E

ta e Dytë Botërore me
ë padiskutueshme ndër-
zitë dhe të drejtat e saj
i vinin në dyshim Shte-
rikës dhe Britania e
ës së luftës u bënë pas
ar e më të egër të popu-
ndësuan veprimtarinë e
maskat e deklaratat, ishte
gjatë Luftës së Dytë

qeveria amerikane prej
vëmendje zhvillimin e
Luftën Antifashiste Na-
politike dhe raportin e
kane dhe sidomos angle-
ftën e Dytë Botërore, për
ptar është shkruar edhe
gjitha aspektet. Vepra e
Rreziku anglo-amerikan
një kontribut shumë të
e dhe historike për njoh-
veprimtarisë armiqësore të

SHBA-së e të Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë në vitet e Luftës së Dytë Botërore e mbas saj. Nga fundi i luftës për anglo-amerikanët po bëhej gjithnjë e më e qartë se Partia Komuniste e Shqipërisë dhe Ushtria Nacionalçlirimtare ishin të vetmet forca politike e ushtarake që zotëronin situatën në vend. Forcat e tjera politike e ushtarake siç ishin ato ballisto-zogiste qenë kthyer në bashkëpunatore të pushtesit dhe nuk kishin asnjë kredi politike apo ndonjë pozitë të qëndrueshme e shpresëdhënëse.

Në këto rrethana qeveritë e SHBA-së e të Britanisë së Madhe, nga njëra anë, u detyruan të hynin në lidhje me pushtetin e ri popullor, që u vendos në vend dhe, nga ana tjetër, u angazhuan me forca, mjete e mënyra të ndryshme për ta rrëzuar këtë pushtet. Kjo strategji imperialiste kishte dy aspekte të saj: të brendshmin dhe të jashtëmin. Brenda vendit synohej që të përkraheshin mbeturinat e reaksionit, të cilat ishin në luftë kundër pushtetit popullor me armë, me sabotime dhe me propagandë. Jashtë vendit, Shqipërisë i rezervohesh një perde e hekurt, një mohim i plotë i të drejtave të saj të ligjshme, me qëllim që ajo të mos njihesh, por të mbetej e vecuar e në mëshirën e anglo-amerikanëve. Që në ditët e para të Çlirimit Shqipërisë iu dësh të përballonte këtë strategji imperialiste, që po manifestohej në forma të ndryshme.

Por politika e SHBA-së dhe e Britanisë së Madhe për izolimin ndërkombëtar të Shqipërisë dështoi, ashtu siç mori fund e gjithë strategjia e tyre antishqiptare. Kur analizohen shkaqet e këtij dështimi nuk ka si të mos vihet në plan të parë lufta e vendosur e popullit shqiptar, të udhëhequr me guxim e urtësi nga Partia.

«...ne, — thekson shoku Enver Hoxha, —

ishim faktori themelor dhe garancia numër një që do të mbronim, siç i mbrojtëm, të drejtat tona të ligjshme kombëtare dhe të drejtat në arenën ndërkombëtare. Faktorët e tjerë që shpreheshin në favorin tonë, sidomos ata të jashtëm, kishin vlerën e faktorit ndihmës, mbështetës».*

Në vitet e para të Çlirimit Shqipëria u mbështet edhe në ndihmën e Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga J. V. Stalini, të vendeve të demokracisë popullore dhe të forcave revolucionare e përparimtare. Duke përcaktuar rolin e faktorit të jashtëm në forcimin e pushtetit popullor në Shqipëri e të pozitës së saj në arenën ndërkombëtare në atë kohë, shoku Enver Hoxha nënvizon se «në radhë të parë, këtë faktor ne e shihnim dhe e gjenim te politika e drejtë dhe internacionaliste e Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Stalini, e shihnim te politika e jashtëme staliniane, e cila... u vu edhe në mbrojtjen e çështjes sonë të drejtë. Përfaqësuesit e Stalinit e përkrahën Shqipërinë e re dhe rendin e demokracisë popullore që ne po vendosnim; ata në të njëjtën kohë demaskonin përpjekjet e reaksionit ndërkombëtar, kërcënimet dhe përpjekjet e tyre për të ndërhyrë në punët tona të brendshme ose për të mohuar e për të marrë nëpër këmbë të drejtat tona».**

Shqipëria nuk e ka mohuar këtë ndihmë e përkrahje në atë masë që i është dhënë, ajo e ka vlerësuar si shprehje të qëndrimit internacionalist, të ndihmës reciproke e pa interes që karakterizonte marrëdhëniet midis vendeve socialiste.

Është sa antihistorik as edhe keqdashës absolutizimi që i bëhet sot kësaj ndihme e përkrahje në literaturën politike e historike revizioniste. Historiografia revizioniste sovjetike nuk

* Enver Hoxha. «Titistët, (Shënime historike),» f. 209.

** Po aty.

është ndalur posaçërisht në studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Shqipërisë në vitet e para të pasluftës, por në shumë botime i ka trajtuar ato pjesërisht. Në këto raste ajo çdo sukses e fitore të Shqipërisë në forcimin e pozitive të veta ndërkombëtare ia ka detyruar vetëm e vetëm përkrahjes së Bashkimit Sovjetik.

Shtrembërime të mëdha dhe gjykime pa asnjë fije të vërtete gjen edhe në literaturën politike e historike revizioniste jugosllave si dhe në memualet e disa prej ish — përfaqësuesve zyrtarë të Jugosllavisë në atë kohë. Trajtimi i çështjes është i një natyre të tillë që kërkon të krijojë opinionin se Shqipëria rronte e merrte frymë në saje të Jugosllavisë! Vërtet kërkesa për pranimin e Shqipërisë në OKB u paraqit për herë të parë nga qeveria jugosllave, përfaqësuesit e së cilës në këtë organizatë dhe në konferenca të ndryshme ndërkombëtare dilnin «në mbrojtje» të të drejtave të vendit tonë, por titistët «... nuk mbronin Shqipërinë si shtet të lirë e sovran, por mbronin ato troje, që në planet e tyre të fshehta, përbënin qubernën jugore të «shtetit të madh» shumëkombësh e shumëpopujsh jugosllav të ëndërruar prej shekujsh».* Historia ka dëshmi të pamohueshme e të pashlyeshme për karakterin e «ndihmës» jugosllave për Shqipërinë. Vepra madhore e shokut Enver Hoxha «Titistët», përmban një material të gjallë faktik e analiza të thella shkencore që pasqyrojnë me vërtetësi synimet hegjemoniste dhe gllabëruese të PKJ e të Jugosllavisë ndaj PKSH e Shqipërisë në vitet 1944-1948.

Edhe literatura historike borgjeze, në trajtimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore, jep shembullin e munge-

* Enver Hoxha, «Titistët (Shënime historike)», f. 214.

sës së objektivitetit e të seriozitetit shkencor. Në shumicën e rasteve ajo ka huazuar si burime «dokumentare» disa botime tepër tendencioze e komerciale, që nuk kanë asgjë të përbashkët me të vërtetën. Triumfin e revolucionit popullor dhe ekzistencën e Shqipërisë së lirë e sovranë kjo literaturë nuk i shikon si një proces objektiv, që e kishte zanafillën dhe bazën në luftën dhe përpjekjet e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë, por si një rastësi, si një «gabim» të diplomacisë anglo-amerikane, që «nuk i kushtoi vëmendjen e duhur problemit shqiptar në atë kohë».

Dokumentet anglo-amerikane të luftës e të pasluftës për Shqipërinë janë një dëshmi që i përgënjeshtrojnë fare mirë këto përfundime të historiografisë borgjeze. Këto dokumente, në masën që kanë parë dritën e botimit, provojnë se çështja shqiptare jo vetëm që nuk ka qenë e panjohur për Departamentin e Shtetit e Forin Ofisin, por është ndjekur hap pas hapi gjatë luftës e pas saj. Nëse diplomacia e Londrës dhe e Uashingtonit dështoi në Shqipëri, shkaqet nuk duhen kërkuar në të ashtuquajturin nënvleftësim të çështjes shqiptare në atë kohë nga ana e qeverive të SHBA-së e të Britanisë së Madhe. Ajo nuk pati sukses sepse në Shqipëri, për herë të parë në historinë e saj, fatet e atdheut i kishte marrë në duar populli, që nën udhëheqjen e Partisë Komuniste arriti të mbrojë interesat e vendit, të sfidojë çdo përpjekje që u bë nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm për të penguar zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit popullor në rrugën e socializmit.

Forcimi i pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë, pas Luftës së Dytë Botërore, është i lidhur me disa probleme, shumica e të cilave tashmë i takojnë historisë. Çështja e pranimit të Shqipë-

risë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara është një nga aspektet e luftës që ka bërë Partia dhe Qeveria jonë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Britanisë së Madhe për afirmimin e të drejtave dhe forcimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore. Duke e gjykuar e duke e vendosur këtë çështje në kuar-
drin e saj historik, vlerat dhe rëndësia e saj pa-
dysim që nuk janë të vogla.

Në këtë punim bëhen përpjekje për ta stu-
diuar problemin në tërësi, duke e paraqitur ecu-
rinë e tij nga fillimi deri në fund.

H Y R J E

Dy herë në shekullin e 20-të, dhe në të dy rastet në përfundim të luftërave të përbotshme, janë krijuar organizata ndërkombëtare, ku janë përfaqësuar një shumicë e madhe shtetesh. Pas Luftës së Parë Botërore nisi jetën Lidhja e Kombeve, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Lidhja e Kombeve ishte pjellë e diplomacisë së Antantës, që përbënte, siç shprehej Lenini, «një grup bishash grabitqare që vetëm hahen me njëra-tjetrën dhe nuk i zënë besë aspak njëra-tjetrës»*. Zyrtarisht ajo u krijua si një organizatë ndërkombëtare, ku do të bashkërendoheshin përpjekjet e të gjitha shteteve anëtare për ruajtjen e paqes e sigurimin e popujve. Në fakt, për iniciatorët e krijimit të këtij organizmi fasada zyrtare përfaqësonte maskën prapa së cilës fshihej qëllimi i vërtetë: shndërrimi i Lidhjes së Kombeve në një instrument për të realizuar sundimin e kësaj apo të asaj fuqie imperialiste, për të shtypur dhe për të luftuar lëvizjen revolucionare e nacionalçlirimtare që kishte marrë hov.

* V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 185.

Lidhja e Kombeve, e manipuluar nga Britania e Madhe dhe Franca, shpejt degjeneroi në një organizëm pa jetë, që jo vetëm nuk përmbushi misionin për të cilin ishte krijuar, por u la dorë të lirë shteteve fashiste të shpërthenin Luftën e Dytë Botërore.

Shqipëria ishte anëtare e Lidhjes së Kombeve që në vitin 1920. Pranimi i saj në këtë organizatë u bë në një kohë kur fuqitë imperialiste dhe shtetet shoviniste fqinj e vinin në dyshim ekzistencën e shtetit shqiptar dhe thurnin plane për copëtimin e tij. Tanimë për historinë e primit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve është shkruar.¹ Megjithëqë ky akt në vetvete shënonte në atë kohë forcimin e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë, duhet thënë se anëtarësia e saj në këtë organizatë nuk e shpëtoi nga ndërhyrja dhe sundimi i kapitalit të huaj e sidomos nga pushimi italian i prillit 1939.

Përkundrazi, ndaj agresionit fashist kundër Shqipërisë, (akt ky në kundërshtim të hapët me parimet dhe qëllimet e saj), Lidhja e Kombeve nuk e ngriti fare zërin. Edhe kur Bashkimi Sovjetik shtroi para Lidhjes së Kombeve kërkesën për të vënë në rend të ditës shqyrtimin e agresionit të Italisë ndaj Shqipërisë, shtetet perëndimore nuk pranuan. Nuk kishte veçse disa muaj që politika e tyre e «mosndërhyrjes» ishte kurorëzuar me marrëveshjen e Munihut, e cila shërbeu si nxitja më e hapët që iu dha shteteve fashiste për shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Me fillimin e luftës Lidhja e Kombeve mori fund si vetë sistemi i Versajës që e krijoi.

Kur Lufta e Dytë Botërore ishte në kulmin e saj, lindi përsëri ideja për të krijuar një organizatë të re ndërkombëtare. Por rrethanat tashmë ndryshonin nga ato të Luftës së Parë Botë-

rore. Në qoftë se Lufta e Parë kishte për të gjitha palët karakter imperialist, Lufta e Dytë dallonte në këtë drejtim. Për Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të pushtuara nga fashizmi lufta kishte karakter të drejtë, çlirimtar. Popujt tanë ishin ngritur me vetëdije për fitoren e lirisë dhe shpartallimin e fashizmit. Nevoja për bashkimin e forcave në luftë kundër armikut të përbashkët shërbeu si nismë për të përpunuar mendimin për një organizatë të re ndërkombëtare. SHBA-ja dhe Britania e Madhe nxiqan ta bënin të tyren këtë ide.

Më 14 gusht 1941 midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Britanisë së Madhe u nënshkrua Karta e Atlantikut, në të cilën morën pjesë pak më vonë Bashkimi Sovjetik e një numër vendesh të tjera të Evropës. Ndonëse nuk përmbante ende ndonjë ide të qartë për krijimin e një organizate ndërkombëtare në periudhën e pasluftës, Karta theksonte disa parime të përgjithshme, të cilat zunë vend më vonë në Kartën e OKB-së.²

Ngjarja e parë që ka të bëjë me historinë e Kombeve të Bashkuara është «Deklarata e Kombeve të Bashkuara». Ajo u miratua më 1 janar 1942 në Uashington dhe nënshkruesit e saj të parë ishin përfaqësuesit e 26 kombeve që luftonin kundër shteteve të boshtit fashist. Deklarata i angazhonte ata në mobilizimin e të gjitha burimeve ekonomike e ushtarake kundër anëtarëve të paktit tripalësh Gjermani-Itali-Japoni dhe satelitëve të tyre.³ Të drejtën e aderimit në këtë deklaratë e kishin të gjithë ata popuj që luftonin kundër fashizmit. Kështu më vonë përveç 26 nënshkruesve të parë, në të aderuan edhe 21 vende të tjera.

Nënshkrues të kësaj deklarate ishin edhe

SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik dhe Anglia. Qëndrimi i tyre ndaj deklaratës dhe angazhimeve para saj ndryshonte. SHBA-ja dhe Britania e Madhe niseshin nga interesa e synime që ndryshonin rrënjësisht nga ato të Bashkimit Sovjetik e të popujve të tjerë antifashistë. Ato u detyruan të hynin në luftë pasi dështoi politika e tyre e «mosndërhyrjes», kur nazizmi gjerman, në kundërshtim me planet e Uashingtonit e të Londrës, ndezi zjarrin e luftës jo vetëm në Lindje, por edhe në Perëndim. Agresioni frontal i bllokut fashist u bë një rrezik i drejtpërdrejtë edhe për SHBA-në e Britaninë e Madhe. Në të njëjtën kohë, duke marrë pjesë në anën e forcave antifashiste, këto dy shtete ruanin edhe aparenecat «demokratike» dhe investonin një kredi të madhe politike për të ndërhyrë pas luftës në «rregullimin» e botës. Në fakt SHBA-ja dhe Anglia bënë shumë pak për të vënë në jetë parimet që u fiksuan në «Deklaratën e Kombeve të Bashkuara», çka ishte karakteristikë për diplomacinë e këtyre dy shteteve gjatë gjithë Luftës së Dytë Botërore.

Ideja e krijimit të një forumi ndërkombëtar kombesh të pasluftës për herë të parë u konkretizua në deklaratën e katër fuqive mbi sigurimin kolektiv, që u nënshkrua më 30 tetor 1943 në Moskë. Sipas kësaj deklarate, në një datë sa më të afërt do të krijohet «një organizatë e përgjithshme ndërkombëtare, e mbështetur mbi parimet e barazisë sovrane të të gjitha shteteve anëtare paqedashëse. Anëtarë të saj mund të ishin të gjitha ato shtete të mëdha e të vogla që do të punonin për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar».⁴ Po për këtë qëllim në deklaratën e miratuar nga Konferenca e Teheranit, më 2 dhjetor 1943, thuhej: «Ne do t'i bëjmë thirrje bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive të të gjii-

tha vendeve, të mëdha ose të vogla, popujt e të cuave, sikunder edhe popujt tanë, i kushtohen me gjithë zemër dhe vullnetin e tyre zhdukjes së tiranisë dhe skllavërisë, shtypjes dhe intolerancës. Ne do t'i pranojmë porsa të vendosin të bashkohen me ne në gjurin e familjes botërore të kombeve demokratikë».⁵

Vetëm në fund të verës së vitit 1944 u hodh hapi i parë praktik drejt krijimit të një organizate të përgjithshme ndërkombëtare. Ai është i lidhur me bisedimet e Dumbarton Oksit, lokalitet në afërsi të Uashingtonit, të cilat u zhvilluan në dy faza: faza e parë nga 21 gushti deri në 28 shtator, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të SHBA-së, të Bashkimit Sovjetik dhe të Britanisë së Madhe. Faza e dytë nga 29 shtatori deri më 7 tetor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të SHBA-së të Britanisë së Madhe dhe të Kinës. Si rezultat i këtyre bisedimeve u miratua dokumenti me emrin «Propozime lidhur me krijimin e një organizate të përgjithshme ndërkombëtare».⁶ Aty u hartua, në vija të përgjithshme, projekti i Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, qëllimet dhe parimet mbi bazën e të cilave ajo do të ngrihej. Gjithashtu u përcaktuan edhe organet kryesore të organizatës, përbërja, funksionet dhe të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme, të Këshillit të Sigurimit, të Gjykatës Ndërkombëtare si dhe procedura e tyre.

Në rrugën e krijimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara një vend të veçantë zë edhe Konferenca e Jaltës dhe marrëveshja e nënshkruar aty midis Bashkimit Sovjetik, SHBA dhe Britanisë së Madhe në shkurtin e vitit 1945. Në këtë konferencë u vendos përfundimisht që të krijohet një organizatë e përgjithshme ndërkombëtare për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit. Fuqitë e mëdha

të Koalicionit Antifashist vendosën që më 25 prill 1945 në San-Francisko të SHBA-së të thirrej Konferenca e Kombeve të Bashkuara për të përgatitur Kartën e kësaj organizate sipas parimeve të propozuara në bisedimet jozyrtare të Dumbarton Oksit⁷. Ato u morën vesh edhe për krijimin e Gjykatës Ndërkombëtare, për natyrën dhe kompetencat e saj si dhe për mënyrën e votimit në Këshillin e Sigurimit.

Organizata e Kombeve të Bashkuara po krijohej në rrethana që ndryshonin nga ato në të cilat u krijua Lidhja e Kombeve. Edhe çështja e pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë organizatë shtrohej në kushte të reja. Në dallim nga Lufta e Parë Botërore, në të cilën Shqipëria si shtet nuk mori pjesë, edhe pse u shndërrua në fushë betejesh midis palëve ndërluftuese, në Luftën e Dytë Botërore ajo ishte një pjesëmarrëse aktive e Koalicionit Antifashist Botëror të popujve. Për herë të parë Shqipëria ishte plotësisht e çliruar dhe e pavarur nga ndërhyrja dhe tutela e fuqive të mëdha imperialiste. Por mbi të gjitha Shqipëria kishte tani një udhëheqje politike të sigurt e të aftë, Partinë Komuniste.

KAPITULLI I PARË

KËRKESA E QEVERISË DEMOKRATIKE PËR PRANIMIN E SHQIPËRISË NË OKB NË SESIONIN E PARË TË ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë në mbarim të Luftës së Dytë Botërore

Shqipëria ishte një nga pjesëtarët e Koalicionit të madh Antifashist Botëror të popujve. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar ishte njohur e vlerësuar edhe nga fuqitë e mëdha të këtij Koalicioni.

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore ngriti një varg problemesh për shumë vende e rajone të Evropës, duke përfshirë këtu edhe Ballkanin. Ende pa mbaruar lufta, vendet ballkanike si Jugosllavia, Greqia, Bullgaria e Rumania, për arsye të ndryshme, ishin bërë objekt diskutimi në takimet e konferencat e tri fuqive të mëdha,

ashtu siç u bënë më vonë edhe në Potsdam. Shqipëria në këto mbledhje nuk u bë objekt i veçantë diskutimi dhe asnjë problem në lidhje me të nuk u ngrit. Ky fakt kurrësi nuk duhet interpretuar ashtu siç kërkojnë ta paraqesin disa historianë perëndimorë, kryesisht anglezë e amerikanë, si nënvleftësim nga ana e tyre i faktorit shqiptar. E vërteta është se Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar ndiqej nga afër prej Uashingtonit e Londrës. Ato, siç pohon një ish-anëtar i misionit ushtarak amerikan në Shqipëri, «kishin një interes aktiv në qëndresën shqiptare kundër forcave të Boshtit...»⁸ Dokumentet angleze dhe amerikane të kohës së luftës e mbas saj dëshmojnë se çështja shqiptare në kuadrin ballkanik ishte e dorës së parë për Forin Ofisin dhe Departamentin e Shtetit. «Shqipëria, — shkruan për atë kohë historiani anglez Uatson, — megjithëse një vend i vogël ishte një çelës potencial i problemeve të mëdha»⁹. Pretendimi se anglo-amerikanët nuk e kuptuan apo e nënvleftësuan çështjen shqiptare ishte një justifikim i rëndomtë i dështimit që ata pësuan në përpjekjet për ta futur edhe Shqipërinë në sferën e tyre të influencës e të sundimit.

Zhvillimi i ngjarjeve dhe pozita që kishte zënë Shqipëria përkrah gjithë kombeve antifashistë gjatë luftës nuk linte vend për diskutime. Ajo dilte në arenën ndërkombëtare si shtet, pavarësia e të cilit tashmë nuk ekzistonte vetëm *de jure*, por edhe *de facto*. Fitorja e revolucionit popullor solli një kthesë rrënjësore edhe në pozitën dhe rolin e shtetit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare.¹⁰ Ndryshe nga shumë vende të tjera, që u çliruan nga fashizmi, Shqipëria doli nga lufta me një gjëndje të brendshme tepër të qartë. E vetmja forcë politike në vend ishte Fronti

Nacionalçlirimtar, i udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë. Brenda vendit apo jashtë tij nuk ekzistonte asnjë parti politike tjetër apo qeveri që të pretendonte marrjen e pushtetit. Borgezia e lartë dhe çifligarët si klasë, si dhe organizatat e tyre politike Balli Kombëtar e Legaliteti, ishin shpartalluar politikisht e ushtarakisht që gjatë luftës. Qeveria Demokratike kishte mbështetjen e popullit dhe ushtronte kontrollin e plotë në të gjitha krahinat e vendit. Shqipërinë e dalë nga lufta e kishte përfshirë vala entuziaste e rindërtimit.

Në rrugën e forcimit të mëtejshëm të pozitive ndërkombëtare të Shqipërisë Qeveria Demokratike ndeshi në disa probleme të ngritura artificialisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Britania e Madhe. Një prej këtyre problemeve ishte edhe ai i pjesëmarrjes në Konferencën themeluese të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Ashtu siç ishte vendosur në Konferencën e Jaltës, ende pa mbaruar Lufta e Dytë Botërore, më 5 mars 1945 qeveria amerikane, duke vepruar në emër të saj dhe të qeverive të tjera të fuqive të mëdha, njoftoi vendet që kishin nënshkruar Deklaratën e Kombeve të Bashkuara të 1 janarit 1942, ose që kishin aderuar në këtë deklaratë dhe që i kishin shpallur luftë Gjermanisë ose Japonisë para 1 marsit 1945, të merrnin pjesë në Konferencën themeluese të OKB-së, që do të hapet më 25 prill në San-Francisko të SHBA-së.

Kriteri i përfaqësimit në konferencë ishte i drejtë dhe përfshinte shumicën e popujve që kishin luftuar kundër fashizmit, por ai u interpretua dhe u zbatua në mënyrë arbitrare nga SHBA-ja. Në konferencë, krahas vendeve që ndihmuan me të vërtetë në shpartallimin e fashizmit,

u ftuan dhe shtete të tilla si Arabia Saudite, Turqia, Argjentina, etj, të cilat qëndruan mënjanë Luftës së madhe Antifashiste Botërore. Në sajë të një vendimi formal të qeverive të këtyre vendeve, që i shpallnin luftë Gjermanisë naziste në ditët e saj të fundit, ato ftoheshin në konferencë.

Shqipëria, anëtare efektive e Koalicionit Antifashist, nuk u ftua nga qeveria amerikane të dërgonte përfaqësuesin e vet në San-Francisko. Ky veprim nuk ishte një rastësi. Ai përbënte aktin e parë të hapët të politikës amerikane të pasluftës për të mohuar të drejtat e ligjshme të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Në projektet anglo-amerikane të kohës së luftës, Shqipëria e pasluftës përfytyrohej në variante nga më të ndryshmet, thelbi i të cilave ishte një: shtet i modelit perëndimor e nën orbitën e SHBA-së apo të Britanisë së Madhe.¹¹ Nuk përjashtohej që problemi shqiptar t'i jepej rrugë edhe në një variant tjetër. Çerçilli atë e shikonte në kuadrin e «rregullimit» të përgjithshëm të çështjes së Ballkanit: ndarjen e Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë.¹² Diplomacia angleze, me një të rënë të lapsit të Çerçillit, i jepte fund Shqipërisë së paruarur.

SHBA-ja dhe Britania e Madhe ishin munduar të tregoheshin tepër të kujdesshme dhe të maskonin synimet e tyre reale në Shqipëri. Por në tre-katër muajt e parë të pushtetit popullor ishin grumbulluar shumë fakte që dëshmonin se ato dëshironin e punonin për një zhvillim tjetër të situatës në shtetin e ri shqiptar.

Qeveria e Përkohshme Demokratike, e dalë nga Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Beratit në tetor 1944, bëri të ditur dëshirën e saj për t'u njohur prej aleatëve të mëdhenj dhe të gjithë pjesëtarëve të Koalicio-

nit Antifashist si e vetmja Qeveri e vendit. Britania e Madhe, që pretendonte të ishte fuqia më e interesuar për Shqipërinë, menjëherë u përpoq t'i dilte përpara çështjes dhe ta bënte qëndrimin e saj opinion të të tria fuqive të mëdha të Koalicionit Antifashist. Ajo iu drejtua me memorandumet e posaçme qeverive amerikane e sovjetike. Në memorandumin që ambasadori britanik në Moskë Ker i drejtonte Komisarariatit Sovjetik për Punët e Jashtme theksohej se «jam i udhëzuar nga qeveria ime të njoftoj qeverinë sovjetike se në këtë situatë të turbullt në Shqipëri, ajo nuk ka ndër mend ta njohë «Qeverinë e Përkohshme» të krijuar nga ana e FNC» dhe se «qeveria ime shpreson se në këtë drejtim qeveria sovjetike do të jetë dakord.»¹³ Në memorandumin që i drejtohej Departamentit amerikan të Shtetit thuhej se «në situatën e tanishme të turbullt në Shqipëri, qeveria e madhërisë së tij nuk ka ndër mend ta njohë Qeverinë e Përkohshme që është krijuar nga FNC dhe duke informuar Departamentin e Shtetit për mendimin e qeverisë së madhërisë së tij, ambasada britanike është udhëzuar të shprehë shpresën se qeveria e Shteteve të Bashkuara do të jetë e një mendimi.»¹⁴ Londra nuk e pati të vështirë të fitonte mbështetjen amerikane për të hedhur poshtë kërkesën e Qeverisë Demokratike. Të dyja palët nuk e shikonin me sy të mirë këtë qeveri të krijuar nga komunistët dhe pa ithtarët e tyre. Është pikërisht kjo arsyeja që Departamenti i Shtetit në përgjigjen që i kthente Forin Ofisit theksonte se «bashkohet me mendimin e ambasadës britanike se çdo kërkesë për njohje të Qeverisë së Përkohshme të formuar në Berat, që mund të merret në këtë kohë, nuk duhet pranuar.»¹⁵

Në vjeshtën e vitit 1944 SHBA-ja dhe Britania

e Madhe e kuptuan se në Shqipëri e kishin të humbur lojën. Sa më tepër afrohej dita e çlirimit, aq më shumë veniteshin projektet e tyre për Shqipërinë. Britania, që i jepte tonin politikës anglo-saksone në kohën e luftës në Shqipëri, provoi të bënte një orvatje të fundit për të frenuar rrjedhën e ngjarjeve në dobi të FNÇ. Anglezët tri herë rresht kërkuan me këmbëngulje pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ dhe personalisht te shoku Enver Hoxha që të sillnin forca ushtarake në Shqipëri, gjoja në emër të luftës së përbashkët kundër fashizmit për çlirimin e Shqipërisë. Ata u lejuan të zbarkonin trupa të kufizuara vetëm në dy raste në bregdetin jugor të vendit për operacione të vogla kundër garnizoneve gjermane, pa ndonjë vlerë strategjike. Por edhe në këto dy raste anglezëve iu kërkua dhe iu imponua nga Shtabi i Përgjithshëm që të largoheshin menjëherë pas përfundimit të operacioneve. «Partia jonë, — thekson shoku Enver Hoxha, — e kuptoi se tentativat për zbarkim s'kishin si qëllim të luftonin gjermanët në Shqipëri, pse këtë po e kryente me sukses Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, e cila ishte plotësisht e aftë të çlironte vendin e vet pa ndihmën e forcave të armatosura të «miqve», por ta hidhnin Shqipërinë në kthetrat e tyre. Ajo nuk i lejoi ata... i refuzoi e i shkëlmoi propozimet e njëpasnjëshme për të zbarkuar trupa «aleate» në vendin tonë, ku, kur, sa dhe si të donin. Ky ishte një rrezik i tmerrshëm që i kërcënohej vendit tonë».*

Fakti që ngjarjet në Shqipëri po rridhnin me të shpejtë kundër dëshirës dhe jashtë kontrollit të tyre i detyroi Forin Ofisin dhe Departamentin

* Enver Hoxha, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», f. 321.

e Shtetit që të lëviznin nga vendi dhe të zbatonin një taktikë të re. Thelbi i saj qëndronte në përpjekjet për të forcuar tani ndikimin brenda radhëve të Frontit Nacionalçlirimtar, për ta vënë atë nën kontrollin e politikës anglo-amerikane. Të dyja palët shpejtonin të përcaktonin mjetet dhe rrugët për të arritur qëllimin. Ndërsa Londra në nxitim e sipër ngatërrohej në një mori planesh që zhvleftësoheshin pa lindur mirë ende, Uashingtoni tregonte një interesim të madh për zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri. Ndihmësekretari i Shtetit Stetinius më 6 nëntor i shkruante këshilltarit politik amerikan në Shtabin Aleat të Mesdheut, A. Kirkut, se «Departamenti shpreson se ju do të vazhdoni ta mbani atë të informuar për sa u përket zhvillimeve në Shqipëri. Ne do të dëshironim në mënyrë të veçantë të kishim çdo hollësi që mund të tërhiqte vëmendjen, tuaj...»¹⁶

Po Stetiniusi në 25 nëntor i drejtonte presidentit amerikan Rusvelt një memorandum, në të cilin kërkonte miratimin për të dërguar në Bari të Italisë, në krye të misionit amerikan që merrrej me çështjet shqiptare J. E. Xheikobsin. Arsyeja e kësaj kërkese për ligjëj me «rëndësinë e disa çështjeve shqiptare që tashmë kërkojnë kujdes».¹⁷

Me çlirimin e vendit problemi i njohjes së Qeverisë Demokratike bëhet një ndër problemet kryesore të politikës së jashtme të Shqipërisë së re Demokratike Popullore. Në fillim të janarit 1945 Qeveria Demokratike, nëpërmjet një note kërkoi përsëri njohjen nga qeveritë e SHBA-së, të Bashkimit Sovjetik dhe të Britanisë së Madhe si dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me to.

Përsëri është Forin Ofisi që merr iniciativën

për të ngritur pengesa të reja për njohjen e Qeverisë Demokratike. Ngutja dhe zelli i tepruar që tregonin në Londër për të dalë në krye të fushatës izoluese diplomatike ndaj Qeverisë shqiptare frymëzohej jo vetëm nga urrejtja për pushtetin popullor, që ishte vendosur në Shqipëri, por edhe nga frika gjithnjë në rritje nga aleati i pëртеjoqeanit, që po përpiqej t'i vinte në favorin e vet shkopinj nën rrota ndikimit britanik në Ballkan. Më 12 janar 1945 ambasada britanike në Uashington i dërgoi një përkujtesë (Aide-Mémoire) Departamentit të Shtetit. Së pari, Forin Ofisi bënte të ditur qëllimin e tij për të mos njohur Qeverinë shqiptare dhe së dyti, njoftonte se kishte ndër mend të tërhiqte misionin e vjetër ushtarak anglez dhe ta zëvendësonte atë me një mision të ri më të gjerë të kryesuar nga një gjeneral. Si detyrë këtij misioni i caktohej «grumbullimi i informatave për tendencat politike dhe gjendjen ekonomiko-financiare në Shqipëri».¹⁸ Nënkuptohej se kjo ishte vetëm maja e ajsbergut. Koha shumë shpejt do të nxirrte në shesh qëllimin e vërtetë të ardhjes së misionit ushtarak anglez në Shqipëri.

Siç del edhe nga vetë dokumentet amerikane, Departamentit të Shtetit i leverdiste që anglezët të prinin në fushatën antishqiptare. Vetë ndihmësekretari i shtetit Grei i bënte të ditur Kirkut se në lidhje me çështjen shqiptare «ne nuk jemi në asnjë mënyrë të prirur të veprojmë përpara anglezëve...»¹⁹. Amerikanët llogaritnin që gështenjat t'i nxirrnin nga zjarri me duart e anglezëve, ndaj dhe rezervoheshin që të shfaqnin hapur qëndrimin e tyre. Në përgjigjen që i kthente Forin Ofisit më 26 janar Departamenti i Shtetit bashkohej me qëndrimin anglez ndaj çështjes së njohjes.²⁰ Por amerikanët në vend të misionit ushtarak ishin të mendi-

mit të dërgonin një grup civil jozyrtar me mision «informacioni» paraparak rreth gjendjes në Shqipëri.

Pasi e kishin bashkërenduar qëndrimin midis tyre Uashingtoni e Londra kërkonin t'ia impononin atë edhe qeverisë sovjetike. Të nisur nga ky qëllim Forin Ofisi dhe Departamenti i Shtetit i drejtuan Komisarariatit Sovjetik për Punët e Jashtme kërkesën për të mbajtur një pozicion të njëjtë ndaj njohjes së Qeverisë Demokratike.²¹

SHBA-ja dhe Britania e Madhe përsëri u orvatën që çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike të Shqipërisë ta shfrytëzonin për shantazhe e presione. Më 22 janar 1945 feldmareshali Aleksandër, në emër të qeverisë britanike, i bëri të ditur Qeverisë Demokratike kërkesën në formë ultimatumit për zëvendësimin e misionit ushtarak aleat me një mision të ri ushtarak anglez mjaft të gjerë. Në një formë kërcënuese paralajmërohej Qeveria Demokratike që në rast se nuk do të plotësohej kjo kërkesë, «një akt i tillë do të vononte patjetër njohjen akoma më tepër».* Në të njëjtën kohë, feldmareshali Aleksandër këmbëngulte për të dërguar me mijëra «vëzhgues» anglezë në kuadrin e misionit ushtarak të ndërlydhjes (Military Liaison).

Përgjigjja amerikane ndaj kërkesës së Qeverisë Demokratike në thelb ishte e njëjtë me përgjigjen angleze. Në memorandumun e Departamentit të Shtetit në mars 1945 drejtuar Qeverisë sonë vërehej po e njëjta procedurë: në fillim mohimi i njohjes, pastaj kërkesa për ardhjen e një misioni civil amerikan në Shqipëri dhe së fundi kërcënimi se çdo vonesë në realizimin e kërkesave amerikane do të rëndonte në kurriz të njohjes së Qeverisë Demokratike.²²

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 5, f. 483.

Qeveria Demokratike hodhi poshtë me vendosmëri kërkesat që cenonin sigurimin e lirisë e të pavarësisë së shtetit shqiptar, siç ishte p.sh. ajo e «vëzhguesve» të misionit ushtarak të ndërlidhjes, numrin e të cilëve e kufizoi nga 1 500-1 700 në 80. Për të mos u dhënë pretekste të reja anglo-amerikanëve që të vononin çështjen e njohjes dhe e interesuar sinqerisht që të forcohej miqësia midis popujve, ajo lejoi që të hynin në Shqipëri në pranverën e vitit 1945 misionet e reja anglo-amerikane. Në muajin prill qeveria sovjetike bëri të ditur dëshirën e saj për të dërguar një mision ushtarak në Shqipëri, i cili mbërriti në Tiranë në muajin qershor.

Kjo panoramë e shkurtër e qëndrimit të qeverisë angleze dhe asaj amerikane ndaj pushtetit popullor në muajt e parë të ekzistencës së tij mjafton për t'i dhënë përgjigje të plotë pyetjes pse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk e ftuan Shqipërinë në Konferencën themeluese të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. SHBA-ja dhe Britania e Madhe nuk mund të pajtoheshin me ngjarjet që zhvilloheshin në vend.

Mohimi i të drejtave të ligjshme të Shqipërisë ngjalli një valë të gjerë zemërimi e proteste në popullin shqiptar. Në të gjitha krahinat e vendit giatë muajve mars-prill u zhvilluan manifestime të mëdha, në të cilat kërkoheshin njohja e Qeverisë dhe pjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos. Është e pamundur të përshkruhet atmosfera e protestës që zotëronte në atë kohë në qytetet dhe në fshatrat e vendit tonë ndaj padrejtësisë që i bëhej Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Populli, me besim të patundur te Partia Komuniste e Qeveria Demokratike, në të njëjtën kohë, shprehte vendosmërinë e tij për të luftuar deri në realizimin e të drejtave që

i takonin. Dokumentet e kohës dëshmojnë fare mirë për ndjenjat që provonte populli shqiptar në ato ditë të pranverës së 1945-ës.

Me dhjetëra e qindra mijëra njerëz në qytetet e fshatrat e vendit, të mbledhur në mitingje, ngritën zërin e protestës kundër mohimit të të drejtave të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe i kërkuan Qeverisë Demokratike që të bëhej ndërmjetëse pranë aleatëve të mëdhenj dhe të shfaqte kërkesën e njëzëshme të të gjithë popullit shqiptar për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos²³. Pas një manifestimi që zgjati katër orë e gjysmë, 30 mijë veta nga populli i qytetit dhe i fshatrave të Tiranës u drejtuan në misionet angleze, amerikane e sovjetike për të kërkuar pranimin e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos. Përfaqësuesi sovjetik u deklaroi manifestuesve se do t'i transmetonte qeverisë së tij kërkesat e popullit shqiptar.²⁴ Manifestimet dhe kërkesat e popullit shqiptar për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos patën një jehonë të gjerë ndërkombëtare. Shtypi përparimtar e demokratik botëror u dha një përkrahje të gjerë këtyre kërkesave të ligjshme.

Në valën e manifestimeve të mëdha popullore Qeveria Demokratike, duke interpretuar dëshirën dhe vullnetin e zjarrtë të popullit shqiptar, më 29 mars të vitit 1945 iu drejtua kryetarëve të të tria fuqive të mëdha, SHBA-së, BS-së e Anglisë me kërkesën që Shqipëria të thirrej në Konferencën e San-Franciskos.* Qeveria shqiptare tërhiqte vëmendjen për faktin se asnjë ftesë nuk i ishte drejtuar asaj deri atëherë për të marrë pjesë në konferencë. Ajo u rikujtonte fuqive të mëdha, që ishin edhe iniciatorët dhe or-

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 17-18.

ganizatorët e konferencës, se Shqipëria ishte në radhët e para të luftës së Koalicionit të madh Antifashist, se shumë shtete që nuk kishin dhënë asnjë ndihmesë në këtë luftë ishin ftuar dhe përgatiteshin të dërgonin përfaqësues në San-Francisko. Qeveria Demokratike u bënte të ditur gjithashtu fuqive të mëdha se ajo ishte përfaqësuese legjitime e popullit shqiptar, i cili meritonte në çdo pikëpamje të jepte ndihmesën e tij në rregullimin e çështjeve që i përkisnin të ardhmes së popujve.

Kërkesa e Qeverisë Demokratike për të marrë pjesë në Konferencën themeluese të OKB-së e vuri Departamentin e Shtetit përpara nevojës së ngutshme për të kërkuar një pretekst që të mbështeste refuzimin. Ai nuk mund ta mohonte luftën dhe ndihmesën e popullit shqiptar në shpartallimin e fashizmit, sepse do të dilte kundër deklaratave të mëparshme të qeverisë amerikane që e njihnin dhe e vlerësonin këtë luftë. Në Uashington e gjetën më të përshtatshme që ta lidhnin ftesën shqiptare për në Konferencën e San-Franciskos me çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike. Vetë njohja e Qeverisë ishte kushtëzuar me plotësimin e disa kërkesave që kishin vënë e do të vinin më vonë SHBA-ja dhe Britania e Madhe. Qëllimisht e në mënyrë artificiale SHBA-ja i bashkoi këto dy çështje që të mos zgjidhej as njëra as tjetra.

Në fillim të prillit Departamenti i Shtetit mori përsipër t'i kthente përgjigje Qeverisë Demokratike. Sekretari i shtetit Stetiniusi ngarkoi Kirkun dhe Xheikobsin në Kazerta për t'i dhënë dorën e fundit një memorandum i jozyrtar. Memorandumi iu dorëzua Qeverisë shqiptare më 11 prill. Departamenti i Shtetit sillte aty «argumente» për të zhvleftësuar kërkesën shqiptare. Tërtho-

razi lihej të kuptohej se Qeveria shqiptare «nuk e kishte të qartë» për se mbledhej Konferenca e San Franciskos, se kjo e fundit do të mirrej vetëm me çështjen e themelimit të organizatës ndërkombëtare, pra ajo nuk do të kishte aspak karakterin e Konferencës së Paqes.²⁵ Argumenti tjetër sipas Departamentit të Shtetit ishte procedura e ndjekur për ftesat e cila «nuk parashi-konte pjesëmarrjen e qeverive të panjohura» në konferencë. Departamenti i Shtetit nuk mund të merrte përsipër rihapjen e diskutimit të procedurës që tashmë ishte mbyllur. Për rrjedhim, ai nuk ishte në gjendje të mbështeste kërkesën e Qeverisë Demokratike për përfaqësimin e Shqipërisë në Konferencën e ardhshme të San-Franciskos.²⁶

Shtetet e Bashkuara, si në çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike, ashtu edhe në atë të përfaqësimit të saj në Konferencën themeluese të OKB-së, duke spekuluar me «Deklaratën mbi Evropën e Çliruar», kërkonin t'i impononin qëndrimin e tyre edhe Bashkimit Sovjetik. «Deklarata mbi Evropën e Çliruar», që u miratua në Konferencën e Jaltës, i angazhonte SHBA-në, Bashkimin Sovjetik dhe Britaninë e Madhe në përpjekje për të mbajtur një qëndrim të përbashkët ndaj të gjitha qeverive të vendeve të Evropës të çliruara nga pushtimi nazifashist.²⁷

Uashingtoni dhe Londra këtë deklaratë e interpretuan si një dokument që u jepte të drejtën që të ndërhynin në punët e brendshme të vendeve të çliruara të Evropës, të vendosnin aty regjimin politik që dëshironin dhe të shuanin çdo prirje e lëvizje revolucionare. Nga kjo pikëpamje SHBA-ja dhe Anglia synonin të ndërhynin edhe në Shqipëri, fatin e së cilës ata nuk mund ta kuptonin ndryshe, veçse të lidhur ngushtë me

Perëndimin. Është kjo arsyeja që Departamenti i Shtetit, duke spekuluar me «Deklaratën mbi Evropën e Çliruar», kërkonte që problemet e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare të liheshin në duart e tri fuqive të mëdha. Qeveria amerikane këmbëngulte që të tria qeveritë kryesore aleate nuk duhej të ndërmerinin asnjë vendim të prerë për sa i takonte Shqipërisë në çështjet me rëndësi ndërkombëtare, përveçse në konsultime me dy qeveritë e tjera aleate.²⁸ Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nën maskën e konsultimeve me fuqitë e tjera të mëdha, synonin të bënin monopol të tyre zgjidhjen e çështjeve ndërkombëtare që kishin të bënin me Shqipërinë.

Departamenti i Shtetit dhe Forin Ofisi e mbanin njëri tjetrin në korent të ngjarjeve dhe i bashkërendonin mirë qëndrimet e tyre. Ndaj qeverisë sovjetike ata ndiqnin politikën e faktit të kryer. Kështu u veprua edhe me çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike dhe të pjesëmarrjes së saj në Konferencën themeluese të OKB-së. Vetëm tetë ditë më vonë, pasi i kishte kthyer një përgjigje negative Qeverisë shqiptare, Departamenti i Shtetit e njoftoi Ministrinë e Jashtme sovjetike për këtë qëndrim të tij. Stetiniusi më 19 prill udhëzonte të ngarkuarin me punë të SHBA-së në Bashkimin Sovjetik, Kenan, që të informonte qeverinë sovjetike se Uashingtoni, në vijim të kërkesës së Qeverisë shqiptare për të marrë pjesë në Konferencën e San-Franciskos, nuk kishte pranuar të mbështeste kërkesën e saj.²⁹

Qeveria sovjetike nën udhëheqjen e Stalinit e vlerësonte drejt Qeverinë shqiptare dhe përkrahte hapat e parë të Shqipërisë së re. Departamenti i Shtetit, duke qenë në dijeni të

këtij qëndrimi, kërkonte të frenohej ndonjë veprim sovjetik në favor të çështjes shqiptare, gjë që do t'i vinte në pozitë tepër të vështirë si SHBA-në ashtu edhe Britaninë e Madhe. Ishte pikërisht ky qëllim që e shtynte Stetiniusin të porosiste Kenanin që t'u rikujtonte sovjetikëve se qeveria amerikane «nuk përpiket të ndërmarrë ndonjë veprim të prerë për sa i takon njohjes së Shqipërisë, veçse pas konsultimit me qeveritë kryesore të aleancës dhe se kjo qeveri shpreson se qëndrimi i saj në këtë drejtim lidhet me atë sovjetik.»³⁰

Parimet që përmbaheshin në «Deklaratën mbi Evropën e Çliruar» ishin të drejta, antifashiste e demokratike. Ato u shkelën, u interpretuan shtrembër dhe u shfrytëzuan për qëllime hegjemoniste nga anglo-amerikanët. Qeveria sovjetike e Stalinit, duke e kuptuar një politikë të tillë, vepronte me kujdes e vendosmëri dhe shumë shpejt doli hapur në mbrojtje të interesave sovranë e demokratikë të popujve e të vendeve të vogla.

Qeveria Demokratike ishte e ndërgjegjshme se asnjë lloj arsye nuk mund të pengonte pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos veç armiqësisë së qeverive të SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe për pushtetin popullor. Duke i njohur që më parë këto qëndrime, Qeveria Demokratike nuk u pajtua me përgjigjen që i dha Departamenti i Shtetit për Punët e Jashtme të Shteteve të Bashkuara. «Të drejtën e njohjes së qeverisë së tij dhe pjesëmarrjen në Konferencën e San-Franciskos, — theksonte në atë kohë shoku Enver Hoxha, — populli ynë e ka fituar me luftë dhe me sakrifica dhe derisa në atë konferencë janë ftuar shtete, që jo vetëm nuk kanë luftuar aspak kundër fashizmit, por

edhe e kanë ndihmuar tërthorazi, lënia jashtë e popullit shqiptar është një padrejtësi.»*

Çështja e njohjes së Qeverisë Demokratike dhe aq më pak vendosja ose jo e marrëdhënieve zyrtare të saj me SHBA-në nuk ishin dhe s'kishin për se të ishin kushte për thirrjen e Shqipërisë në San-Francisko. Ishte e qartë se preteksti që paraqiti Departamenti i Shtetit për të refuzuar pranimin e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos, dhe që u përsërit edhe më vonë, ishte në kundërshtim me vetë parimet mbi të cilat po ngrihej Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Qeveria Demokratike e Shqipërisë, duke mos e quajtur të drejtë pretekstin që përmbante memorandum i amerikan i 11 prillit, ripërsëriti më 27 prill kërkesën për pranimin në Konferencën e San-Franciskos. Kësaj radhe ajo iu drejtua Kryetarit të konferencës, sekretarit amerikan të Shtetit Stetiniusit, duke këmbëngulur që kërkesa e saj të shqyrtohej «prej fuqive kryesore ftuese jashtë çdo konsiderimi procedural në një frymë më të gjerë drejtësie...»³¹ Qeveria shqiptare kërkonte që rasti i Shqipërisë të trajtohej jashtë procedurës së zbatuar për pjesëmarrjen në konferencë, që gjoja sipas Departamentit të Shtetit nuk parashikonte pjesëmarrjen e qeverive të panjohura. Shqipërisë i takonte të shkonte në San-Francisko si anëtare themeluese e OKB-së, ashtu si u takonte të gjitha vendeve që kishin luftuar kundër fashizmit.

Kjo kërkesë bëhej në një kohë kur misioni informativ i Departamentit të Shtetit po bëhej gati të hynte në Shqipëri. Në marsin e 1945-ës në Shqipëri kishte mbërritur një mision i ri ush-

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 33.

tarak anglez. Uashingtoni dhe Londra u përkujdësën që ardhja e misioneve anglo-amerikane në Shqipëri të mos vlerësohej si një akt njohjeje i Qeverisë Demokratike. Në korrespondencën e Departamentit të Shtetit me zyrën e këshilltarit politik në Kazerta dhe me misionin amerikan në Shqipëri është shprehur qartë shqetësimi i qeverisë amerikane që vendimi i saj për të dërguar një mision civil me qëllim informacioni në Tiranë të mos konsiderohej kurrsesi si një akt zyrtar njohjeje. Departamenti i Shtetit e këshillonte kryetarin e misionit amerikan në Shqipëri, Xhejkobsin, që të tregonte kujdes «për të evituar përdorimin e termave ose të titujve, gjë që të bën të mendosh për marrëdhënie diplomatike ose konsullore»³². Nuk lihej pa u këshilluar Xhejkobsi edhe për çështjen e pranimit të Shqipërisë në OKB. Ai paralajmërohej, që në rast se gjatë takimit të tij me autoritetet qeveritare shqiptare ngrihej ky problem, të shprehte qëndrimin e njohur amerikan të memorandumit të 11 prillit³³.

Për Qeverinë Demokratike këto manovra nuk ishin të panjohura. Ajo ndiqte me vëmendje veprimtarinë dhe qëndrimin armiqësor të SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe në çështjen e njohjes së qeverisë dhe të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos. Më 9 maj, në takimin me kryetarin e misionit amerikan, shoku Enver Hoxha shprehu edhe një herë pakënaqësinë e Qeverisë Demokratike dhe të popullit shqiptar për qëndrimin amerikan në lidhje me thirrjen e Shqipërisë në San-Francisko. Populli shqiptar, — i deklaroi shoku Enver Hoxha, — përfaqësuesit të Uashingtonit, «është thellësisht i indinjuar dhe zien nga marazi edhe për padrejtësinë që iu bë duke i mohuar të drejtën legjitime për të dërguar përfaqësuesit e vet në Konfe-

rencën e San-Franciskos... Shqipëria edhe sot e kësaj dite qëndron jashtë OKB-së. Këtë të drejtë ajo s'ia kërkon ndokujt për mëshirë, atë ajo e ka fituar me gjak e sakrifica mbinjerëzore, duke u hedhur pa asnjë rezervë në luftën për lirinë e saj e të popujve të tjerë, për të drejtat e njerëzimit.»* Megjithatë qeveria amerikane nuk hoqi dorë nga qëndrimi i saj armiqësor. Në notën e datës 28 maj Stetiniusi dha përsëri një përgjigje negative. Aty thuhej se «sikundër jeni informuar tashmë, Shtetet e Bashkuara nuk mund të mbështetin pikëpamjen për pjesëmarrjen në konferencë të autoriteteve që ushtrojnë tani kontrollin në Shqipëri, me të cilat qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ka vendosur marrëdhënie zyrtare.»³⁴ Pra përsëri taktika e lojës së dyfishtë. Nga njëra anë kundërshtonin njohjen e Qeverisë Demokratike, bënin çmos ta pengonin atë, nga ana tjetër merrnin shkas nga mungesa e njohjes së saj për të përligjur qëndrimin e tyre për mospranimin e Shqipërisë në Konferencën e San-Franciskos.

Motivet e vërteta që përcaktonin qëndrimin e qeverisë amerikane ishin të tjera. Ekzistenca e një shteti të lirë e të pavarur shqiptar, me një qeveri demokratike, që gëzonte mbështetjen e popullit, dilte jashtë kornizave të projekteve amerikane të pasluftës. Në Uashington e në Londër nuk mund ta konceptonin ndryshe Shqipërinë, veçse sipas skemave e kallëpeve të vjetra imperialiste. Fuqitë imperialiste gjithnjë ishin përpjekur për ta përdorur Shqipërinë si monedhë shkëmbimi, në transaksionet e tyre ndërkombëtare, ta kthenin atë në një bazë intrigash e

* Enver Hoxha, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», f. 354-355.

lufte në Ballkan.* Revolucionin popullor, i cili triumfoi në Shqipëri për herë të parë në historinë e vendit, krijoi mundësi reale që vendi të zhvillohej i pavarur dhe jashtë çdo diktati të huaj, duke u bërë kështu faktor paqeje e stabiliteti në Ballkan. Pushteti popullor, i vendosur në Shqipëri, e kishte treguar me kohë se do të priste, ashtu siç i preu, të gjitha urat për depërtimin imperialist në vend. SHBA-ja dhe Anglia shpresonin të rikthenin situatën e kaluar, të triumfonte komploti që ata kishin organizuar brenda vendit me reaksionin dhe agjentët e tyre.

Krahas përpjekjeve për të ringjallur e për të vënë në lëvizje grupet armiqësore brenda vendit, qeveria angleze e ajo amerikane u kujdesën të aktivizonin e të mbanin afër edhe ata kuislingë e tradhtarë shqiptarë që, me çlirimin e vendit, morën arratinë. Qeveria shqiptare, disa herë në rrugë zyrtare, u kishte kërkuar qeverive të SHBA-së e të Britanisë së Madhe të dorëzonin kriminelët e luftës, të cilët kishin gjetur strehë në vende të tilla si në Itali, në Greqi, të kontrolluara nga autoritetet ushtarake aleate. Këto qeveri në fillim mohonin se kishin nën kontroll kriminelë shqiptarë. Kur Qeveria e RPSH me fakte e dokumente provoi se shumica e kriminelëve shqiptarë të luftës jashtë atdheut ndodheshin nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e anglo-amerikanëve, Uashingtoni dhe Londra nxituan të nxirrnin përsëri pengesën e preferuar: mungesën e marrëdhënieve zyrtare. Në përgjigje të kërkesës që shoku Enver Hoxha i kishte bërë presidentit amerikan më 1 qershor për dorëzimin e kriminelëve të strehuar në Itali, Departamenti i Shtetit autorizonte Xhejkobsin të shprehte pikëpamjen e qeverisë amerikane se kjo «është çështje, e cila

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 5, f. 474.

nuk mund të përcaktohet derisa të arrihet marrëveshja për sa u takon marrëdhënieve midis regjimit shqiptar dhe qeverive kryesore aleate»³⁵. Shumë prej kriminelëve kryesorë të luftës ishin agjentë të SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe. Dihet se një pjesë e mirë e tyre u nxorrën nga Shqipëria me ndihmën e këtyre dy shteteve në prag të çlirimit të vendit.

Krerët e tradhtarëve shqiptarë jashtë atdheut ishin njerëz me njëqind flamurë në xhep. Me po atë besnikëri që i kishin shërbyer fashizmit provonin tani t'u shërbenin edhe anglo-amerikanëve. Disa prej tyre Forin Ofisi dhe Departamenti i Shtetit i kishte cilësuar si «patriotë të vërtetë» që jo vetëm mund të ktheheshin në Shqipëri, por duhej të bënin pjesë edhe në Qeverinë Demokratike. Në planet e Uashingtonit e të Londrës pjesa e reaksionit shqiptar jashtë shërbente për disa qëllime: së pari, për të shfrytëzuar atë ndikim të paktë që ata kishin ende në mbeturinat e ish-klasave të përmbysura dhe të reaksionit brenda vendit; së dyti, për t'i hedhur po qe nevoja më vonë në Shqipëri për të organizuar luftën diversioniste kundër pushtetit popullor dhe, së treti, për t'i përdorur, për sa kohë që ata vetë nuk mund të dilnin hapur si tellallë, kundër Qeverisë së re Demokratike dhe për t'i krijuar asaj pengesa në arenën ndërkombëtare. Krerë të Ballit Kombëtar e të Legalitetit ndërmorën në faqet e gazetave reaksionare të Perëndimit një fushatë të tërë shpifjesh. Ata i dërguan një varg letrash e memorandumesh Departamentit të Shtetit dhe Forin Ofisit, ku kërkonin që Shqipëria të mos pranohet në OKB.

Nuk ishte rastësi që, në tërë këtë fushatë të reaksionit shqiptar jashtë vendit, Qeveria Demokratike atakohej hapur me po ato «argumente» e

pika që kishin zënë vend në korespondencën zyrtare të qeverive anglo-amerikane me Qeverinë tonë. Më 14 prill 1945 disa krerë të Ballit Kombëtar i dërguan një memorandum Departamentit amerikan të Shtetit³⁶. Përmbajtja e këtij memorandumi nuk është bërë e njohur plotësisht. Në dokumentet amerikane të botuara pjesa e parë dhe e dytë e tij mungojnë. Por edhe atë që është dhënë mjafton për të provuar se sa thellë ishin zhytur këta njerëz në llumin e tradhtisë. Në mënyrë tepër cinike ata shprehnin kënaqësinë e tyre që Shqipëria nuk u ftua në Konferencën e San-Franciskos. Dhe faji, sipas logjikës balliste, rëndonte mbi Qeverinë Demokratike, që na qenkej qeveri «ekstremiste». Për rrjedhim jepej edhe varianti i zgjidhjes së problemit: Me ndihmën e SHBA-së e të Britanisë së Madhe të ndërrohej regjimi në Shqipëri, të vendosej një qeveri «demokratike» e modelit perëndimor, e përbërë nga «nacionalistë shqiptarë», njerëz «të pjekur» e «të regjur» në politikë! Gjithnjë sipas memorandumit ballist, vetëm një Shqipëri e tillë do të ishte e aftë të merrte pjesë në OKB. Për ta shitur sa më shtrenjtë këtë memorandum, autorët e mbyllnin me një varg nënshkrimesh ku ishin fiksuar funksionet diplomatike të së kaluarës. Ata rronin me të kaluarën, sepse nuk kishin të ardhme. Urat për të kaluar aty ua kishte prerë revolucionin popullor që triumfoi në Shqipëri.

Vendi ynë përfundimisht nuk u thirr në Konferencën themeluese të OKB-së. Zhvillimi i punimeve të kësaj konference zbuloi falsitetin e pretekstit amerikan mbi pamundësinë e rishikimit të procedurës së pranimeve në këtë forum. Danimarka, Italia dhe disa vende të tjera kishin kërkuar zyrtarisht të merrnin pjesë në Konferencën e San-Franciskos. Këto kërkesa u bënë objekt

shqyrtimi në Departamentin e Shtetit dhe në gjirin e delegacionit amerikan në San-Francisko, që kryesohej nga Stetiniusi. Asnjë çështje procedure nuk u deklarua si pengesë nga qeveria amerikane për këto vende përveç frikës se një pranim i tyre do të ngrinte problemin e ftesës edhe për Shqipërinë.³⁷ Megjithatë Danimarka, pas konsultimeve midis delegacioneve të fuqive të mëdha, më 6 qershor u ftua të merrte pjesë në konferencë. Për dy muaj rresht në San-Francisko u diskutuan propozimet e Dumbarton Oksit, të rishikuara në Konferencën e Jaltës. Më 25 qershor 1945 në seancën plenare të konferencës u miratua Karta e Kombeve të Bashkuara.

Padrejtësitë që po i bëheshin Shqipërisë nuk e tërhoqën Qeverinë Demokratike nga lufta për t'i siguruar vendit të drejtat e ligjshme në arenën ndërkombëtare. Këto përpjekje, ndonëse nuk kishin arritur ndonjë rezultat konkret, kishin sjellë disa përfitime. Çështjet shqiptare, si njohja e Qeverisë, pranimi në OKB etj., që ishin të lidhura drejtpërsëdrejti me vetë pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, kishin fituar mbështetjen e opinionit publik përparimtar botëror. Ai ishte njohur me luftën dhe me përpjekjet e popullit shqiptar për liri e përparim shoqëror.

Këmbëngulja me të cilën Qeveria shqiptare kërkonte të drejtat e saj në arenën ndërkombëtare i kishte vënë anglo-amerikanët në një pozitë të vështirë. Misionet e tyre kishin kohë që ndodheshin në Shqipëri dhe kishin dërguar edhe raportet e tyre të para mbi gjendjen në vend. Uashingtoni dhe Londra, sipas deklaratave të mëparshme, duhej të përcaktonin qëndrimin e tyre ndaj Qeverisë Demokratike. Për këtë qëllim të dyja palët ishin në kontakte tepër të ngushta. Ambasada britanike në Uashington më 21 qershor,

nëpërmjet një promemorieje drejtuar Departamentit të Shtetit, shprehte pikëpamjen se Forin Ofisi «nuk do të nxitohet në njohje» dhe se «qeveria e Shkëlqesisë së tij është për bashkërendimin e politikës me qeverinë amerikane për sa i takon njohjes... së Qeverisë së tanishme shqiptare.»³⁸

Uashingtoni këtë bashkërendim kërkonte ta shtrinte edhe më gjerë në kuadrin e tri fuqive të mëdha. Departamenti i Shtetit ishte i shqetësuar nga qëndrimi dashamirës dhe nga përkrahja që qeveria sovjetike po i jepte shtetit të ri shqiptar. Një delegacion qeveritar shqiptar ishte pritur në Moskë në qershor 1945. Qeveria amerikane nxitoi t'i dilte përpara dhe të pengonte një veprim të njëanshëm sovjetik ndaj çështjes së njohjes së Qeverisë Demokratike. Më 14 qershor 1945 Xh. Gru, ndihmësekretar i Departamentit të Shtetit, i drejtoi një memorandum presidentit Truman me rastin e përpunimit të rendit të ditës për konferencën e ardhshme të të tria fuqive të mëdha që ishte caktuar të mbahej në Potsdam në muajin korrik. Në njëërën prej pikave të rendit të ditës Departamenti i Shtetit propozonte përfundimin e një marrëveshjeje midis SHBA-së, Bashkimit Sovjetik dhe Britanisë së Madhe, sipas së cilës asnjëra prej këtyre tri fuqive nuk do të ndërmerre hapa në njohjen e Qeverisë Demokratike të Shqipërisë pa konsultime paraprake midis tyre. Disa ditë më vonë projekti amerikan që çështja shqiptare të diskutohej në nivelin më të lartë në Potsdam ia la vendin diskutimit në nivelin e ministrave të Punëve të Jashtme.

Departamenti i Shtetit mori masa që të përgatiste dosjen shqiptare për Konferencën e Potsdamit. Për këtë qëllim, ndër të tjera, ai, më 27 qershor, i kërkoi Xhejkobsit një raport të shkurtër me zbulime dhe rekomandime në lidhje me

situatën në Shqipëri.³⁹ Më 1 korrik Xhejkobsi e dërgoi raportin e tij në Uashington⁴⁰. Ai përmbante 12 konkluzione dhe 6 rekomandime. Emisari amerikan ishte i detyruar të pranonte se pushteti popullor kishte mbështetjen e popullit, se në organet shtetërore e përfaqësuese ishin vendosur njerëz patriotë, që përpiqeshin të vinin të gjitha aftësitë e tyre në shërbim të qeverisjes dhe të mirëqenies më të mirë të popullit shqiptar. Xhejkobsi radhiste rekomandimet e tij, ose më saktë kushtet mbi bazën e të cilave duhej njohur Qeveria shqiptare. Kryesoret ishin tri: 1) në një kohë të arsyeshme të zhvilloheshin zgjedhjet në të cilat populli shqiptar do të zgjidhte përfaqësuesit për organin më të lartë legjislativ, ku do të përcaktohej forma e përhershme e organizimit shtetëror. 2) të garantoheshin sipas ligjit ndërkombëtar imuniteti i diplomatëve amerikanë, privilegjet dhe të drejtat e tyre. 3), t'i kërkoheshin regjimit në fuqi që të zgjeronte bazën e tij duke futur në qeveri disa anëtarë të opozitës.

Departamenti i Shtetit e vlerësoi raportin e Xhejkobsit si «një vëzhgim objektiv të situatës në Shqipëri» dhe e futi në dosjen shqiptare për Konferencën e Potsdamit.⁴¹ Planin e tij për një diskutim të mundshëm të çështjes shqiptare në konferencën e nivelit të lartë të të tria fuqive të mëdha, Departamenti i Shtetit ia bëri të njohur edhe Forin Ofisit, nëpërmjet një memorandumit që ai i drejtonte ambasadës angleze në Uashington, që është njëkohësisht edhe përgjigje për promemorjen angleze të 21 qershorit. Uashingtoni bashkohej me mendimin e Londrës se Qeveria shqiptare nuk duhej njohur në këtë kohë, pasi nuk kishte marrë ende raportin përfundimtar prej kryetarit të misionit amerikan në Shqipëri.⁴² Të dyja qeveritë parapërgatiteshin që të kundërshtoj-

nin çështjen e njohjes së Qeverisë Demokratike në rast se ky problem do të ngrihej në takimin e tri fuqive të mëdha.

Konferenca e Potsdamit i zhvilloi punimet nga 17 korriku deri më 2 gusht 1945. Gjatë zhvillimit të punimeve të konferencës, më 26 korrik shoku Enver Hoxha u dërgoi nga një mesazh Stalinit, Çerçillit dhe Trumanit, në të cilat kërkohej edhe një herë njohja e Qeverisë Demokratike.* Megjithatë nuk ka asnjë të dhënë që çështja shqiptare të jetë diskutuar në Konferencën e Potsdamit, qoftë edhe në nivelin e ministrave të Punëve të Jashtme. Si në dokumentet amerikane, ashtu edhe në ato sovjetike, mbi punimet e konferencës, që kanë parë dritën e botimit, nuk ka asgjë të posaçme në lidhje me çështjen e njohjes së Qeverisë apo të pranimit të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Në konferencë anglo-amerikanët ngritën çështjen e pranimit të Italisë në OKB. Delegacioni sovjetik kërkoj që rasti i Italisë të mos merrej i shkëputur nga ai i vendeve të tilla si Rumania, Bullgaria, Hungaria e Finlanda, që ndodheshin në të njëjtën pozitë si ish-shtetet aleate të Gjermanisë naziste. Tri fuqitë e mëdha ranë dakord që pas përfundimit të traktateve të paqes, këto vende të pranoheshin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Pjesëmarrësit e konferencës vendosën në të njëjtën kohë që të mbështesnin kërkesën për pranim në OKB të të gjitha atyre shteteve që qëndruan neutralë gjatë kohës së luftës.

Në dritën e këtyre vendimeve vetvetiu shtrohet pyetja: Në cilën anë e kishin radhitur Shqipërinë fuqitë e mëdha? Ajo nuk figuronte as në listën e shteteve armiq dhe as në listën e shteteve neutrale.

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 67-68.

Të vetmet çështje në lidhje me Shqipërinë që u prekën në këtë konferencë ishin ajo e incidenteve në kufirin shqiptaro-grek dhe e reparacioneve që Shqipëria duhej të merrte nga Italia. Në 18 korrik Stalini, në një bisedë jozyrtare me Çerçillin, i tërhoqi vëmendjen kryeministrit anglez mbi provokacionet greke në kufi me Shqipërinë.⁴³ Çerçilli e mori në mbrojtje politikën provokuese të monarkofashistëve grekë ndaj Shqipërisë. Ai akuzoi Shqipërinë se ka përqendruar trupa të shumtë në kufirin me Greqinë. Kryeministri anglez jo pa qëllim hodhi në tryezën e bisedimeve, në formë paralajmërimi e kërcënimi, pikëpamjen e vjetër angleze në mbështetje të pretendimeve territoriale greke ndaj Shqipërisë së Jugut. Ai theksoi se «kufijtë do të vendosen në Konferencën e Paqes dhe se kush përpiqet të përcaktojë më shpejt kufijtë e tij mund të ndodhet në një pozitë më të keqe».⁴⁴ Që nga kjo konferencë del nga prapaskena dhe fillon të shfaqet sheshit një nga pretekstet kryesore që kanë për të ngritur SHBA dhe Britania e Madhe kundër pranimi të Shqipërisë në OKB dhe përgjithësisht kundër të drejtave të saj në arenën ndërkombëtare. Dhe kjo është çështja greke. Nga kjo pikëpamje nuk është pa vend të supozohet se akuzat angleze, të mbështetura edhe nga amerikanët në Konferencën e Potsdamit kundër Shqipërisë në lidhje me çështjen greke, u ngritën me qëllim që të pengohej diskutimi i problemeve të tilla ndërkombëtare të Shqipërisë siç ishin njohja e Qeverisë dhe pranimi në OKB.

Qëndrimi armiqësor i këtyre dy fuqive të mëdha ndaj vendit tonë u manifestua edhe gjatë diskutimit të çështjes së reparacioneve nga Italia. Në projektet e delegacionit sovjetik, që

u parashtruan në mbledhjet e ministrave të Punëve të Jashtme të të tria fuqive të mëdha më 24 dhe 30 korrik 1945, Shqipërisë i njëhej e drejta e marrjes së reparacioneve nga Italia. Në të kundërtën, projektet anglo-amerikane e përjashtonin Shqipërinë nga një e drejtë e tillë.

Në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare të SHBA-së e të Britanisë së Madhe menjëherë pas luftës vihen re disa nga tiparet që karakterizojnë diplomacinë imperialiste, siç janë shantazhi e presionet, prapaskenat, mashtrimi e demagogjia. Në ata pak muaj të marrëdhënieve me këto dy fuqi të mëdha Shqipëria po i provonte pasojat e kësaj diplomacie.

Në fillim të vjeshtës, në Departamentin e Shtetit dhe në Forin Ofis e ndienin se kishte ardhur koha të bënin një «gjest» në adresë të njohjes së Qeverisë Demokratike. Misionet anglo-amerikane e kishin kryer detyrën e tyre dhe kishin dërguar raportet mbi gjendjen në Shqipëri. Në Londër e në Uashington nuk mund të kapeshin më pas justifikimit të mungesës së informacionit mbi situatën në vend. Muaji tetor është i mbushur me një korespondencë të ngjeshur diplomatike midis Forin Ofisit dhe Departamentit të Shtetit për çështjen e njohjes së Qeverisë shqiptare. Nuk mungojnë edhe takimet kokë më kokë midis zyrtarëve të të dyja palëve siç ishte ai i 4 tetorit 1945 në Londër. Dy ishin shqetësimet kryesore: përcaktimi i kushteve të njohjes dhe sigurimi i qeverisë greke se akti i njohjes së Qeverisë shqiptare nuk nënkuptonte edhe zgjidhjen e problemeve të saj ndërkombëtare e në mënyrë të veçantë problemet territoriale. Pasi ranë dakord midis tyre, Uashingtoni dhe Londra iu drejtuan qeverisë sovjetike për t'u bashkuar me ta në njohjen

e Qeverisë shqiptare me kushte. Qeveria sovjetike shprehu gatishmërinë e saj të plotë, por nuk pranoi që Qeverisë Demokratike t'i viheshin kushte.⁴⁵ Të tria qeveritë ranë dakord që notat e njohjes të bëheshin të ditura në 10 nëntor. Nota sovjetike njihte Qeverinë shqiptare pa asnjë kusht dhe ishte efektive.⁴⁶

Ndërsa notat anglo-amerikane vinin disa kushte, si zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të fshehta dhe lejimin e korespondentëve të huaj në Shqipëri për të parë zhvillimin e zgjedhjeve.⁴⁷ Nota amerikane përmbante edhe një kusht tjetër: pranimin prej Qeverisë shqiptare të të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve që ishin lidhur midis Shqipërisë e SHBA-së para 7 prillit 1939. Në përfundim, të dyja notat përmbanin frazën plot nënkuptim e thekse antishqiptare se vendimi i qeverive të SHBA-së e të Britanisë së Madhe për të njohur Qeverinë shqiptare nuk presupozonte zgjidhjen e çështjeve të tjera me karakter ndërkombëtar që i përkisnin Shqipërisë.⁴⁸

Njohja anglo-amerikane me kushte ishte një manovër politike e paramenduar. Duke e kuptuar këtë, shoku Enver Hoxha, në takimin që pati më 10 nëntor me kryetarët e misionëve anglo-amerikane, demaskoi edhe një herë tjetër qëndrimin mashtrues e armiqësor të SHBA-së e të Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. «Populli shqiptar, — tha ai, — nuk do ta mirëpresë këtë lloj njohjeje të Qeverisë së tij nga aleatët... ai edhe herë të tjera ka shprehur pakënaqësinë për disa qëndrime të tyre ndaj përfaqësimit të tij në forume ndërkombëtare. Atij s'i ka ardhur e s'i vjen mirë që vazhdon t'i mohohet e drejta e anëtarësisë në OKB dhe këtë shqiptarët e shikojnë si mohim të principeve për të cilat u bë lufta antifashiste, për të cilat u

krijua OKB-ja.»* Asgjë nuk kishte ndryshuar në politikën antishqiptare të SHBA-së e të Britanisë së Madhe në vjeshtën e vitit 1945. Politika e tyre e mohimit sistematik të të drejtave të Shqipërisë në këtë kohë u përforcua me fakte të tjera. Uashingtoni dhe Londra kundërshtuan pjesëmarrjen e Shqipërisë në diskutimin e Traktatit të Paqes me Italinë në sesionin e parë të Mbledhjes së Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha në Londër në shtator-tetor dhe u përpoqën ta bënin këtë edhe në Konferencën e Dëmshtëpërblimeve që u mbajt në Paris në nëntor-dhjetor 1945.

Me gjithë politikën armiqësore anglo-amerikane pozitat e brendshme dhe ato ndërkombëtare të Shqipërisë po forcoheshin nga dita në ditë. Zgjedhjet e 2 dhjetorit të 1945-ës për Asamblenë Kushtetuese, si të parat zgjedhje me karakter demokratik në historinë e popullit shqiptar, përfunduan me sukses. Mbi 93 për qind e votuesve i dhanë votat për kandidatët e Frontit Demokratik. Përpjekjet e reaksionit të brendshëm dhe ndërhyrja e presionet e qeverive amerikane e angleze për të penguar zhvillimin e zgjedhjeve e fitoren e kandidatëve të Frontit nuk patën sukses. Asambleja Kushtetuese, e dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit, e shpalli Shqipërinë më 11 janar 1946 Republikë Popullore. Me këtë akt u zgjidh përfundimisht çështja e formës politike të shtetit shqiptar. Në fushën ekonomike e shoqërore u ndërmorën një varg masash të rëndësishme me karakter demokratik e revolucionar që goditën rëndë pozitat ekonomike të borgjezisë dhe që shërbyen si një parapërgatitje për thellimin e revolucionit në rrugën socialiste.

* Enver Hoxha, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», f. 375.

Në fund të vitit 1945 politika anglo-amerikane për ta izoluar Shqipërinë pësoi një të çarë të madhe. Përveç Bashkimit Sovjetik, Qeverinë Demokratike e njohën dhe lidhën marrëdhënie diplomatike me të Polonia, Bullgaria dhe Franca. Shqipëria mori pjesë në Konferencën e Dëshpërblimeve dhe nënshkroi aktin përfundimtar të kësaj konference. Për herë të parë vendi ynë mernte pjesë në një konferencë ndërkombëtare dhe vihej përkrah kombeve të tjera antifashiste.

Diskutimi i kërkesës së Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit

Përpara politikës së jashtme të Partisë dhe të Qeverisë së RPSH në vitet e para të Çlirimit qëndronin dy detyra themelore: të luftonin për të siguruar të drejtat e ligjshme të vendit në arenën ndërkombëtare dhe t'u bënin ballë presioneve e komploteve të të dyja fuqive më të mëdha imperialiste të kohës, SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe shteteve që u shkonin nga pas. Këto dy aspekte ishin të lidhur njëri me tjetrin. Në vitin 1946 përpjekjet anglo-amerikane për të përmbysur pushtetin popullor u dendësuan së tepërmi. Brenda vendit reaksioni, i drejtuar nga misionet angleze e amerikane, ndërmori një sulm frontal në të gjitha fushat: politike, ekonomike, ideologjike e ushtarake. Në arenën ndërkombëtare SHBA-ja dhe Britania e Madhe e angazhuan veten në një fushatë të tërbuar antishqiptare, që arriti deri në provokacione të armatosura e në shkallë të gjerë kundër sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Shqipërisë.

Partia dhe Qeveria jonë ishin të ndërgjegjshme për të përballuar këtë politikë antishqiptare në të gjitha aspektet e saj, në fushën e brendshme dhe në arenën ndërkombëtare. Vështirë se mund të gjendet një konferencë apo mbledhje e një forumi ndërkombëtar gjatë vitit 1946 ku të mos jetë diskutuar çështja shqiptare dhe ku të mos jenë manifestuar qëndrimet antishqiptare të SHBA-së e të Britanisë së Madhe. Kjo politikë u duk që në sesionin e parë të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që filloi punimet më 10 janar 1946 në Londër. Përgatitja e këtij sesiioni i ishte besuar një komisioni të kryesuar nga ishsekretari amerikan i shtetit Stetinius. Më 20 dhjetor 1945 Qeveria Demokratike i kishte drejtuar një kërkesë këtij komisioni që Shqipëria të pranohet si anëtare në gjirin e Komunitetit të Kombeve të Bashkuara.*

Kjo ishte kërkesa e parë që bënte Qeveria shqiptare pas refuzimit që iu bë Shqipërisë nga ana e SHBA-së për të marrë pjesë në Konferencën e San-Franciskos. Më 16 janar 1946 ajo bëri kërkesën e dytë që Shqipëria të pranohet në OKB. Në të theksohej se «duke ripërsëritur kërkesën e saj, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë është e bindur se Asambleja e Përgjithshme, duke vlerësuar si duhet sakrificat shumë të mëdha të popullit shqiptar gjatë luftës së ashpër dhe të gjatë kundër fuqive të Boshtit, do të plotësojë kërkesën e saj». Në të njëjtën kohë aty deklarohet se vendi ynë ishte i gatshëm të merrte përsipër të gjitha detyrat që rridhnin nga Karta e Kombeve të Bashkuara.⁴⁹

Kërkesa e 16 janarit e Qeverisë sonë ndryshonte nga ato të parat vetëm në një drejtim.

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 215-216.

Ndërsa më parë ajo kërkonte që Shqipëria të pranohet në OKB si shtet themeltar i saj, tani pranimi shtrohet në kuadrin e dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara për pranimin e anëtarëve të rinj».*

Kërkesa për pranimin e Shqipërisë ndoqi rrugën e procedurës së zakonshme të parashikuar nga Karta. Ajo u parashtrua për shqyrtim në Këshillin e Sigurimit. Që këtu zunë fill dy qëndrime diametralisht të kundërta për çështjen e pranimin të Shqipërisë në OKB, që do të vazhdojnë të shfaqen për disa vjet me radhë. Nga njëra anë qëndronin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe e disa shtete të tjera kapitaliste, që ishin kundër pranimin të Shqipërisë në OKB, dhe nga ana tjetër Bashkimi Sovjetik dhe disa vende të tjera demokratike, që luftonin për pranimin e saj.

Në Këshillin e Sigurimit SHBA-ja dhe Britania e Madhe bënë çmos që diskutimi i kërkesës shqiptare të mos përfshihej në rendin e

* Çështja e pranimin të anëtarëve të rinj është një problem me shumë rëndësi për Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Si i tillë ai është paraparë dhe nga Karta e OKB-së, nga rregulloret e brendshme, të Këshillit të Sigurimit dhe të Asamblesë së Përgjithshme. Lidhur me këtë, paragrafi i parë i nenit 4 të Kartës parashikon se «mund të bëhen anëtarë të Kombeve të Bashkuara të gjitha shtetet e tjera paqedashëse që pranojnë detyrimet e kësaj Karte dhe që, sipas gjykimit të organizatës, janë të afta dhe të gatshme për t'i përmbushur ato». Ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni thekson se «pranimi si anëtar i Kombeve të Bashkuara i çdo shteti që përmbush këto kondita bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme mbi rekomandimin e Këshillit të Sigurimit» (Charte des Nations Unies et Statut de la Cour International de Justice, f. 6).

Çështja e pranimin të anëtarëve të rinj i nënshtrohet një procedure të veçantë votimi si në Këshillin e Sigurimit ashtu edhe në Asamblenë e Përgjithshme. Në

ditës të punimeve të tij dhe të mos shqyrtohej fare në sesionin e parë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Këtë qëndrim e motivuan me pretekste, të cilat u rrëzuan nga përfaqësuesi i Bashkimit Sovjetik, Vishinski. Këshilli i Sigurimit u detyrua të merrte vendim që çështjen e diskutimit të kërkesës shqiptare ta vinte në rendin e ditës të punimeve të tij në një datë të afërt.

Qëndrimi i SHBA-së e i Britanisë së Madhe në Këshillin e Sigurimit ngjalli protesta të fuqishme dhe u prit me zemërim nga populli shqiptar. Kryetari i Qeverisë Demokratike, shoku Enver Hoxha, në intervistën e dhënë gazetës «Bashkimi» dënoi vendosmërisht këtë qëndrim armiqësor të SHBA-së e të Britanisë së Madhe.* Në mungesë të përfaqësuesit shqiptar në Këshillin e Sigurimit, intervista mori karakterin e një përgjigjeje zyrtare të Qeverisë së RPSH ndaj objeksioneve që ngritën anglo-amerikanët kundër pranimit të Shqipërisë në OKB. Aty vendosmërisht i pritej rruga çdo shprese që nëpër-

nenin 27 të Kartës së OKB-së është fiksuar mënyra e votimit në Këshillin e Sigurimit. Paragrafi i dytë i këtij neni thotë: «Vendimet e Këshillit të Sigurimit mbi çështjen e procedurës merren kur votojnë në favor 9 anëtarë». Ndërsa paragrafi i tretë i po këtij neni thekson se «Vendimet e Këshillit të Sigurimit mbi të gjitha çështjet e tjera konsiderohen të vlefshme kur merren me votat e 9 anëtarëve, midis të cilëve duhet të jenë votat e 5 anëtarëve të përhershëm» (Charte des Nations Unies et Statut de La Cour International de Justice, f. 17-18).

Në kohën kur diskutohej çështja e pranimit të Shqipërisë në OKB, numri i anëtarëve të Këshillit të Sigurimit ishte 11, ndërsa numri minimal i votave për të miratuar vendime të rëndësishme ishte 7, duke përfshirë dhe anëtarët e përhershëm. Me 17 dhjetor 1963 numri i anëtarëve të Këshillit të Sigurimit u shtua në 15.

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 238.

mjet presioneve e mohimit të të drejtave në arenën ndërkombëtare, anglo-amerikanët të gju-njezionin pushtetin popullor. «Shqipëria, — thek-sonte shoku Enver Hoxha, — duhet të jetë nga të parët e atyre kombeve që duhet të gëzojnë anëtarësinë e kësaj organizate dhe këtë të drejtë ajo e ka, jo për hatrin e ndokujt, por se e ka fituar me gjakun e bijve të saj më të mirë.»*

Refuzimi i SHBA-së e i Britanisë së Madhe për të vënë në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit kërkesën shqiptare motivohej nga arsye të tjera nga ato që u shpallën. Uashingtoni dhe Londra ishin të pakënaqura nga qëndrimi i mbajtur nga Qeveria shqiptare ndaj pretendimeve të tyre e sidomos nga mundësitë e pakta që u ishin krijuar misioneve angleze e amerikane në Shqipëri për të ushtruar veprimtarinë komplotiste kundër pushtetit popullor. Logjikë e fuqisë së madhe imperialiste nuk mund ta konceptonte qëndrësën e kundërshtimin e shteteve e të popujve të vegjël në mbrojtje të lirisë, të pavarësisë e të të drejtave të tyre të ligjshme. Përkundrazi, në Shqipëri, që në fillimet e saj si shtet me të vërtetë i pavarur, mori guximin t'u thotë ndal veprimeve antishqiptare të SHBA-së e të Britanisë së Madhe, ato u vërsulën me të gjitha metodat e mënyrat kundër saj. Xh. Kenani, një nga diplomatët më në zë të Departamentit të Shtetit, i rekomandonte sekretarit të shtetit Bërnz që ndaj Shqipërisë «... ne duhet të veprojmë shpejt dhe me forcë... duhet të jemi të përgatitur për të mbështetur protestat tona, në mënyrë decizive të shpejtë, me masa të tilla që regjimi në Shqipëri nuk mund të jetë dakord».⁵⁰ Dhe pasi të jenë provuar të gjitha mjetet e tjera

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 239.

të presionit, Kenani sugjeronte masën e fundit: tërheqjen e misionit amerikan nga Shqipëria.

Kur më 13 shkurt Këshilli i Sigurimit mori përsëri në shqyrtim kërkesën e Shqipërisë, Uashingtoni dhe Londra për të kundërshtuar pranimin e Shqipërisë, e gjetën të udhës që të ushtronin presion në një rrugë tjetër. Me nxitjen e tyre të drejtpërdrejtë ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë dhe kryetari i delegacionit grek në OKB, Rendis, më 12 shkurt, një ditë përpara diskutimit, i dërgoi një letër kryetarit të Këshillit të Sigurimit, Makin. Me anë të saj, ministri i Jashtëm grek, pasi e paraqiste Shqipërinë dhe popullin shqiptar në pajtim të plotë me agresionin që Italia fashiste ndërmoi kundër Greqisë në tetor 1940, kërkonte që të shtyhej shqyrtimi i kësaj çështjeje «deri në sesionin e ardhshëm të Asamblesë, me shpresë se deri atëherë marrëdhëniet normale mund të jenë vendosur midis dy vendeve.»⁵¹ Duke pasur parasysh, për sa u tha më sipër, — vazhdonte letra, — çështja e pranimin të Shqipërisë, fqinjët më të afërt, të Greqisë, në gjirin e organizatës prek në mënyrë të veçantë interesat e saj. Për rrjedhim, ministri i Jashtëm grek kërkonte që Këshilli i Sigurimit të ftonte Greqinë, sipas nenit 31 të Kartës, për të marrë pjesë në debatet që mund të ketë lidhur me këtë çështje. Kryetari i delegacionit grek e vinte në një plan Shqipërinë me Italinë e Musolinit dhe e quante atë po aq fajtorë sa edhe këtë të fundit. Sipas logjikës së tij, Shqipëria duhej të hynte në OKB pasi t'i ishte dhënë fund gjendjes së luftës që ekzistonte gjoja midis saj dhe Greqisë, gjendje kjo që do të përfundonte me nënshkrimin e një traktati paqeje.

Rendisi i shfaqti pretendimet e qeverisë së

tij më hapur dy ditë më vonë, më 14 shkurt, kur deklaroi se «midis Shqipërisë dhe Greqisë ekziston zyrtarisht gjendje lufte dhe ne dëshirojmë, që Kombet e Bashkuara të rregullojnë çështjen me anën e traktatit të paqes në bazë të parimeve të fituesve dhe të të mundurve.»⁵²

Qeveria Demokratike hodhi poshtë vendosmërisht pretendimet absurde të Rendisit dhe nxori në shesh synimet e vërteta të këtyre shpifjeve. «Qeveria e Athinës dhe zoti Rendis, ministër i Jashtëm i saj, — theksonte shoku Enver Hoxha në atë kohë, — përpiqet që popullin shqiptar ta bëjnë përgjegjës për Luftën Italo-Greke, ta vënë në një plan me Italinë fashiste dhe këtej të kërkojnë reparacione. «Shqipëria i ka deklaruar luftë Greqisë», gërthet fashisti Rendis për të forcuar tezën e tij qesharake të «Epirit të Veriut». Populli shqiptar kurrë nuk i ka deklaruar luftë Greqisë, përkundrazi, ai ka luftuar më mirë se kushdo, tjetër kundër italianëve dhe kuislingëve shqiptarë, autorë të këtij krimi».*.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar nuk mund të errësohej me akuza, me shpifje, apo me miqte të tjera. Populli shqiptar ishte ndër të parët që u ngrit në luftë kundër fashizmit italian. Kur Italia fashiste më 7 prill 1939 sulmoi e pushtoi Shqipërinë, SHBA-ia dhe Britania e Madhe nuk e ngritën zërin as edhe formalisht. Kurse paraardhësit e Rendisit me servilizëm i shprehën kënaqësinë B. Musolinit për pushtimin e Shqipërisë. Ish-kryeministri i asaj kohe, Metaksai, 4 ditë pas pushtimit të Shqipërisë, i shkruante Cianos: «Jam fare i bindur se asgjë nuk do të ndodhë në të ardhmen që të prishë miqësinë tradicionale që ekziston në mes dy vendeve dhe që një epokë e

* Enver Hoxha; Vepra, vëll. 3, f. 317.

re për zemërsie e bashkëpunimi... në mes tonë është duke filluar.»⁵³

Pikërisht ata me të cilët Metaksai shpresonte të zhvillonte më tej miqësinë, pak më shumë se një vit e gjysmë më vonë sulmuan Greqinë. Populli shqiptar nuk qëndroi indiferent, por e kundërshtoi Luftën Italo-Greke, ushtarët shqiptarë dezertuan nga fronti, aq sa ndikuan në disfatën e ushtrisë italiane, u kryen sabotime e manifestime kundër agresionit fashist dhe me qindra patriotë shqiptarë u hodhën burgjeve e kampeve të përqendrimit. Këto janë fakte të njohura dhe të pashlyeshme.

Letra e Rendisit ngjalli diskutime të shumta në Këshillin e Sigurimit. Debati u zhvillua rreth çështjes nëse kjo letër do të futej ose jo në dosjen e materialeve që kishin të bënin me çështjen e pranimit të Shqipërisë në OKB. Më në fund për kompromis u miratua sugjerimi i kryetarit të Këshillit të Sigurimit që të njoftohej qeveria greke zyrtarisht për marrjen e letrës dhe çështja e shqyrtimit të vlefshmërisë së saj të shtyhej deri atëherë kur do të shqyrtohej në themel çështja e pranimit të Shqipërisë në OKB.

Letra e Rendisit, që do të shërbente si argument për shtyrjen e diskutimit të kërkesës së Shqipërisë, u dogj. Një tjetër duhej t'i zinte vendin. Përfaqësuesit e SHBA-së e të Britanisë së Madhe u detyruan të futeshin përsëri në lojë, duke kërkuar të shtyhej shqyrtimi i kësaj çështjeje me pretekstin se Asambleja e Përgjithshme nuk do të kishte kohë të merrte në diskutim kërkesën e pranimit të Shqipërisë.⁵⁴ Truku anglo-amerikan binte në kundërshtim me rregulloren e Këshillit të Sigurimit. Ky, pasi kishte vendosur të vinte në

rendin e ditës shqyrtimin e kësaj çështjeje, disa ditë më vonë, nuk mund të merrte një vendim për ta tërhequr atë.

Pozita e vështirë, në të cilën u ndodhën, i detyroi Uashingtonin dhe Londrën të manifestonin hapur qëndrimin e tyre armiqësor ndaj Shqipërisë. Delegati britanik, Bevin, kërkoi që të shtyhej shqyrtimi i kërkesës shqiptare për në pjesën e dytë të sesionit të parë të Asamblesë së Përgjithshme. Ai tha: «Kërkesa e pranimit të Shqipërisë ngre çështje shumë delikate, që unë nuk kam ndër mend t'i diskutoj këtë mbrëmje... Në qoftë se unë do të jem i detyruar të shprehem këtë mbrëmje, do të më duhej të votoja kundër pranimit të Shqipërisë».⁵⁵ Më në fund Bevini, pasi këshilloi durim dhe tolerancë nga të tjerët, kërkoi që të vendosej sipas propozimit të tij. Delegati sovjetik Vishinski u ngrit kundër deklaratës së përfaqësuesit britanik dhe, duke iu përgjigjur thirrjes së tij për të arritur një marrëveshje që t'i kënaqte të gjithë, tha se «çështjet e këtij rangu nuk vendosen në planin e mirësjelljes personale. Unë do të doja të jepja prova të dashamirësisë kundrejt Bevinit, por jo me shpenzimet e Shqipërisë ose në dëm të interesave të saj».⁵⁶

Problemi shqiptar nuk ishte aspak i ndërlikuar sikundër dëshironin ta paraqitnin SHBA-ja e Britania e Madhe. Këshilli i Sigurimit i kishte të gjitha mundësitë që ta shqyrtonte që në atë seancë kërkesën e Shqipërisë dhe të votonte në favor të saj. Pas refuzimit lakonik të Bevinit «jo këtë mbrëmje», Vishinski u kërkoi përfaqësuesve anglo-amerikanë që të mos e ndërlikonin çështjen dhe, duke iu rikthyer delegatit britanik, përsëriti se: «Do të më pëlqente të tregohesha bujar me zotin Bevin, po ne nuk jemi mbledhur këtu

për bujarira personale, por për një çështje parimi dhe për interesat jetikë të një shteti.»⁵⁷

Kur nuk kishte mbetur më asnjë mjet pa u shfrytëzuar, u përdor ai i fundit, mekanizmi i shumicës së votave. Përfaqësuesi amerikan Stetinius propozoi që kërkesa e Shqipërisë për pranimitë qëndronte në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit, por shqyrtimi i saj të bëhej kur Këshilli i Sigurimit do të mblidhej në selinë e tij të përhershme në Nju Jork.⁵⁸ Ai kërkoi që propozimi i tij të vihej në votë. Në favor votuan SHBA-ja, Australia, Britania e Madhe, Kina, Brazili, Egjipti dhe Holanda, ndërsa Franca abstenoj. Kundër propozimit amerikan votuan Bashkimi Sovjetik, Polonia, dhe Meksika. Duke qenë se shtyrja e diskutimit ishte çështje procedure, që sipas paragrafit 2 të nenit 27 të Kartës kërkonte 7 vota pohuese të anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, propozimi amerikan u miratua.⁵⁹ Ishte më se e qartë se shtyrja për më vonë e diskutimit të çështjes shqiptare do t'u jepte mundësi SHBA-së e Britanisë së Madhe në të ngrinin pengesa të reja ndaj pranimit të Shqipërisë në OKB.

Votimi i parë i hapur anglo-amerikan kundër pranimit të Shqipërisë

Me qëndrimin që mbajtën në Këshillin e Sigurimit, Uashingtoni dhe Londra mendonin se i kishin dhënë një «mësim» të mirë Qeverisë shqiptare. Gjithashtu shpresoj se me një qëndrim të fortë do të mund t'i impononin asaj rishikimin e politikës së ndjekur deri në këtë kohë ndaj

SHBA-së e Britanisë së Madhe. Duke u nisur me këto paramendime, Departamenti i Shtetit në gjysmën e dytë të muajit shkurt i dërgoi një memorandum të ri Qeverisë shqiptare. Memorandumi që në fillim akuzonte Qeverinë shqiptare për qëndrim jomiqësor e joshoqëror ndaj SHBA-së e misionit amerikan në Shqipëri. Ai përmbante nota të theksuara demagogjike, të cilat synonin të përlligjnin qëndrimin e mbajtur në Këshillin e Sigurimit ndaj kërkesës shqiptare për pranim në OKB. «Për të hequr çdo mendim keqkuptimi, çka duket në mendje të autoriteteve shqiptare për pranimin e Shqipërisë në OKB, — thuhej aty, — kjo qeveri pohon se është plotësisht dakort që Shqipëria të fitojë anëtarësi në Kombet e Bashkuara...»⁶⁰ Pas kësaj tirade, memorandum i paraqiste në formë kërcënuese kushtet që diktonte SHBA-ja në këmbim të miratimit të kërkesës shqiptare. Qëndrimi përfundimtar që do të merrret nga SHBA-ja në këtë drejtim, theksohej në memorandum, do të varej nga vullneti i Qeverisë Shqiptare për të plotësuar detyrimet ndërkombëtare. Dhe sipas Departamentit amerikan, detyrimet që duhej të plotësonte Qeveria Shqiptare ishin para së gjithash pranimi i vlefshmërisë së traktateve e të marrëveshjeve të nënshkruara midis SHBA-së dhe Shqipërisë deri në vitin 1939.⁶¹

Kërkesat që përmbante memorandum i nuk ishin të reja. Ato ripërsëriteshin si presion i hapët që i bëhej Qeverisë sonë, për të pranuar e për të ligjëruar interesat imperialiste të SHBA-së në Shqipëri në shkëmbim të njohjes e të pranimit të Shqipërisë në OKB. Për cilindo shtet sovran e të pavarur do të ishte vdekjeprurës një pazar i tillë, aq më tepër për vendin tonë, që me kohë ka

genë trajtuar prej fuqive imperialiste si plaçkë tregu e monedhë këmbimi.

Qeveria e RPSH që në fillim veproi me kujdes, duke u nisur nga qëllimi që të mos cënoheshin interesat e vendit dhe të mos shkeleshin vendimet që ishin marrë në Kongresin historik të Përmetit, në maj të vitit 1944, mbi marrëveshjet dhe traktatet e pabarabarta që kishte nënshkruar qeveria zogiste me vendet kapitaliste. Për shkak se shumica e arkivës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë ishte djegur ose grabitur nga pushtuesit, Qeveria jonë nuk ishte në dijeni lidhur me hollësitë që përmbanin këto marrëveshje e traktate, prandaj, nëpërmjet letrës që ajo i dërgonte kryetarit të misionit amerikan më 13 nëntor 1945, u kërkonte autoriteteve amerikane kopjet e instrumenteve të këtyre traktateve ose marrëveshjeve.*

Departamenti i Shtetit e udhëzonte më 15 nëntor përfaqësuesin e vet në Tiranë, Fulcin, që t'i komunikonte Qeverisë shqiptare se qeveria amerikane dëshironte që ajo të njëjtte traktatet e mëparshme që s'kishin marrë fund ligjërisht, duke e paraqitur këtë çështje si një kusht për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Gjithashtu Fulci këshillohej të deklaronte se qeveria e SHBA-së «shpreson të presë sigurime përsa i takon statusit të këtyre instrumenteve sa më shpejt që të jetë e mundur»⁶² pasi kopjet e tyre të jenë në dispozicion të Qeverisë shqiptare. Më 17 nëntor, përfaqësuesi amerikan i bënte të njohur Qeverisë sonë pikëpamjen e mësipërme amerikane. Pasi u shkëmbyen edhe disa nota të tjera për këtë çështje, në janar 1946, Departamenti i Shtetit i njoftoi Qeverisë së RPSH përmbajtjen e traktateve e të marrëveshjeve dypalëshe të lidhura në vitet

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 178.

20-30 midis qeverisë amerikane e regjimit zogist dhe të traktateve e marrëveshjeve shumëpalëshe, në të cilat kishte aderuar edhe Shqipëria.

Kjo ishte gjendja e marrëdhënieve midis qeverisë amerikane e Qeverisë sonë lidhur me traktatet deri në mes të muajit shkurt, kur Departamenti i Shtetit e lidhi çështjen e pranimit të Shqipërisë në OKB me të qenët në fuqi të këtyre traktateve.

Në pranverën e vitit 1946 këto marrëdhënie rrokullisen poshtë e më poshtë. Revolucioni socialist në Shqipëri po thellohej nga dita në ditë në të gjitha fushat: politike, ideologjike, ekonomike e kulturore. Diktatura e proletariatit, me fshe-sën e saj të hekurt, po pastronte vendin nga tradhtarët, kriminelët dhe agjentët në shërbim të SHBA-së e të Britanisë së Madhe. Proceset gjyqësore, që u zhvilluan në këtë kohë kundër armiqve të popullit, sollën fakte të pakundërshtueshme për veprimtarinë agjenturore antishqiptare të misioneve anglo-amerikane.

Në shkurt-mars 1946 janë tri momente të rëndësishme në rrugën drejt ndërtimit të shoqërisë socialiste në Shqipëri: plenumi V i KQ të PKSH, Kushtetuta e Parë revolucionare dhe programi i Qeverisë së RP të Shqipërisë. Plenumi rishikoi në frymë kritike politikën e brendshme dhe të jashtme të partisë dhe të shtetit, dënoi pikëpamjet dhe praktikat e gabuara që ishin vërtetuar dhe bëri korrigjimet e duhura. Në mënyrë të veçantë plenumi u ndal në çështjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, SHBA-në dhe Britaninë e Madhe. Aty u dënuan pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës mbi qëndrimin ndaj këtyre tri fuqive të mëdha. Ai ishte për një hapje dhe orientim sa më të madh ndaj Përrëndimit, për lidhje të gjera ekonomike me të.

Në këmbim të njohjes së Qeverisë dhe të pranimit në OKB, ai propagandonte tezën e lëshimeve në favor të SHBA-së e të Britanisë së Madhe. Sejfulla Malëshova, në opozicion të hapët me shokun Enver Hoxha, kërkonte pranimin e traktateve që ekzistonin para Çlirimit midis SHBA-së dhe Shqipërisë.

Forcimi i diktaturës së proletariatit, shpallja e programit të ndërtimit socialist të vendit dhe lufta për thellimin e shndërrimeve revolucionare shoqërore e ekonomike ngjallën një valë të urrejtjeje për pushtetin popullor në radhët e armiqve të brendshëm e të jashtëm. Mbeturinat e reaksionit brenda vendit u përpoqën të sabotonin programin e ndërtimit socialist. Lufta e tyre u përqendrua në minimin e bazave të pushtetit popullor, në sabotime ekonomike, në akte terroriste kundër njerëzve të Partisë e të pushtetit popullor dhe në një agjitacion e propagandë të shfrenuar antisocialiste dhe antipopullore.

Rezistenca e armikut të brendshëm u shoqërua me një intensifikim të politikës anglo-amerikane për izolimin ndërkombëtar të Shqipërisë. Londra dhe Uashingtoni përdorën presione e kërcënime e deri provokacione të armatosura. Në fillim u la përshtypja sikur anglezët do ta njihnin Qeverinë shqiptare më shpejt se amerikanët. Bile Forin Ofisi njoftoi emrin e ministrit anglez që do të vinte në Tiranë dhe kërkoi edhe pëlqimin e Qeverisë sonë për të. Shkëmbimi i disa notave midis dy qeverive në muajt mars-prill u duk sikur i sheshoi pengesat për të lidhur marrëdhënie diplomatike midis dy vendeve. Po shumë shpejt u pa se njohja angleze për Qeverinë shqiptare nuk ishte veçse një bluf. Anglezët, ashtu si amerikanët, kërkonin të fitonin kohë për t'i gjetur anën fillit të çështjes

shqiptare. Se në çfarë drejtimi e kërkonin këtë fill, del qartë nga pohimi kërcënues i anëtarit të misionit ushtarak anglez Nil në momentin e largimit nga Shqipëria: «Ne do të kthehemi në një mënyrë tjetër».* Qëndrimin e vendosur e pa kompromis që Qeveria shqiptare mbajti ndaj kërkesave e presioneve angleze, në Londër e vlerësuan si «jomiqësor», «si mungesë dëshire për bashkëpunim» me përfaqësuesit britanikë në Shqipëri. Në fakt, konsiderata të tjera antishqiptare, tashmë të njohura, e shtynin ministrin e Jashtëm anglez Bevin që të deklaronte më 6 prill 1946 se «qeveria e madhërisë së tij ishte e mendimit që vendosja e marrëdhënieve diplomatike në kohën e tanishme me Qeverinë shqiptare nuk ishte e dobishme.» Qeveria angleze njoftoi Qeverinë tonë se ministri anglez në Tiranë nuk do ta merrte detyrën e tij dhe se asnjë përfaqësues diplomatik shqiptar nuk do të ishte i mirëpritur në këtë kohë në Londër. Epilogu i «njohjes» angleze është sa armiqësor aq edhe qesharak. Forin Ofisi njoftoi më 18 maj me një notë zyrtare se ministri anglez i akredituar në Tiranë do të drejtohej menjëherë në krye të detyrës së tij. Nuk kishin kaluar veçse 20 minuta dhe nota e mësipërme u tërhoq me pretekstin e një incidenti që u kishte ndodhur dy luftanijeve angleze tri ditë më parë në kanalën e Korfuzit, për «faj» të autoriteteve shqiptare. Diplomacia angleze, me famë për dinakërinë e saj, kësaj here nuk ishte në gjendje të fabrikonte veçse një komedi trashanike. Dhe një akt të tillë ajo do ta përsëriste në përmasa më të gjera pak muaj më vonë.

Ndryshe nga Forin Ofisi, Departamenti i Shtetit kishte paraqitur kushte më të studiuara, por shumë më armiqësore. Ai ishte kapur fort

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 5, f. 486.

pas çështjes së traktateve dhe e kishte shpallur vazhdimin e vlefshmërisë së tyre si një kusht «sine qua non» për t'u dhënë vizë problemeve ndërkombëtare lidhur me Shqipërinë. Ashtu si politika angleze, edhe ajo amerikane, në pranverë-verën e 1946-ës i shtoi thekset e saj antishqiptare. Zyrtarisht Uashingtoni deri në këtë kohë ishte rezervuar të shprehte hapur mbështetjen e tij ndaj pretendimeve territoriale të qeverisë greke për Shqipërinë e Jugut. Monarko-fashistët grekë kishin shpërthyer në këtë kohë një fushatë të tërbuar diplomatike pranë forumeve ndërkombëtare për të fituar përkrahje për orekset e tyre shoviniste dhe antishqiptare. Siç duket, në Uashington momenti u quajt i përshtatshëm për të bërë një veprim publik e zyrtar në favor të pretendimeve greke për Shqipërinë e Jugut. Me një gur vriteshin dy zogj. I bëhej me këtë rast një presion tjetër qeverisë shqiptare në një pikë nevralgjike dhe nxitej reaksioni grek në luftën e tij kundër forcave demokratike e revolucionare në Greqi si dhe kundër Shqipërisë e vendeve të tjera ballkanike. Në fund të muait mars, Komisioni i Punëve të Jashtme të Senatit amerikan miratoi një mocion ku theksohej që «Epiri i Veriut» t'i jepej Greqisë. SHBA-ja e Britania e Madhe këtë pretendim e shtruan për diskutim edhe në pjesën e parë të sesionit të dytë të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme, që u mbajt në Paris nga 25 prilli deri në 16 maj 1946.⁶⁵ Ministri i Jashtëm sovjetik, Molotovi, nuk pranoi të vihej në rendin e ditës diskutimi i një traktati të mundshëm midis Greqisë dhe Shqipërisë. Një problem i tillë nuk ekzistonte, nënvizonte ministri i Jashtëm sovjetik, ato që ekzistonin realisht ishin orekset e pakufizuara të disa qarqeve greke.⁶⁶

Qëndrimi antishqiptar i SHBA-së u manifestua edhe në çështjet e tjera ndërkombëtare që kishin të bënin me Shqipërinë. Kërkesës së Qeverisë sonë për të parashtruar pikëpamjen e saj para Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme, në lidhje me diskutimin e traktatit të paqes me Italinë, Uashingtoni, i ktheu përgjigje negative. Departamenti i shtetit theksonte se qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ishte në gjendje — të merrte iniciativën për këtë çështje, për shkak të qëndrimit që mbante regjimi shqiptar në fuqi ndaj përfaqësuesve të SHBA-së në Tiranë dhe të mungesës së dëshirës për të pranuar detyrimet normale, të kërkuara për njohje nga Shtetet e Bashkuara.⁶⁷

Në të gjitha instancat e forumet ndërkombëtare Shqipëria ndodhej përpara qëndrimeve armiqësore anglo-amerikane, të cilat në thelb ishin të njëjta, sepse frymëzoheshin nga po ato qëllime: izolimi i shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare dhe përmbysja e pushtetit popullor. Për SHBA-në dhe Britaninë e Madhe nuk kishte shumë rëndësi se ku diskutohej çështja shqiptare: në OKB, në Këshillin e Ministrave të Punëve të Jashtme, në Konferencën e Paqes apo gjetiu. E rëndësishme për ato ishte që të bllokohej zgjidhja e problemeve që i përkisnin Shqipërisë. Kudo anglo-amerikanët përsëritnin të njëjtat argumente, pavarësisht se ato mund të mos kishin lidhje me çështjet që diskutoheshin. Kështu më 14 maj 1946. dy ditë para mbylljes së pjesës së parë të sessionit të dytë të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme dhe tri ditë para fillimit të punimeve të Këshillit të Sigurimit, ku do të shqyroheshin kërkesat e ndryshme për t'u pranuar në OKB, midis të cilave edhe ajo e Shqipërisë, Departamenti i Shtetit i drejtoi një tjetër memorandum kërcënues

Qeverisë sonë. Meqenëse nuk ka marrë përgjigje nga regjimi shqiptar lidhur me statusin e traktateve, — thuhej në memorandum, — qeveria e SHBA-së mund ta gjykojë vetëm me dyshime të mëdha aftësinë dhe vullnetin e autoriteteve shqiptare për të përmbushur me mirëbesim përgjegjësitë ndërkombëtare.

Memorandumi amerikan i 14 majit donte të thoshte se kërkesa shqiptare për t'u pranuar në OKB në Këshillin e Sigurimit do të ndeshte përsëri në kundërshtimin e SHBA-së. Më 17 maj Këshilli i Sigurimit u mblodh përsëri dhe mori në shqyrtim kërkesat për anëtarësi në OKB. Deri në këtë kohë Shqipëria vazhdonte të ishte ende i vetmi vend që kishte paraqitur kërkesë. Sapo Këshilli i Sigurimit filloi nga diskutimi, përfaqësuesi amerikan Stetinius paraqiti një projekt-rezolutë, sipas së cilës kërkesat për anëtarësi që i kishin ardhur Këshillit të Sigurimit dhe që do t'i vinin deri më 15 korrik 1946, të shqyrtoheshin në seancat e gushtit, pasi t'i ishin dërguar më parë një komiteti të përbërë nga një përfaqësues për çdo shtet anëtar të Këshillit të Sigurimit.⁶⁸ Duke dhënë shpjegime për projekt-rezolutën e vet, Stetiniusi tha se deri në hapjen e Asamblesë së Përgjithshme me siguri do të ketë edhe kërkesa të tjera, prandaj ato duhet t'i kalojnë Komitetit të gjitha së bashku «për të lejuar një studim të thelluar, të rregullt dhe një shqyrtim të përbashkët të këtyre kërkesave».⁶⁹

Është e kuptueshme se prapa projekt-rezolutës amerikane për të shtyrë dhe një herë shqyrtimin e kërkesës shqiptare fshihej plani për të penguar Shqipërinë të zinte vendin e saj në OKB. Anglo-amerikanët, meqë zotëronin shumicën e votave në Këshillin e Sigurimit, arritën të si-

gurojnë miratimin e projektrezolutës në fjalë. Kërkesa e Qeverisë sonë i kaloi për studim Komitetit të Kërkesave, i cili duhej t'i paraqiste Këshillit të Sigurimit raportin e tij mbi këtë çështje deri më 1 gusht 1946. Më 24 korrik ky komitet vendosi që kërkesat për anëtarësi në OKB të shtyreshin për aq kohë sa do të shtyhej edhe hapja e pjesës së dytë të sesionit të parë të Asamblesë së Përgjithshme. Ndërkohë kërkesa për pranim kishin paraqitur edhe shtete të tjera, si RP e Mongolisë, Transjordia, Islanda, Portugalia, Suedia, Irlanda dhe Afganistani. Komiteti për studimin e kërkesave për anëtarësi në OKB i zhvilloi punimet nga 31 korriku deri më 20 gusht 1946. Ai vendosi që kërkesat e paraqitura nga shtetet e ndryshme të shqyrtoheshin sipas rendit kronologjik të tyre. Kërkesa e Shqipërisë do të ishte e para që do të shqyrtohej.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, për të ndjekur nga afër debatet në Komitetin e Kërkesave dhe në Këshillin e Sigurimit, i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së që të dërgonte një përfaqësues në Nju-Jork.⁷⁰ Pasi mori përgjigje pozitive, Qeveria jonë caktoi përfaqësuesin e saj.

Kërkesa shqiptare u bë objekt i një debati të zgjatur në Komitetin e Kërkesave. I nxitur nga anglo-amerikanët, përfaqësuesi i Greqisë në OKB në dy memorandume drejtuar Këshillit të Sigurimit radhiti përsëri shpifjet e mëparshme kundër Shqipërisë.⁷¹

Nuk është e rastit që memorandumet greke u dërguan në Këshillin e Sigurimit në këtë kohë. Ky akt ishte paraprirë nga një fushatë e dendur diplomatike, me takime e diskutime të shumta zyrtare të qeveritarëve grekë e anglo-amerikanë. Uashingtoni dhe Londra i kishin lënë të kuptonte

qeverisë së atëhershme greke se nga shkalla e angazhimit të saj kundër Shqipërisë do të varej edhe përkrahja anglo-amerikane për pretendimet e saj territoriale. Kryeministri grek Caldaris ishte takuar në Paris më 2 gusht me sekretarin amerikan të shtetit Berns dhe kryeministrin anglez Etli (Attlee) dhe kishte shprehur shqetësimin se pranimi i Shqipërisë në OKB do të ishte një ngjarje që do të siguronte tërësinë e saj territoriale dhe për rrjedhim edhe dështimin e pretendimeve greke ndaj Shqipërisë së Jugut.⁷² Anglo-amerikanët e siguruan Caldarisin se njohja e pavarësisë së Shqipërisë në traktatin e paqes me Italinë dhe anëtarësia e Shqipërisë në OKB nuk do të siguronin në asnjë mënyrë tërësinë territoriale të këtij vendi dhe nuk do të përjashtonin pretendimet greke.⁷³

Qëndrimet antishqiptare të anglo-amerikanëve dhe të monarko-fashistëve grekë ishin të kombinuara si në OKB ashtu edhe në Konferencën e Paqes. Uashingtoni dhe Londra që në mbledhjet e Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme ishin shprehur kundër regjistrimit të Shqipërisë në listën e shteteve fituese, si dhe kundër thirrjes së saj në Konferencën e Paqes me të drejta të barabarta ose me votë konsultative. Shqipërisë, viktimës së parë të fashizmit italian në Evropë, i bëhej në këtë rast një nga padrejtësitë më të mëdha. Ky veprim, që nuk ishte i pari, preku thellë ndjenjat e popullit shqiptar, shkaktoi një indinjatë të ligjshme ndaj gjithë atyre, që në mënyrë flagrante kërkonin të mohonin gjakun e derdhur për çlirimin kombëtar nga fashizmi. Manifestimet e zjarra popullore në të katër anët e Shqipërisë, të shoqëruara me kërkesat kombëngulëse të Qeverisë sonë, e detyruan kryetarin e konferencës, kryeministrin francez

Zh. Bido, ta shtronte kërkesën shqiptare për diskutim në seancën plenare të konferencës. SHBA-ja e Britania e Madhe edhe këtu manifestuan hapur qëndrimet e tyre antishqiptare. Përfaqësuesin anglez, lordin Aleksandër, një nga ushtarakët më të lartë anglezë që e njihte mirë Luftën Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe kontributin e tij në shpartallimin e forcave nazifashiste në Ballkan, detyra e diplomatit borgjez e lejonte dhe i jepte «të drejtë» të mohonte gjithçka. Dy «argumente» ngrinte feldmareshali anglez: «Shqipëria nuk është një komb aleat» dhe ajo «nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara»*.

Uashingtoni dhe Londra kërkonin t'i futnin problemet ndërkombëtare të Shqipërisë në një rreth vicioz, ku zgjidhja e gjithsecilit prej tyre kushtëzohej nga tjetri, ku mohimi i të drejtave në një çështje automatikisht mohonte edhe të tjerat. Kur u ngrit çështja e ftesës së Shqipërisë në Konferencën themeluese të OKB-së amerikanët u justifikuan se ajo nuk kishte karakterin e Konferencës së Paqes. Tani, për të penguar pranimin në këtë konferencë, ngrihej preteksti se Shqipëria nuk ishte anëtare e OKB-së. Por me gjithë kundërshtimet anglo-amerikane, konferenca, e ndodhur para fakteve të pashlyeshme, u detyrua të ftojë Qeverinë shqiptare që të marrë pjesë në punimet e saj me votë konsultative dhe për t'u dëgjuar në lidhje me Traktatin e Paqes dhe Italinë. Delegacioni shqiptar u kryesua në këtë konferencë nga shoku Enver Hoxha.

Fushata propagandistike dhe veprimtaria antishqiptare në Konferencën e Paqes e jashtë saj nuk mbeti pa ndikuar edhe në Komitetin e Kërkesave, disa anëtarë të të cilit nuk shpresonin të

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 5, f. 492.

gjenin rast më të volitshëm për të penguar diskutimin e kërkesës shqiptare për praninë në OKB. Përfaqësuesit anglezë e amerikanë, u munduan të argumentonin se Qeveria shqiptare nuk i plotësonte kushte e parashikuara nga neni 4 i Kartës. Përveç kësaj, delegati amerikan, duke folur në seancën e 5 gushtit ngriti çështjen e respektimit të traktateve nga ana e Qeverisë së RP të Shqipërisë.

Më 9 gusht Komiteti i Kërkesave iu drejtua delegacionit shqiptar në Nju-Jork me disa pyetje për t'i sqaruar, me qëllim që të lehtësohej gjoja raporti që do t'i dërgohej Këshillit të Sigurimit.⁷⁴ Komiteti i Kërkesave kërkonte të dinte se a e konsideronte Qeveria shqiptare veten e saj në gjendje lufte me Greqinë dhe në qoftë se ishte ashtu, si do të përfundonte kjo gjendje lufte sipas pikëpamjes shqiptare, se a ishte gati Shqipëria të pranonte rregullimin me anë mjetesh paqësore, ashtu si e kërkonte Karta për rastet kur paraqiteshin kërkesa territoriale ose kur kishte grindje midis shteteve. Ai kërkonte gjithashtu të informohej nëse u kishte dhënë fund Qeveria shqiptare traktateve që kishin ekzistuar midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera përpara 7 prillit 1939, dhe se cili ishte qëndrimi i saj kundrejt vazhdimit të traktateve dhe marrëveshjeve në fuqi gjer atëherë midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera, anëtare të Kombeve të Bashkuara. Komiteti pyeste se a mund të jepte informata Qeveria shqiptare mbi disa çështje të tjera që kishin tërhequr vëmendjen e tij. Më në fund komiteti kërkonte që të informohej mbi përfundimin e zgjedhjeve të përgjithshme të 2 dhjetorit 1945.

Më 14 gusht përfaqësuesi shqiptar i dërgoi Kryetarit të Këshillit të Sigurimit përgjigjen lidhur me pyetjet që i ishin drejtuar në datën 9

gusht.⁷⁵ Pozita e Qeverisë shqiptare ndaj këtyre problemeve ishte shprehur qartë në shumë raste. Megjithatë në përgjigjen e dhënë me këtë rast, përsëritej qëndrimi i Qeverisë sonë për këto çështje. Për tri pyetjet e para përgjigjen do ta jepte qartë shoku Enver Hoxha disa ditë më vonë në Konferencën e Paqes në Paris, ku do të deklaronte se «populli shqiptar flak poshtë me përbuzje akuzën poshtëruese të delegatit grek, që e padit vendin tim si sulmues. Populli shqiptar nuk e ka sulmuar kurrë popullin e ndershëm grek, nuk i ka shpallur kurrë luftë... Do të ishte qesharake të mendohej se një dekret i thatë i Viktor Emanuelit, mbretit të Italisë, do të mund të ngarkonte me faj popullin shqiptar, i cili luftonte pa mëshirë kundër Italisë që nga dita e parë e pushtimit...»*

Për sa i përket problemit të traktateve Qeveria jonë në disa dokumente zyrtare kishte shprehur arsyet që motivonin kundërshtimin e saj për të njohur vlefshmërinë e tyre. Megjithatë, e nisur nga dëshira e mirë për të ndihmuar sa më shumë në vendosjen e marrëdhënieve normale me vendet e tjera, ajo i rishqyrtoi edhe një herë, një për një, të gjitha traktatet dhe marrëveshjet e paraluftës. Më 13 gusht, një ditë përpara se përfaqësuesi ynë në Nju-Jork të jepte sqarimet për çështjet e ngritura në adresë të vendit tonë, Qeveria e RPSH i dërgoi Xhejkobsit, kryetarit të misionit amerikan në Shqipëri, përgjigjen e saj përfundimtare lidhur me traktatet. Duke qenë se traktatet dhe marrëveshjet shumëpalëshe nuk cenonin interesat e vendit, Qeveria shqiptare vendosi t'i pranonte ato. Për traktatet dypalëshe ajo shprehu gati-shmërinë që pasi të vendosnin marrëdhënie diplomatike, t'i merrte ato në shqyrtim së bashku me ministrin e SHBA që do të vinte në

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 433.

Tiranë dhe, pasi t'u bëheshin ndreqjet e nevojshme, ato mund të quheshin të vlefshme.* Departamenti i Shtetit nuk i ktheu përgjigje zyrtare propozimit të ri të Qeverisë shqiptare, duke e konsideruar atë të pakënaqshëm dhe se bëhej «vetëm për kërkesën e paraqitur nga Shqipëria për të qenë anëtare e Kombeve të Bashkuara, tani në shqyrtim në Nju-Jork.»⁷⁶

Lidhur me incidentin e dy anijeve britanike në ujërat tona bregdetare përgjigja shqiptare sqaroi se faktet ngarkonin me përgjegjësi të plotë palën angleze. Në këtë ditë dy luftanije, pa asnjë shenjë dalluese, hynë në ujërat tona territoriale, në bregdetin e Sarandës në drejtim të limanit. Komanda bregdetare në bazë të rregullave, dha shenjën e largimit dhe, pasi ajo nuk u mor parasysh, u detyrua që, për qëllime paralajmëruese dhe aspak dëmtimi, të qëllonte rreth e rrotull këtyre anijeve. Për këtë incident midis Qeverisë sonë dhe asaj angleze janë shkëmbyer disa nota.

Në notën drejtuar Qeverisë sonë, qeveria angleze mohonte faktin se më 15 maj luftanijet e saj ishin paralajmëruar nga rojat bregdetare shqiptare dhe pretendonte se ato ishin pajisur me flamur anglez. Ajo mundohej ta paraqiste kalimin e tyre në ujërat tona territoriale si një kalim paqësor. Më në fund pala angleze akuzonte Qeverinë shqiptare se nuk respektonte parimin e kalimit paqësor në kanalën e Korfuzit e në ujërat territoriale dhe e quante veprimin e drejtë të rojave tona bregdetare si një shkelje të rregullave ndërkombëtare.⁷⁷ Ajo kërkonte gjithashtu një deklaratë publike nga ana e Qeverisë shqiptare në të cilën t'i kërkohej falje qeverisë angleze si dhe dënimin e ashpër të njerëzve përgjegjës për këtë akt.⁷⁸

* Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 487-488.

Qeveria e RP të Shqipërisë në notën e saj drejtuar qeverisë angleze, më 21 maj, pasi shpjegonte rrethanat në të cilat ndodhi incidenti, deklaronte se ajo nuk kishte pasur kurrë për qëllim të godiste anijet britanike dhe se respektonte kalimin paqësor në kanalën e Korfuzit dhe në ujërat e tjera territoriale.⁷⁹ Por në të njëjtën kohë ajo nuk mund të pranonte kurrë që ujërat e skelës së Sarandës të konsideroheshin si vijë ndërkombëtare për lundrim. Pas kësaj qeveria britanike dërgoi edhe dy nota të tjera, një të më 29 maj dhe tjetrën më 2 gusht 1946. Në të parën qeveria angleze e quante «të pakënaqshme» përgjigjen shqiptare, ndërsa në të dytën kërcënonte se anijet britanike të luftës do të qëllonin kundër baterive bregdetare shqiptare në rast se ato i pengonin gjatë kalimit të tyre përmes kanalit të Korfuzit.⁸⁰ Qeveria e RPSH, në përgjigjen e saj, hodhi poshtë pretendimet dhe kërcënimet angleze dhe bëri propozime konkrete për rregullimin e lundrimit në kanalën e Korfuzit nëpërmjet bisedimeve. Qeveria angleze nuk iu përgjigj propozimit të Qeverisë sonë. Incidenti i 15 majit nuk ishte as i pari e as i fundit në vazhden e provokacioneve që kurdisnin anglo-amerikanët dhe veçat e tyre.

Për pyetjen e fundit që i ishte drejtuar delegacionit shqiptar, në përgjigjen e dhënë jepej një përmbledhje e rezultateve të zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, të cilat dëshmonin për përkrahjen dhe mbështetjen e fuqishme që populli shqiptar i jepte Qeverisë së tij dhe politikës së saj të brendshme dhe të jashtme. Për herë të parë në historinë e vet, populli shqiptar votoi lirisht për të zgjedhur përfaqësuesit e tij. Korrespondentët e shtypit të huaj, që kishin ardhur për të ndjekur nga afër zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, ki-

shin shkruar për karakterin demokratik të këtyre zgjedhjeve, për vullnetin e lirë të popullit për të zgjedhur Asamblenë Kushtetuese.*.

Përgjigjet shqiptare ishin të vendosura dhe të qarta. Pas debateve të ashpra, Komiteti i Kërkesave arriti në përfundimin se mbi bazën e dokumentacionit që ekziston, Këshilli i Sigurimit duhej të merrte në shqyrtim kërkesën shqiptare dhe të vendoste në seancat e ardhshme të tij.

Më 28-29 gusht Këshilli i Sigurimit filloi diskutimin për pranimin e anëtarëve të rinj në OKB në bazë të raportit të paraqitur nga Komiteti i Kërkesave.

E para për t'u shqyrtuar ishte kërkesa e Shqipërisë. Ende pa filluar diskutimi i saj, në skenë del përsëri pengesa greke. Përfaqësuesi i përhershëm i Greqisë, Dendramis, i kishte dërguar Këshillit të Sigurimit më 21 gusht një letër. Si në muajin shkurt, edhe kësaj radhe, me porosi të Athinës, ai kërkonte që të merrte pjesë në diskutimin e Këshillit të Sigurimit për shqyrtimin e kërkesës së Shqipërisë për t'u pranuar në OKB, sepse sipas tij kjo prekte interesat e vendit të vet dhe ishte në përputhje me nenin 31 të Kartës.⁸¹ Nuk ka dyshim se autor i kësaj letre nuk ishte vetëm përfaqësuesi grek. Nxitesit e saj ishin delegatët anglezë e amerikanë. Letra e Dendramisit ishte rezultat i prapaskenave të tyre në

* Vetë Xheikobsi në dy telegrame që i dërgonte Departamentit të Shtetit më 4 dhe 19 dhjetor, duke raportuar për zgjedhjet, konkludonte se «... këto zgjedhje u zhvilluan në mënyrë të kënaqshme dhe si rrjedhim duhen pranuar si një shprehje e vullnetit të shumicës së popullit shqiptar. Ky nuk është vetëm opinioni i këtij misioni (misionit amerikan - P. M), por gjithashtu edhe i shumicës së korrespondentëve të shtypit që erdhën në Shqipëri për të vëzhguar zgjedhjet, si dhe i misionit britanik këtu». (FRUS, 1945, vol. IV, Europe, Washington 1968, f. 77).

prag të hapjes së seancave të Këshillit të Sigurimit. Si e tillë ajo ishte e mbushur me shpifjet e trillimet e zakonshme antishqiptare.

Taktika amerikane e pengesave të tërthorta e anësore mbeti e pasuksesshme. Atëherë delegati amerikan Xhonson kërkoi që të vihej në votë propozimi i tij për të shtyrë deri në vitin e ardhshëm shqyrtimin e kërkesës për praninë të RP të Shqipërisë.⁸² Propozimi amerikan përbente një dhunim të rregullores së brendshme të Këshillit të Sigurimit. Duke u nisur nga ky fakt, delegacioni sovjetik kërkoi që të votohej së pari për kërkesën e Shqipërisë, e cila kishte 8 muaj që ishte paraqitur, në një kohë kur propozimi amerikan kishte vetëm 2 ditë.⁸³ Xhonsonit nuk i mbetej gjë tjetër veçse të manifestonte edhe një herë tjetër qëndrimin antishqiptar të SHBA-së. Ai u shpreh se do të votonte kundër kandidaturës së Shqipërisë dhe për të justifikuar këtë qëndrim bëri një deklaratë demagogjike. Nëpunësi i Departamentit të Shtetit u mundua të bindë dëgjuesit e tij se gjoja SHBA-ja ushqente një simpati të madhe për popullin shqiptar, se shpreonte ta shikonte Shqipërinë të përfaqësuar në gjirin e Kombeve të Bashkuara, se SHBA-ja nuk kishin asnjë arsye të kundërshtonin praninë e Shqipërisë etj. Pas kësaj hyrjeje deklarative mashtruese, vijën kushtet amerikane për praninë e Shqipërisë në OKB, që përbëjnë thelbin e deklaratës. «Ne, — tha Xhonsoni, — aktualisht kemi dyshime në lidhje me meritat e Shqipërisë, sipas termave të vetë Kartës. Në shpresojmë se këto dyshime do të zhduken në një kohë shumë të afërt nga një aksion pozitiv nga ana e Qeverisë shqiptare.»⁸⁴

Se për çfarë «aksioni pozitiv» e kishte fjalën përfaqësuesi i Uashingtonit nuk ishte vështirë të

kuptohej. Qeveria amerikane kërkonte që Shqipëria të hiqte dorë nga rruga e ndërtimit socialist dhe të lidhej me imperializmin amerikan, të pranonte diktatin dhe kushtet e tij skllavëruese. Debatet mbi pranimin e saj në OKB zhvilloheshin në një kohë kur po vazhdonte punimet edhe Konferenca e Paqes në Paris. Fakti është që edhe këtu SHBA-ja, Britania e Madhe e pasuesit e tyre ngritën po të njëjtat shpifje në adresë të Shqipërisë si në Këshillin e Sigurimit. Kjo ishte një provë tjetër që dëshmonte për sulmin e egër frontal që SHBA-ja dhe Anglia kishin ndërmarrë kundër Shqipërisë në këtë kohë. Në Konferencën e Paqes në Paris anglo-amerikanët arritën t'i mohonin përkohësisht Shqipërisë disa të drejta si për shembull atë për t'u quajtur «fuqishoqe» (puissance associée), kthimin e arit të grabitur, marrjen e dëmshpërblimeve nga Italia etj.

Politika imperialiste e mohimit të të drejtave të ligjshme të popujve të vendeve të vogla shfaqej më së miri në rastin e Shqipërisë. Ajo, në ato ditë të gushtit 1946, ishte angazhuar në një sulm të rreptë e në shkallë të gjerë kundër çdo problemi që lidhej me forcimin e pozitës ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Në Këshillin e Sigurimit të OKB-së manifstoheshin vetëm një nga drejtimitet e politikës antishqiptare të SHBA-së e të Britanisë së Madhe.

Kandidaturën e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit e mbështetën disa anëtarë të saj si Bashkimi Sovjetik, Polonia, Meksika, Franca e Brazili. Në favor të kërkesës shqiptare ata sollën argumente të plota që provonin se Shqipëria i kishte të gjitha kushtet për t'u bërë anëtare e Organizatës, se ajo ishte një shtet paqedashës, që dëshironte dhe ishte në gjendje të përmbushte

detyrimet që Karta u impononte anëtarëve të Organizatës.⁸⁵

Përfaqësuesi amerikan Xhonson dhe ai anglez Këdagën, si gjithnjë ishin në akord të plotë për çështjen shqiptare. Xhonsoni këmbënguli që **kërkesa e Shqipërisë të mos merrej në shqyrtim**, sepse, kërcënoi ai, «në qoftë se do të duhej të votoja tani, unë do të isha i detyruar të votoja negativisht».⁸⁶ Delegati anglez Këdagën mbështeti propozimin amerikan dhe theksoi se ishte i autorizuar të deklaronte se qeveria e tij nuk mund të mbështeste kërkesën për pranim të Shqipërisë, sepse kishte me Qeverinë e Shqipërisë një numër mosmarrëveshesh midis të cilave përmendte edhe incidentin e 15 majit 1946.⁸⁷

Pas këtyre deklaratave, votimi ishte një procedurë formale. Në favor të kërkesës së Shqipërisë votuan Bashkimi Sovjetik, Polonia, Franca, Meksika dhe Brazili; kundër Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Holanda. **Abstenuan Australia, Egjipti dhe Kina. Meqenëse nuk fitoi shtatë votat e nevojshme, duke përfshirë këtu** edhe ato të të pesë anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, kërkesa e RP të Shqipërisë për t'u pranuar në OKB nuk u miratua.⁸⁸ Rekomandimin e Këshillit të Sigurimit për t'u pranuar nga Asambleja e Përgjithshme në OKB e fituan vetëm Afganistani, Islanda dhe Suedia me dhjetë vota pro dhe një abstenim.⁸⁹

Ditën që Këshilli i Sigurimit votonte për kandidaturën shqiptare në OKB, në Konferencën e Paqes në Paris, me përkrahjen anglo-amerikane, vihej në rendin e ditës rivendikimi grek për Shqipërinë e Jugut. Një valë e re zemërimi e proteste përfshiu përsëri popullin shqiptar. Kuvendi Popullor, i mbledhur në një seancë e posaçme, protestoi me vendosmëri kundër vendimeve anti-

shqiptare të Konferencës së Paqes. Në Paris, më 16 shtator, shoku Enver Hoxha deklaronte solemnisht para përfaqësuesve të shtypit: «Kur populli shqiptar luftonte trimërisht kundër fashizmit, të tjerët i hidhnin lule, por kur erdhi koha që ai të kërkonte vendin e tij kaq shumë të merituar në OKB ose në Konferencën e Paqes, i hodhën gurë... Ne jemi një popull paqedashës, por ne nuk jemi nga ata që lejojmë të na marrin nëpër këmbë. Ne dimë t'i mbrojmë të drejtat tona, lirinë, pavarësinë, sovranitetin, integritetin tonë tokësor»*.

Politika e izolimit ndërkombëtar të Shqipërisë, që ndiqnin SHBA-ja dhe Anglia, nuk e trembte popullin shqiptar. Partia jonë me kohë e kishte bërë të qartë se forcimi i pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë do të bëhej në luftë të pandërprerë me imperialistët anglo-amerikanë dhe pasuesit e tyre. Pas votimit të gushtit, Uashingtoni e Londra hoqën dorë edhe nga taktika e mbulimit të kundërshtimeve të tyre ndaj pranimit të Shqipërisë në OKB. Këtë e tutje kandidaturës shqiptare për në OKB do t'i dilnin vështirësi e pengesa edhe më të mëdha. Partia dhe Qeveria jonë ishin të ndërgjegjshme dhe të përgatitura për t'i përballuar ato. Disa ditë para hapjes së pjesës së dytë të sesionit të parë të Asamblesë së Përgjithshme, më 17 tetor 1946, Kryetari i Qeverisë së RP të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, i dërgoi një telegram Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Trygve Li dhe për dijeni edhe Këshillit të Sigurimit. Aty, pasi vihej në dukje rezultati i votimit në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit më 29 gusht 1946 dhe përdorimi i vetos nga SHBA-ja dhe Anglia kundër të drejtës së Shqipërisë për t'u pranuar në OKB, theksohej: «Vendimi i lartpërmendur i Këshillit të Sigurimit është një vendim i padrejtë dhe jo i merituar për vendin tonë...».

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 447-448.

se populli shqiptar kërkon që «të vini çështjen e pranimit tonë në rendin e ditës të mbledhjes plenare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që do të mbahet së shpejti, të hiqet vetoja jo e drejtë që i është vënë pranimit tonë si anëtare efektive dhe Shqipëria të pranohet anëtare me të drejta të plota në atë organizatë të lartë.»* Në përfundim i bëhej e ditur Sekretarit të Përgjithshëm vendimi i Qeverisë shqiptare për të dërguar në OKB, me cilësinë e dëgjuesit, dy përfaqësues zyrtarë.

Qeveria jonë këmbëngulte në të drejtën e saj që Shqipëria të pranohet në OKB. Pasi u hap seanca plenare e Asamblesë së Përgjithshme, me 3 nëntor 1946 shoku Hysni Kapo, që ndodhej në Nju-Jork, kërkoi që të vihej në rendin e ditës të Asamblesë së Përgjithshme çështja e pranimit të Shqipërisë në OKB. Në letrën që ai i drejtoi Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, pasi tërhiqej vëmendja se Shqipëria nuk ishte thirrur ende në gjirin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ndonëse asaj i takonte e drejta që të merrte pjesë që në Konferencën e San-Franciskos, theksohej se «të ngulmohet që të mos pranohet Shqipëria në OKB do të thotë të harrosh me dashje që Shqipëria qe viktimë e parë e agresionit të armatosur të Italisë fashiste në Evropë, të premtën e zezë të 7 prillit 1939, do të thotë të harrosh rezistencën e armatosur e të paturtur të popullit shqiptar kundër agresionit, rezistencë që ngjalli një valë të thellë simpatie në të gjithë popullin demokratikë dhe liridashës».⁹⁰ Sekretari i Përgjithshëm Trygve Li u përgjigj se pa rekomandimin e Këshillit të Sigurimit nuk ishte e mundur që të fuste në rendin e ditës të Asamblesë së Përgjithshme një çështje të tillë.⁹¹

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 519.

Në bazë të nenit 60 të rregullores së brendshme të tij, Këshilli i Sigurimit i paraqiti një raport Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për praninë në OKB që kishin bërë tetë shtete. Asambleja e Përgjithshme e përcolli raportin për shqyrtim në Komisionin e Parë Politik. Çështja e pranimit të anëtarëve të rinj ngjalli këtu diskutime të gjata. Në mbështetje të kërkesës shqiptare përfaqësuesi i Bashkimit Sovjetik vuri në dukje ndihmën e madhe që dha Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore, përkrah shteteve të Koalicionit të madh Antifashist, dhe theksoi se «qëndrimi i Shqipërisë gjatë luftës tregon se ajo është e aftë të kontribuojë në mënyrë të efektshme në veprën e paqes të Kombeve të Bashkuara».⁹² Përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara dhe të Britanisë së Madhe dolën përsëri kundër kërkesës shqiptare, duke sjellë si argumente ato çka kishin paraqitur më parë në Këshillin e Sigurimit.

Asambleja e Përgjithshme, në bazë të raportit të paraqitur nga Komisioni Politik, më 19 nëntor 1946 adoptoi rezolutën me anën e së cilës i rekomandonte Këshillit të Sigurimit të merrte përsëri në shqyrtim kërkesat e RP të Shqipërisë, RP të Mongolisë, Transjordanisë, Irlandës dhe Portugalisë, për të cilat Këshilli nuk kishte dhënë mendim pozitiv.⁹³

Më 29 nëntor Këshilli i Sigurimit pranoi rekomandimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe ngarkoi përsëri Komitetin e Kërkesave që të rifillonte studimin e kërkesave të bëra dhe atyre që mund të bëheshin për në OKB. Me këto ngjarje merr fund edhe diskutimi i çështjes së pranimit të Shqipërisë në OKB në sesionin e parë të Asamblesë së Përgjithshme.

Populli shqiptar dhe Qeveria e tij nuk u lërhoqën. Qeveria jonë nuk pushoi së kërkuari të drejtën e ligjshme të saj për të përfaqësuar vendin në OKB. Ajo shprehte bindjen se «drejta jonë do të dalë në shesh dhe populli ynë do të shkojë në OKB, pse këtë të drejtë e ka fituar me gjak».*

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 3, f. 490.

KAPITULLI I DYTË

AKUZA DHE «ARGUMENTE» TË REJA KUNDËR SHQIPËRISË

Fushatë e shfrenuar antishqiptare në OKB

Në vjeshtën e vitit 1946 SHBA-ja dhe Britania e Madhe e dendësuan më tepër veprimtarinë armiqësore kundër shtetit të ri shqiptar. Në bashkëpunim me armiqtë e brendshëm, ata bënë përpjekje të reja për të minuar pushtetin popullor. Kështu, në shtator të 1946-ës reaksioni i brendshëm, me nxitjen e drejtpërdrejtë të reaksionit imperialist e të Vatikanit, ndërmori një goditje kundër qytetit të Shkodrës me qëllim që t'i hapte rrugën ndërhyrjes së armatosur anglo-amerikane. Kjo orvatje dështoi që në nismë të saj. Goditja e armiqve të brendshëm u përqëndrua edhe në ekonomi: Grupet sabotatore vepruan aktivisht në sektorin e naftës, në ndërtimin e urave, në Rubik e në Maliq. Aktivitetet të madh armiqësor zhvillonte në këtë kohë kleri reaksio-

nar, e sidomos ai katolik, i cili u bë strebuesi dhe furnizuesi me armatime e ndihmë materiale i organizatave kundërrevolucionare e bandave agjenturore.

Por në sajë të vigjilencës së pareshtur të Partisë, të organeve të pushtetit e të masave të gjera të popullit, grupet tradhtarë e sabotatore në shërbim të fuqive imperialiste që vepronin brenda në Shqipëri, u zbuluan dhe i kaluan drejtësisë popullore. Gjyqet kundër sabotatorëve dhe grupeve armiqësore nxorën në shesh lidhjet e vjetra dhe të reja të reaksionit të brendshëm e të agjentëve me misionet anglo-amerikane në Shqipëri, bashkërendimin e veprimeve të tyre për përmbysjen e pushtetit popullor. Në këto kushte misionit amerikan nuk i mbetej rrugë tjetër veç të kthehej mbrapsht. Uashingtoni, konsekuent në politikën armiqësore antishqiptare, u përpoq ta shndërronte tërheqjen e këtij misioni në një incident me karakter ndërkombëtar. Por plani amerikan dështoi në sajë të vendosmërisë së Qeverisë sonë.

Vjeshta e vitit 1946 dallohet për nga shkalla e lartë e veprimtarisë armiqësore të SHBA-së e të Britanisë së Madhe kundër Shqipërisë, kryesisht në dy drejtime: në fushën diplomatike dhe në atë ushtarake. Në Nju-Jork, krahas punimeve të OKB-së, kishte filluar edhe sesioni i tretë i Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha për t'i dhënë dorën e fundit traktateve të paqes me Italinë dhe me shtetet e tjera ish-aleate të Gjermanisë. Pas gjysmës së dytë të tetorit, për të ndjekur nga afër çështjet shqiptare të mbetura pezull nga Konferenca e Paqes, në Nju-Jork ndodhej një delegacion shqiptar i kryesuar nga shoku Hysni Kapo. Delegacioni shqiptar iu drejtua mbledhjes së Mi-

nistrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha dy herë, më 15 dhe 25 tetor. Në emër të Qeverisë shqiptare u kërkuua që Shqipërisë t'i caktohej shuma e dëmshpërblimeve që do të merrte nga Italia; t'i kthehej rezerva e arit e Bankës Kombëtare, që ishte depozituar në Romë dhe që ishte grabitur më vonë nga gjermanët; t'i dorëzoheshin kriminelët e luftës; t'i rikthehej materiali ushtarak i grabitur nga Italia dhe t'i njihëj e drejta për t'u konsideruar si fuqi-shoqe në zbatimin e Traktatit të Paqes me Italinë.⁹⁴ Mbledhjes iu parashtrua edhe kërkesa që një përfaqësues shqiptar të ftohej për të shprehur para saj mendimet e Qeverisë shqiptare për problemet në fjalë.

Më 13 nëntor 1946 këto dokumente iu bënë të njohura zyrtarisht ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha, por asnjë prej tyre nuk u diskutua dhe asnjë përfaqësues shqiptar nuk u ftua para Këshillit.⁹⁵ Megjithatë efekti i tyre u ndie në ditët e mëvonshme, kur Këshilli u mor gjerësisht me problemet shqiptare. Diskutimet u përqendruan kryesisht në dy çështje: në kërkesën e Shqipërisë për t'u konsideruar fuqi-shoqe në Traktatin e Paqes me Italinë dhe në të drejtën e saj për të marrë dëmshpërblime nga Italia. Për të kundërshtuar këto të drejta, anglo-amerikanët përsëri dolën me argumentet e konsumuara të së kaluarës, se Shqipëria nuk kishte nënshkruar Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, e për rrjedhim nuk ka qenë në gjendje lufte me shtetet e bllokut fashist.⁹⁶ Por përpara realitetit e fakteve të pakundërshtueshme, Këshilli në fillim të dhjetorit që i detyruar të njihë të drejtën e Shqipërisë për t'u cilësuar si fuqi-shoqe për sa i përkiste Traktatit të Paqes me Italinë. Po kështu, ndonëse shumë pak në kraha-

sim me dëmet e pësuar, Shqipërisë iu caktua shuma e dëmshpërblimeve që do të mirrte nga Italia.⁹⁷

Vlerësimi, ndonëse jo i plotë, i kërkesave të ligjshme të Shqipërisë në lidhje me Traktatin e Paqes me Italinë ishte një fitore në fushën e politikës së jashtme të Qeverisë sonë.

Ky fakt ishte një hap më tej drejt afirmimit gjithnjë e më të madh të të drejtave të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. SHBA-ja dhe Britania e Madhe e ndienin rritjen e kësaj tendence, që dalngadalë po e çante murin e tyre të izolimit diplomatik. Në fund të vitit 1946 Uashingtoni dhe Londra e humbën besimin për një përmbysje nga brenda të pushtetit popullor. Tani edhe karta e presioneve në fushën diplomatike nuk po i justifikonte shpresat e fillimit. Në kushtet e krijuara, anglo-amerikanët filluan të përpunonin taktika ushtarake, që parashikonin mundësinë edhe të një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë me forcën e armëve në Shqipëri.

Shtimi i veprimtarisë armiqësore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Britanisë së Madhe kundër Shqipërisë ishte pjesë e pandarë e tërë politikës që imperializmi ndërkombëtar ndërmori pas Luftës së Dytë Botërore kundër kampit socialist, komunizmit e revolucionit dhe që njihet me emrin «lufta e ftohtë». Në ballë të kësaj kryqëzate antikomuniste u vunë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kishin mobilizuar të gjitha mjetet «për të mposhtur socializmin, për të shuar lëvizjet çlirimtare revolucionare, për të luftuar ndikimin e madh të teorisë marksiste-leniniste dhe për të vendosur hegjemoninë e vet në botë.»* Shprehje e koncentruar e kësaj politike ishin «doktrina Truman» e «plani Marshall», të

* Enver Hoxha, «Imperializmi dhe revolucioni», f. 15.

shpallura nga Uashingtoni në vitin 1947. Të gjitha vendet e demokracisë popullore në atë kohë e ndien kush më shumë e kush më pak peshën e ndërhyrjes e të kompleteve anglo-amerikane kundër lirisë e sovranitetit të tyre. Por asnjëri prej tyre nuk u kërcënua nga Uashingtoni e Londra në atë shkallë sa Shqipëria, për t'u sulmuar ushtarakisht e për të përmbysur pushtetin popullor. Britania e Madhe ishte e para që mori përsipër të zbatonte ndaj Shqipërisë taktikën e presionit ushtarak. Në 21 shtator 1946 Admiraliati Britanik informoi kryekomandantin e forcave britanike në Mesdhe Uillis se «Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë është përsëri në konsideratën e qeverisë së madhërisë së tij, e cila dëshiron të dijë nëse Qeveria shqiptare ka mësuar të sillet. Informacioni kërkon nëse ndonjë anije nën komandën tuaj ka kaluar përmes kanalit të Korfuzit që nga gushti, dhe, në qoftë se jo, nëse ju kenë ndër mend ta bëni atë së shpejti.»⁹⁸ Një ditë më vonë Uillis përgjigjet se ende asnjë anije nuk e ka bërë itinerarin e mësipërm, «por qëllimi im është që admirali Kinahan në krye të «Mauricius» dhe i shoqëruar nga «Leander» dhe dy destroyerë ta bëjnë atë kur të nisen nga Korfuzi më 22 tetor».⁹⁹

Në atë ditë vjeshte dy kryqëzorë dhe dy destroyerë të flotës ushtarake detare britanike u larguan nga baza e tyre në ishullin e Korfuzit në drejtim të bregdetit shqiptar. Qeveria angleze me këtë inkursion të paramenduar të luftanijeve angleze synonte: a — të ushtronte një presion të hapur ushtarak për të përkulur Qeverinë shqiptare, b — të bënte një sondazh paraprak që më vonë mund të pasohej me një ndërhyrje ushtarake në shkallë të gjerë, c — të «krijonte» fakte

në mbështetje të qëndrimeve të saj antishqiptare në arenën ndërkombëtare.

Dy prej katër luftanijeve angleze, në afërsi të portit të Sarandës, ndeshën në mina të vendosura nën ujë dhe patën humbje në njerëz e në materiale. Qeveria angleze, që ishte «në pritë», e shfrytëzoi menjëherë ndodhinë. Gjatë muajve tetor-dhjetor 1946 ajo i dërgoi disa nota Qeverisë sonë, në të cilat e ngarkonte me përgjegjësi për ngjarjen e 22 tetorit.¹⁰⁰ Anglezët shpërthyen një fushatë të gjerë propagandistike, diplomatike e ushtarake. Më 12 dhe 13 nëntor, 30 luftanije britanike, të vendosura në formacion luftimi, u futën në ujërat territoriale shqiptare pa autorizimin e Qeverisë së RP të Shqipërisë, nën pretekstin e spastrimit të kanalit nga minat. Ky akt brutal i qeverisë britanike ishte i paramenduar dhe i destinuar për të arritur disa qëllime të caktuara, të cilat nuk ishin më të panjohura për Qeverinë tonë. Politikën angleze të kanonierave Qeveria jonë e demaskoi botërisht si një veprim kundër tërësisë territoriale dhe si një kërcënim të hapët kundër lirisë dhe pavarësisë së atdheut. Ajo protestoi tri herë pranë OKB-së për provokacionet e armatosura të luftanijeve angleze dhe kërkoi marrjen e masave të menjëhershme për t'i dhënë fund një veprimtarie të tillë.¹⁰¹

Qeveria britanike, e egërsuar nga qëndrimi i drejtë e i papërkulur i Qeverisë sonë, e vazhdoi më tej ofensivën diplomatike. Më 10 janar 1947 ajo paraqiti ankesën e saj në Këshillin e Sigurimit duke synuar ta cilësonte Shqipërinë si një vend që kërcënonte paqen dhe sigurimin ndërkombëtar.¹⁰² Meqenëse në Këshillin e Sigurimit blloku anglo-amerikan kishte shumicën e votave, qeveria angleze ishte e sigurt për miratimin e akuzës së saj kundër Shqipërisë. Më 18 shkurt

1947 ankesa britanike ishte në rendin e ditës të Këshillit të Sigurimit. Anglezi Këdagën parashitroi gjatë e gjerë pretendimet e qeverisë së vet ndaj Shqipërisë dhe kërkoi që Këshilli i Sigurimit të miratonte një projektrezolutë britanike që cilësonte Qeverinë shqiptare fajtores për ndodhinë e 22 tetorit. Një ditë më vonë shoku Hysni Kapo mori fjalën në Këshillin e Sigurimit. Me argumente e fakte bindëse ai hodhi poshtë akuzën angleze kundër Shqipërisë dhe provoi se provokacioni i Britanisë së Madhe në kanalën e Korfuzit ishte rrjedhim logjik i gjithë politikës së saj antishqiptare para dhe pas luftës.

Shoku Hysni Kapo zbuloi falsitetin e pretendimeve britanike dhe qëllimin e tyre për të mohuar «të gjitha të drejtat e pakundërshtueshme të Shqipërisë në gjirin e Kombeve të Bashkuara», dhe për ta izoluar «vendin tonë nga bota e jashtme, duke e quajtur atë një vend që kërcënon paqen dhe sigurimin».¹⁰³

Qeveria britanike pasi nuk mundi të siguronte miratimin e një rezolute që dënonte Shqipërinë, në sajë të mbështetjes së SHBA e të vendeve të tjera që i pasonin në Këshillin e Sigurimit, arriti të miratonte një rezolutë tjetër, e cila rekomandonte që të dy palët të parashtronin mosmarrëveshjen e tyre në Gjykatën Ndërkombëtare.¹⁰⁴

Numrit të akuzave anglo-amerikane kundër Shqipërisë në sesionin e dytë të Asamblesë së Përgjithshme iu shtua edhe një tjetër. Qeveria shqiptare ngarkohej me përgjegjësi për luftën civile që kishte shpërthyer në Greqi duke e akuzuar se ndihmonte me armë partizanët grekë.*

* Çështja greke nuk ishte një problem i panjohur për OKB-në. Ajo kishte filluar të merrej me të qysh në ditët e para të veprimtarisë së saj. Më 21 janar 1946 Qeveria Sovjetike kishte kërkuar diskutimin e çështjes

3. Shkaktarët kryesorë të situatës së nderë në Greqi ishin reaksioni grek, Britania e Madhe dhe SHBA. Në fillim të vitit 1947 SHBA-ja i vuri bërnylin ndikimit dhe sundimit të vetëm të Britanisë së Madhe në Greqi. Doktrina «Truman» e nxori Uashingtonin si lidërsipin e politikës imperialiste dhe në Ballkan, dhe solli një angazhim më të madh të tij për çështjet ballkanike në tërësi. Shqipëria tanimë i kishte ndër pasojat e politikës amerikane në Ballkan. Ajo pothuaj gjatë gjithë gjysmës së parë të vitit 1947 e më pas kishte qenë e akuzuar padrejtësisht në Këshillin e Sigurimit nga SHBA-ja dhe Britania e Madhe, në fillim për çështjen e incidentit të kanalit të Korfuzit dhe pastaj për çështjen greke. Por Londra dhe Uashingtoni nuk do të mjaftoheshin me kaq. Këshilli i Sigurimit ndodhej në prag të diskutimit të kërkesave për pranim në OKB. Shqipëria do të ishte përsëri një objekt akuzash anglo-amerikane. Rezoluta e 19 nëntorit 1946 e Asamblesë së Përgjithshme i rekomandonte Këshillit të Sigurimit rishqyrtimin e kërkesave për pranim në OKB të të gjitha atyre vendeve që kishin paraqitur kërkesë. Këshilli i Sigurimit,

greke në Këshillin e Sigurimit. Gjendja në Greqi në fillim të vitit 1946 ishte tepër e nderë. Lufta nacionalçlirimtare e popullit grek nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Greke nuk arriti të kurorëzohej me sukses, të çlironte vendin përfundimisht nga pushtimi i huaj dhe ta shndërronte Greqinë në një vend demokratik. Ende pa mbaruar lufta aty u futën forca të shumta ushtarake britanike për të vendosur përsëri në vend sundimin e reaksionit monarkofashist e të imperializmit. Këtë proces e ndihmuan shumë edhe gabimet e Partisë Komuniste Greke gjatë luftës e mbas saj.

Në pranverën e vitit 1946 në Greqi shpërtheu hapur lufta civile midis komunistëve dhe demokratëve nga njëra anë dhe reaksionit monarkofashist, të mbështetur nga anglo-amerikanët, nga ana tjetër. Për të mbuluar

pasi pranoi këtë rezolutë më 8 korrik 1947, vendosi të ngarkonte Komitetin për pranimin e anëtarëve të rinj që të shqyrtonte përsëri kërkesat e paraqitura nga RP e Shqipërisë, RP e Mongolisë, Mbretëria hashemite e Transjordanisë, Irlanda dhe Portugalia dhe të paraqiste një raport deri më 10 gusht ose më shpejt.¹⁰⁵ Ndërkohë Këshilli i Sigurimit i kishte përcjellë Komitetit edhe kërkesat e paraqitura për pranimin e Hungarisë, të Italisë, të Rumanisë, të Jemenit, dhe të Bullgarisë.

Përsëri kërkesa e Shqipërisë u diskutua e para. Përfaqësuesit anglo-amerikanë dhe ata që i pasonin u përpoqën të vinin në dyshim karakterin paqësor të Qeverisë shqiptare duke servitur si «prova» incidentin e kanalit të Korfuzit dhe «dhunimin» e kufijve veriorë të Greqisë. Delegati anglez, pasi vuri në dyshim aftësinë e Qeverisë shqiptare për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga Karta si dhe gatishmërinë e saj për t'i përmbushur ato, theksoi se «për sa i përket kërkesës për pranim ka vend për të shqyrtuar qëndrimin e Qeverisë shqiptare.»¹⁰⁶

Ndryshe nga një vit më parë, me akuzat e SHBA-së e të Britanisë së Madhe u bashkua edhe

gjurmët dhe shkakun kryesor të kësaj lufte, SHBA-ja Britania e Madhe dhe qeveritë e atëhershme të Athinës akuzuan për veprimtari agresive kundër Greqisë fqinjët e saj të Veriut e sidomos Shqipërinë dhe e ngritën çështjen në Këshillin e Sigurimit. Më 19 dhjetor 1946 Këshilli i Sigurimit vendosi krijimin e një Komisioni për të hetuar shkakun e vërtetë të luftës dhe të turbullirave në Greqi. Me gjithë që Komisioni hetimor u vu para fakteve të pakundërshtueshme që zbulonin shkaktarët e vërtetë të luftës civile në Greqi, shumica anglo-amerikane miratoi një raport, sipas të cilit Shqipëria ishte përgjegjëse për situatën që ekzistonte në Greqi dhe se gjoja ndihmonte partizanët grekë. (CSPVO, Deuxième année, Supplement special, Nr. 2, vol. I, New-York, 1947, f. 63).

Franca. Ndryshimi i qëndrimit francez ndaj kërkesës së Shqipërisë për pranim nuk ishte i lidhur me incidentin e kanalit të Korfuzit, as edhe me çështjen greke, të cilat gjoja ngarkonin me përgjegjësi Qeverinë shqiptare — siç u shpreh delegati francez.¹⁰⁷ Shkaku duhet kërkuar në ndryshimin e politikës së jashtme të Francës. Në vitin 1947, si rrjedhim i forcimit të pozitave të forcave reaksionare brenda vendit, qeveria franceze u bashkua hapur me qeveritë amerikane e angleze kundër Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera të demokracisë popullore.

Asnjë pretekst dhe asnjë akuzë, sado e stërholluar dhe e manipuluar, nuk mund të fshihte të vërtetën, se qëndrimi i Qeverisë sonë ndaj politikës imperialiste të SHBA-së e të Britanisë së Madhe ishte arsyeja kryesore që bënte të kundërshtojë kërkesa e Shqipërisë për t'u pranuar në OKB. «Që Shqipëria i ka të gjitha kushtet për të qenë anëtare e Kombeve të Bashkuara, bile edhe më tepër se shumë pjesëtarë të kësaj Organizate, — shkruante ato ditë shoku Enver Hoxha, — kjo s'ka asnjë diskutim. Këtë të vërtetë e diskutojnë vetëm amerikanët, anglezët, francezët dhe të gjitha ato qeveri që janë krijesat e politikës imperialiste anglo-amerikane.»*

Më 18 gusht 1947, Këshilli i Sigurimit mori në shqyrtim raportin e Komitetit të Kërkesave. Kryetari i Këshillit të Sigurimit, përpara se të fillonte diskutimi, theksoi se do të dëgjoheshin me dëshirë të gjitha delegacionet, pikëpamja e të cilave kishte ndryshuar që nga seancat e Komitetit të Kërkesave ose në kishte një modifikim të pikëpamjeve a të qëndrimit të tij.¹⁰⁸ Për sa i përket qëndrimit të anëtarëve të Këshillit të Si-

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 4, f. 159.

gurimit ndaj kërkesës së Shqipërisë për pranim, ai propozoi që në qoftë se nuk kishte asnjë ndryshim në këtë drejtim, Këshilli nuk kishte dëshirë të diskutonte këtë çështje përsëri.¹⁰⁹

Megjithatë rreth kërkesës shqiptare u zhvillua një debat i shkurtër. Ajo gjeti mbështetjen e delegacioneve të Bashkimit Sovjetik, Polonisë e Sirisë. Anglezi Këdagën, pasi ripërsëriti akuzat tashmë të njohura, arriti në përfundim se «në këto kushte qeveria ime nuk mund të jetë dakord me pranimin e Shqipërisë në gjirin e OKB-së».¹¹⁰ Përfaqësuesi amerikan Xhonsn parashtroi qëndrimin negativ të qeverisë amerikane, që frymëzohej përveç pretekseve të mësipërme të qeverisë angleze edhe nga akuza se gjoja «Qeveria shqiptare nuk respekton detyrimet ndërkombëtare që e lidhin Shqipërinë me vendet e tjera para luftës.»¹¹¹

Në përfundim të diskutimit kërkesa e Shqipërisë për pranim në OKB u hodh në votë. Votuan në favor të saj Bashkimi Sovjetik, Polonia, Siria; kundër Australia, Belgjika, SHBA-ja dhe Britania; abstenuan Brazili, Kina, Kolumbia dhe Franca.¹¹² Në këtë seancë u pranuan vetëm kërkesat e Jemenit dhe të Pakistanit.

Votimi i dytë negativ anglo-amerikan ndaj kërkesës së Shqipërisë ishte rrjedhim logjik i gjithë politikës që ndiqnin këto dy fuqi të mëdha imperialiste ndaj Shqipërisë pas luftës. «Një përfundim i tillë votimi, në Këshillin e Sigurimit, për sa i përket kandidaturës së vendit tonë, — shkruante tri ditë më vonë shoku Enver Hoxha, — nuk është për popullin tonë një gjë e papritur. Ai njohu më mirë miqtë dhe aleatët që i duan të mirën dhe e mbrojnë dhe, nga ana tjetër, pa qartas qëllimet e imperializmit amerikan dhe anglez dhe politikën e tyre skllavëruese dhe anti-

demokratike ndaj vendit tonë dhe ndaj gjithë popujve përparimtarë të botës.»*

Qëndrimi i qeverisë së SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe ndaj kërkesës së Shqipërisë frymëzohej edhe nga qëllime të tjera, përveç atyre të natyrës së drejtpërdrejtë antishqiptare. Imperializmi amerikan pas Luftës së Dytë Botërore ishte hedhur në një ofensivë të përgjithshme ideologjike, politike, ekonomike e ushtarake kundër vendeve socialiste, kundër lëvizjes revolucionare, nacionalçlirimtare e demokratike dhe luftonte për të realizuar sundimin e vet botëror. Kjo politikë dhe synimet e saj manifestoheshin në OKB nga përfaqësuesit anglezë e amerikanë dhe aleatët e tyre. SHBA-ja dhe Britania e Madhe përpiqeshin që ta kthenin OKB-në në një Lidhje të dytë të Kombeve, në një vegël që do të mund të përdorej për të maskuar e për të ligjëruar ndërhyrjen dhe agresionin imperialist kundër popujve e vendeve sovraane, në një instrument pa jetë e të paaftë për të realizuar misionin për të cilin ishte krijuar. Për t'ia arritur këtij qëllimi SHBA-ja dhe Britania e Madhe synonin të krijonin klientelën e tyre në OKB, ta shndërronin atë në një klub, ku mund të hyje vetëm me fletëhyrjen e miratuar nga Uashingtoni e Londra. Anglo-amerikanët, — theksonte shoku Enver Hoxha, — «përpiqen që të kenë sa më tepër klientë të votës në OKB dhe sa më pak pjesëtarë mbrojtës të vërtetë dhe luftëtarë të paepur kundër fashizmit dhe agresionit. Këtu ishte qëllimi i votës kundër kandidaturës së Shqipërisë»**.

Me këto plane shkonte qeveria amerikane, kur, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Këshillin e

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 4, f. 158-159.

** Po aty, f. 163.

Sigurimit, më 21 gusht 1947 kërkoi që të miratohej një projektrezolutë sipas së cilës të pranoheshin në OKB të gjitha ato shtete për të cilat Asambleja e Përgjithshme mendonte se plotësonin kushtet e duhura.¹¹³ Thelbi i propozimit amerikan ishte që duke shfrytëzuar shumicën në Asamblesë të Përgjithshme të miratoheshin vendimet për të pranuar në OKB vetëm shtete kapitaliste.*

Në sesionin e dytë të Asamblesë së Përgjithshme u ndie në mënyrë të veçantë këmbëngulja anglo-amerikane për pranimin e Italisë në OKB. Italia dhe katër vendet e tjera që kishin paraqitur kërkesë për pranim, Bullgaria, Rumania, Hungaria dhe Finlanda, kishin qenë pjesëtarë të bllokut fashist në Luftën e Dytë Botërore. Si fuqi të mundura ato u detyruan të nënshkruanin traktatet e paqes në shkurtin e 1947-s. Pas këtij akti, ato, në përputhje me marrëveshjen e arritur midis SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik në Potsdam në gushtin e 1945-s,

* Propozimi amerikan ishte në kundërshtim me procedurën që ndiqej për pranimin e anëtarëve të rinj. Në Asamblesë të Përgjithshme SHBA kontrollonin shumicën dhe nuk e kishin të vështirë të grumbullonin dy të tretat e votave, në rastin e diskutimit të kërkesave të shteteve kapitaliste. Projektrezoluta amerikane ishte në kundërshtim të hapët me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe në veçanti me paragrafin e dytë të nenit 4 të saj. Karta dhe rregulloret e brendshme të Këshillit të Sigurimit e të Asamblesë së Përgjithshme shprehnin qartë procedurën që duhej ndjekur për pranimin e anëtarëve të rinj. Aty ishte parashikuar që kërkesat në fillim do të shqyrtoheshin nga Këshilli i Sigurimit, i cili i adresonte rekomandimet e tij Asamblesë së Përgjithshme, që vetëm pas kësaj merrete një vendim. Në përfundim të seancës së 21 gushtit 1947 projektrezoluta amerikane u hodh poshtë.

mund të paraqisnin kërkesat për t'u pranuar në OKB.

SHBA-ja, Britania e Madhe dhe disa vende të tjera kapitaliste kërkonin që, ndër shtetet të cilat kishin nënshkruar traktatet e paqes, të pranohej vetëm Italia. Kjo ishte në kundërshtim me marrëveshjen e arritur në Potsdam midis tri fuqive të mëdha, ku ishin marrë angazhime të njëjta për t'i përkrahur kërkesat e këtyre vendeve për pranim në OKB. Pranimi i këtyre shteteve në OKB ishte një problem i vetëm dhe i pandarë, ato ishin në të njëjtat pozita, ndaj edhe çdo vendim që do të merrej do të zbatohej për të pesë vendet.

Qeveria amerikane dhe ajo britanike hoqën dorë edhe nga kriteri formal që ato zbatuan në lidhje me ftesat që u bënë në vitin 1945 për Konferencën themeluese të OKB-së. Për të zgjeruar klientelën e tyre në OKB dhe për të futur në të shtete kapitaliste të njohura për simpatinë e tyre ndaj fashizmit gjatë luftës, Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe kërkonin që për pranimin e anëtarëve të rinj në organizatë, të mos merrej më parasysh qëndrimi i tyre në Luftën e Dytë Botërore. Përfaqësuesi amerikan, Stivenson, në parashtrimin që i bëri këtij propozimi të qeverisë së tij deklaroi se «qëndrimi i një vendi gjatë luftës nuk përbën një kriter për pranim në Organizatë».¹¹⁴

Ky propozim vërtetoi edhe një herë tjetër qëndrimin pragmatist e të paprincipitë të SHBA-së e të Britanisë së Madhe në çështjen e pranimin të anëtarëve të rinj. Ndërsa nga njëra anë këmbëngulnin që në OKB të pranohej një vend ish-fashist dhe agresor siç ishte Italia, nga ana tjetër refuzonin dhe bënin çmos të pengonin pranimin e Shqipërisë, që kishte qënë viktimë e Italisë

fashiste dhe që kishte ndihmuar aq shumë në shpartallimin e fashizmit. Shqipëria ishte nënshkruese e traktatit të paqes me Italinë. Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme të fuqive të mëdha i kishte njohur asaj të drejtën e marrjes së dëmshpërblimeve nga Italia dhe e kishte njohur si «fuqi-shoqe» në lidhje me traktatin e paqes me të.

Bashkimi Sovjetik u shpreh kundër propozimit të SHBA-së. Vishinski theksoi se në një kohë kur tmerret e luftës nuk ishin shlyer ende nga kujtesa e popujve, shenja më e saktë e meritës së këtij apo atij shteti për t'u pranuar në OKB ishte sjellja e tij gjatë luftës.¹¹⁵ Si shembull për të argumentuar zbatimin e këtij kriteri, përfaqësuesi sovjetik përmendi kërkesën për pranim të Shqipërisë. Qeveria sovjetike, tha ai, kur vendosi të përkrahte kërkesën e Shqipërisë u bazua «mbi faktin se Shqipëria është aleatja jonë e përbashkët, se ajo ka marrë pjesë në luftën e Kombeve të Bashkuara kundër agresorëve fashistë.»¹¹⁶

Vishinski dënoi edhe një herë tjetër politikën e diskriminimit që ndiqnin SHBA-ja dhe Britania e Madhe në çështjen e pranimit të vendit tonë. Ai e cilësoi si një gjendje me të vërtetë të çuditshme faktin që Italia, e cila duhej t'i paguante dëmshpërblimet Shqipërisë për dëmet që i kishte shkaktuar gjatë luftës, do të pranohej në OKB, ndërsa Shqipëria e fyer, e poshtëruar, e prishur dhe e shkatërruar nga fashistët italianë, lihej jashtë dyerve të Kombeve të Bashkuara.¹¹⁷

Përfaqësuesit anglo-amerikanë, Mak Neil dhe Stivenson, si dhe pasuesit e tyre, refuzonin të miratonin kërkesën e Shqipërisë me akuzat tashmë të njohura e të përsëritura. Me ta, si gjithnjë u bashkua edhe delegati grek, Dendramis. Pasi radhiti të njëjtat akuza, që sipas tij bënin të pamundur

pranimin e Shqipërisë në OKB, përfaqësuesi grek vuri në dyshim edhe vlerën e deklaratave të SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe të Bashkimit Sovjetik në dhjetorin e 1942-shit, të cilat njihnin dhe çmonin luftën e popullit, shqiptar kundër fashizmit. Duke i riinterpretuar ato sipas logjikës monarko-fashiste, Dendramisi përfundonte se «deklaratat e bëra në dhjetorin e vitit 1942 nga sekretari i shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe nga personalitete të ndryshme u bënë për të favorizuar dhe inkurajuar një lëvizje të rezistencës në Shqipëri.»¹¹⁸

Deklarata e Dendramisit shtrembëronte të vërtetën historike. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar nuk filloi pas deklaratave që bënë tri fuqitë e mëdha në dhjetorin e 1942-shit, siç kishte dëshirë të shprehej përfaqësuesi grek. Përkundrazi, deklaratat e tyre u shpallën në një kohë kur Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare kishte marrë hov, ato u bënë nën ndikimin e kësaj lufte që zhvillonte me sukses populli ynë që më 1939.

Akuzat e Dendramisit pomposheshin fuqimisht nga anglo-amerikanët. Në strategjinë imperialiste të SHBA-së e të Britanisë së Madhe Ballkani duhej që edhe në të ardhmen të shërbente si fuçi baruti. Konflikti midis Greqisë dhe fqinjëve të saj veriorë ishte në përputhje me këtë strategji.*

* SHBA e ngritën çështjen greke drejtpërdrejt në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Më 23 shtator 1947, me propozimin amerikan u vendos në rendin e ditës të Asamblesë çështja e «kërcënimeve ndaj pavarësisë politike dhe integritetit territorial të Greqisë». Afro një muaj më vonë, me 21 tetor, Asambleja e Përgjithshme, shumica e së cilës manipulohet nga SHBA-ja, miratoi propozimin amerikan për krijimin e Komitetit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, e dominuar nga amerikanët, nuk ishte në gjendje t'u jepte zgjidhje problemeve në përputhje me Kartën. Me veprimtarinë e saj ajo nuk i shërbente çështjes së paqes e të sigurimit të popujve, por interesave imperialiste e hegjemoniste të SHBA-së. Votat e shumicës kapitaliste në Asamble shfrytëzoheshin nga Uashingtoni për të ushtruar presione mbi vendet që nuk i nënshtroheshin atij. Shqipëria ndodhej në radhën e atyre shteteve që nuk gëzonin «simpatinë» e SHBA-së. Delegati amerikan Stivenson, duke parashtruar edhe një herë tjetër arsyen për të cilën SHBA nuk miratonin pranimin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera në OKB, deklaroi se atyre nuk u pëlqejnë «veprimet e ndryshme të qeverive të atyre vendeve» dhe vetëm «disa ndryshime në jetën politike të atyre qeverive do të mund të influencenin qëndrimin amerikan në këtë çështje.»¹¹⁹.

Nuk ishte hera e parë që Shqipëria ndeshej me kërkesën këmbëngulëse të qeverisë amerikane për «ndryshime» në vijën e saj politike të brendshme e të jashtme, si kusht për t'u pranuar në OKB. Qeveria e RP të Shqipërisë i kishte hedhur poshtë vazhdimisht këto kërkesa, herë të sheqerosura e herë në formë ultimatumit. Shqipëria nuk mund të ndryshonte rrugën e saj në këmbim të një vendi në OKB. Qeveria jonë ishte

Ballkanin («United Nations Special Commission on the Balkan»). Qeveria e RP të Shqipërisë u shpreh kundër krijimit të këtij Komisioni. Ajo e cilësoi atë si një mjet për t'i imponuar vendime poshtëruese popullit shqiptar dhe vendeve të tjera demokratike të Ballkanit, si një organizëm që synonte të krijonte artificialisht një konflikt të rëndë dhe të ashpër në Ballkan, që e largonte OKB-në nga zgjidhja drejt e problemit grek dhe nga shqyrtimi i shkakut të vërtetë të situatës së rëndë në Greqi, e pikërisht nga ndërhyrja anglo-amerikane.

shprehur disa herë se herët, ose a vonë populli shqiptar do ta zinte vendin që meritonte në gjirin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Argumentet e shëndosha që u parashtruan në favor të kandidaturës shqiptare binin në vesh të shurdhët. Në organet e OKB-së gjithçka ishte e paravendosur. Ligjin aty e bënte shumica anglo-amerikane.

Në sesionin e dytë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u pa edhe një herë se kundërshtimi anglo-amerikan për pranimin e Shqipërisë në OKB ishte vetëm një aspekt i politikës antishqiptare të SHBA-së e të Britanisë së Madhe. Fushata e tyre për ta izoluar Shqipërinë në arenën ndërkombëtare po zgjerohej e po thellohej jo vetëm brenda OKB-së, por edhe në organizma të tjerë ndërkombëtarë. Por, frontit armiqësor anglo-amerikan populli shqiptar dhe Partia jonë i përgjigjeshin me një shtrëngim gjithnjë e më të fortë të radhëve të tyre, me vendosmëri e besim të madh në të ardhmen.

Mekanizmi i «shumicës» në shërbim të anglo-amerikanëve

Viti 1948 ka qenë një nga më të vështirët për Shqipërinë. Presioneve e bllokadës imperialiste iu shtua edhe veprimtaria e hapët armiqësore e Jugosllavisë titiste. Duhet thënë se deri atëherë Jugosllavia quhej si mike e Shqipërisë. Në forumet ndërkombëtare ajo kishte përkrahur të drejtat e ligjshme të Shqipërisë. Por politika jugosllave në mbështetje të kërkesave legjitime shqiptare kishte

domethënien e vet. Ajo, sikurse thekson shoku Enver Hoxha, «... në thelb ishte vetëm një bluf, një hile e madhe, një çark i maskuar me dafina e degë ulliri, por që nën gjethe fshihte dhëmbët e hekurt të armiqve të betuar të Partisë e të lirisë së atdheut tonë.»* Titistët, duke u përpjekur të siguronin njohjen ndërkombëtare të Qeverisë sonë, pranimin e vendit tonë në OKB ose mbrojtjen e të drejtave të tjera sovraane të popullit shqiptar, bënë «një njohje de jure të Shqipërisë për ta gllabëruar Shqipërinë de fakto».** Në projektet federative të Beogradit asaj i ishte caktuar statusi i republikës së shtatë.

Lufta e Partisë dhe e popullit shqiptar në mbrojtje të lirisë e pavarësisë së atdheut pas Çlirimit ka disa momente kulmore. Një prej tyre është edhe viti 1948. Dhe në mes gjithë atyre ngjarjeve që përbëjnë historinë e atij viti pa dyshim në ballë qëndron Kongresi I i Partisë në muajin nëntor. Ai sanksionoi kthesën historike në jetën e Partisë e të vendit. Kongresi dënoi grupin agjenturor projugosllav të Koci Xoxes, demaskoi ndërhyrjen e Jugosllavisë titiste në punët e brendshme të Shqipërisë dhe preu fijen e kompleteve të saj antishqiptare.

Kongresi I i Partisë dhe vetë kthesa që u realizua në jetën e saj e në atë të të gjithë vendit ishte një goditje e rëndë edhe për planet antishqiptare të SHBA-së e të Britanisë së madhe. Ai shpartalloi përfundimisht grupin tradhtar të Koçi Xoxes, që pavarësisht se nuk qe lidhur drejtpërsëdrejti me imperializmin anglez e atë amerikan, objektivisht vepronte në favor të synimeve të tyre kundër Shqipërisë. Uashingtoni

* Enver Hoxha, «Titistët» (Shënime historike), f. 210.

** Po aty, f. 212.

dhe Londra gjatë vitit 1948 e zbatuan edhe më me intensitet politikën e tyre të luftës kundër forcimit të pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë. Anglezët këmbëngulnin ta dënonin Shqipërinë në Gjykatën e Hagës si fajtorë për incidentin e kanalit të Korfuzit. Më 13 maj 1947 qeveria britanike në mënyrë të njëanshme e kishte ngritur çështjen në Gjyqin e Hagës. Ajo kishte kërkuar që Gjykata ta cilësonte Shqipërinë përgjegjëse për ndodhinë e 22 tetorit 1946 në kanalin e Korfuzit dhe pretendonte marrjen e dëmshpërblimit nga Qeveria shqiptare në shumën që do të përcaktonte Gjykata e Hagës.¹²⁰ Qeveria jonë, më 2 korrik 1947, nuk e pranoi këtë procedurë shqyrtimi të çështjes që ishte në kundërshtim edhe me vetë statutin e Gjykatës Ndërkombëtare.¹²¹ Ajo kërkonte prej Gjykatës shpalljen si të pavlefshme të ankesës britanike. Gjykimit të çështjes duhej t'i jepej vijim vetëm pasi të dyja palët në konflikt të kishin nënshkruar paraprakisht dokumentin e kompromisit, siç parashikonte edhe neni 36 i statutit të Gjykatës.

Këmbëngulja e Qeverisë sonë bëri që më në fund më 25 mars 1948 të nënshkruhej ky dokument për parashtrimin e konfliktit para Gjykatës së Hagës. Me aktin e kompromisit Shqipëria nuk shkante në gjyq si e akuzuar, por edhe si akuzuese. Gjykata ftohej të jepte mendimin e saj për dy pika: 1) sipas së drejtës ndërkombëtare, «është Shqipëria përgjegjëse për shpërthimet që ndodhën më 22 tetor 1946 në ujërat shqiptare dhe për pasojë edhe për dëmet e vdekjet e njerëzve dhe a është e detyruar të paguajë dëmshpërblime?». 2), sipas së drejtës ndërkombëtare, «Britania e Madhe e ka dhunuar sovranitetin e Republikës Popullore të Shqipërisë me veprimet e flotës luftarake britanike në ujërat shqiptare më 22 tetor

dhe më 12 e 13 nëntor 1946 dhe a ka vend për të dhënë satisfaksion?»¹²²

Gjykata e filloi shqyrtimin e procesit më 9 nëntor 1948 dhe e përfundoi me 9 prill 1949. Në këtë ditë ajo dha dhe vendimin e saj në lidhje me dy pyetjet e kompromisit të 25 marsit 1948. Në lidhje me pyetjen e parë Gjykata vendosi se Shqipëria ishte përgjegjëse për shpërthimet e ndodhura me 22 tetor 1946 në ujërat shqiptare dhe për pasojë edhe për dëmet e vdekjet e njerëzve.¹²³ Gjykata i njohu vetes të drejtën për të caktuar edhe shumën e dëmshpërblimeve. Vendimi i saj mbështeti akuzën e qeverisë britanike, e cila nuk mundej kurrësi të cilësohej si e argumentuar dhe e bazuar. Megjithatë për Gjykatën, ku shumica e anëtarëve të saj ishin përfaqësues të «drejtësisë së botës së lirë», nuk kishin shumë rëndësi faktet e dokumentet. Ajo ishte thirrur të ndihmonte në realizimin e synimeve politike të Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë. Ajo mori vendim për të shpëtuar «prestigjin» e fuqisë së madhe, por e ekspozoi veten hapur si një organizëm në shërbim të padrejtësisë e të anglo-amerikanëve, duke qëndruar kështu larg atij misioni që kishin marrë përsipër dhe larg atyre qëllimeve që ishin fiksuar në statutin e saj.

Për pyetjen e dytë Gjykata dha mendimin se me veprimet e flotës së saj luftarake me 22 tetor 1946, Britania e Madhe nuk e kishte dhunuar sovranitetin e Shqipërisë, ndërsa me veprimet më 12-13 nëntor ajo e kishte dhunuar atë.¹²⁴ Gjykata ishte e pazonja të hidhte poshtë akuzën shqiptare ndaj Britanisë së Madhe. Faktet që mbështetnin ankesën e palës shqiptare ishin të provuara dhe pa asnjë mëdyshje. Në këtë më-

nyrë ajo u detyrua të cilësojë Britaninë fajto-re për një akt, që ishte më se i zakonshëm në praktikën ndërkombëtare të Londrës.*

Gjyqi i Hagës rreth incidentit të kanalit të Korfuzit ishte një aspekt i fushatës anglo-amerikane për ta cilësuar Shqipërinë si një faktor turbullues për paqen dhe sigurimin në Ballkan. Aspekti tjetër i kësaj fushate ishte zhurma që po bëhej prej kohësh rreth «kërcënimit të parvarësisë dhe të integritetit territorial të Greqisë» nga Shqipëria e vendet e tjera fqinje, në veri të Greqisë. Në vitin 1948 akuzat anglo-amerikane gjetën vend edhe në raportet e Komisionit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Ballkanin (UNSKOB). Më 30 qershor 1948 UNSKOB-i i drejtoi Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së raportin e tij të «studimit».¹²⁵ Komisioni përbëhej vetëm prej shtetesh kapitaliste duke përfshirë këtu edhe SHBA-në, Anglinë dhe Francën. Bashkimi Sovjetik dhe Polonia kishin refuzuar të merrnin pjesë. Me një përbërje të tillë merrrej me mend se sa «i paanshëm» do të ishte raporti i paraqitur prej UNSKOB-it. Më 12 gusht 1948, mbi bazën e këtij raporti, u miratua rezoluta sipas së cilës Shqipëria dhe fqinjët e tjerë

* Gjykata Ndërkombëtare duke dashur t'i shkojë deri në fund çështjes në favor të anglezëve, në mënyrë arbitrare dhe jashtë kompetencave të saj, në dhjetorin e 1949-s, nxori një vendim që caktonte shumën e dëmshpërblimeve prej 843947 lira stërlina që Shqipëria duhej t'i paguante Britanisë së Madhe. Qeveria shqiptare e quajti të paligjshëm këtë vendim dhe refuzoi të paguante shumën e mësipërme. Në përgjigje të këtij qëndrimi, qeveria angleze, në bashkëpunim edhe me komisionin tripalësh të arit monetar (Angli, SHBA, Francë), bllokoi arin monetar shqiptar të grabitur në kohën e luftës nga Gjermania dhe që duhej t'i kthehej Shqipërisë. Qeveria angleze edhe sot e kësaj dite nuk e ka kthyer këtë shumë.

veriorë kërcënonin pavarësinë dhe integritetin territorial të Greqisë.

Qeveria shqiptare u njoh me këtë rezolutë nëpërmjet telegramit të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së më 14 gusht 1948. Ajo e quajti rezolutën të pavlefshme dhe e hodhi poshtë si një dokument të hartuar me paramendim, që synonte ta paraqiste gjendjen e rëndë të Greqisë si një vepër të shkaktuar nga të ashtuquajturat ndihma që u kanë dhënë forcave demokratike greke vendet fqinje.¹²⁶ Qeveria shqiptare ripohonte edhe një herë tjetër se ajo e quante UNSKOB-in dhe të gjitha aktet e tij të paligjshme dhe në kundërshtim me Kartën e parimet e OKB-së.

Çështja greke dhe raporti i UNSKOB-it zuri një pjesë të mirë të kohës së punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në sesionin e saj të tretë, që filloi në shtatorin e 1948-ës në Paris. Shumica anglo-amerikane vazhdonte të frynte mitin e «rrezikut» nga veriu për të mbuluar ndërhyrjen gjithnjë e më brutale të SHBA-së në Greqi. Sesioni i tretë i Asamblesë, me vendimet e tij, shpërndante mjegull për të maskuar këtë ndërhyrje. Më 27 nëntor 1948 ajo i dha vijim punës së UNSKOB-it. Po kështu miratoi edhe krijimin e një «Komiteti Pajtimi», me autor e kryetar të tij ministrin e Jashtëm të Australisë Evat. Një vit më vonë ky komitet do të reduktohej në një shtojcë të thjeshtë të UNSKOB-it.*

* Në një «studim» shumëfaqësh të titulluar «Greece and its Balkan neighbors (1948-1949). The United Nations attempts at conciliation» (Greqia dhe fqinjët e saj të veriut. Përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për pajtim-), amerikani Harry N. Howard, ish-anëtar i Komisionit të Hetimit dhe i Komisionit të Pajtimit, fajin për

Fushata e shpifjeve e SHBA-së dhe e Britanisë së Madhe kundër Shqipërisë krijonte vështirësi për zgjidhjen e problemeve shqiptare në arenën ndërkombëtare. «Lufta e ftohtë» ishte në lulëzim. Shqipëria, si vend socialist, do t'i ekspozohej pa tjetër kësaj lufte. Atmosfera e saj ndihej edhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ajo u manifestua hapur në mënyrë të veçantë në sesionin e tretë të Asamblesë së Përgjithshme.

Partia dhe Qeveria jonë ishin të ndërgjegjshme për vështirësitë e pengesat që i viheshin Shqipërisë në rrugën e afirmimit të të drejtave të saj ndërkombëtare nga ana e anglo-amerikanëve. Ato, si kudo, edhe në OKB, nuk u tërhoqën, por e vazhduan luftën. Me rastin e hapjes së sesionit të tretë të Asamblesë së Përgjithshme, Qeveria e RPSH ripërsëriti kërkesën e saj për praninë në OKB. Aty thuhej se pjesëmarrja e Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ishte një e drejtë legjitime e padiskutueshme e popullit shqiptar, se Republika Popullore e Shqipërisë ishte një shtet paqësor dhe demokratik, që si në politikën e brendshme ashtu dhe në të jashtmen kishte zbatuar me besnikëri parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe se kishte ndihmuar me të gjitha

dështimin e misionit të këtij komiteti ia ngarkon intran-sigjencës së Qeverisë shqiptare, që nuk pranonte asnjë diskutim apo formulim kompromisi për çështjen e kufirit greko-shqiptar. E vërteta është se për Qeverinë tonë çështja e rivendikimeve greke ishte një absurditet, të cilit tashmë i ishte dhënë përgjigje. Misioni i «Komitetit të Pajtimit» dështoi, sepse ai as që u mor me thelbin e problemit, me shkaqet e tij, që ishin ndërhyrja anglo-amerikane në Greqi dhe terrori monarko-fashist në vend.

forcat e saj për ruajtjen dhe forcimin e paqes e të sigurimit në botë. Në përfundim Qeveria jonë ritheksonte edhe një herë tjetër se duke ngritur kërkesën e saj për pranimin e Shqipërisë në OKB ajo pranonte dhe ishte e gatshme të përmbushte të gjitha detyrimet e Kartës.¹²⁷

Edhe në sesionin e tretë të Asamblesë së Përgjithshme kërkesa e Shqipërisë u diskutua në kuadrin e debateve për çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Në qoftë se Britania e Madhe për të vënë në jetë propozime apo plane të saj përdorte shpeshherë ndonjë anëtar të Komonuelthit britanik, Shtetet e Bashkuara me këtë rol kishin ngarkuar Argjentinën, njërin prej vendeve të «oborrit të prapmë» të saj. Përfaqësuesit e këtij vendi u bënë zëdhënësit më të zellshëm të pikëpamjeve amerikane në OKB. Prapa projektrezolutave diskriminuese, propozimeve, formulimeve e interpretimeve të errëta e sofiste do të gjendeshin gjithnjë përfaqësuesit e këtij vendi të Amerikës Latine. Në seancat e para plenare të Asamblesë së Përgjithshme Argjentina kërkoi që të vihej në rendin e ditës një pikë mbi pranimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara të të gjitha atyre shteteve kërkesat e të cilave për anëtarësi në OKB kishin fituar 7 vota në Këshillin e Sigurimit.

Çështja e pranimit të Shqipërisë në OKB u prek gjerësisht edhe në këtë sesion të Asamblesë së Përgjithshme. Përfaqësuesi i SHBA, Kohen, ripërsëriti akuzat e vjetra ndaj Shqipërisë dhe shfaqti dyshime në lidhje me oportunitetin e pranimit të saj në OKB. Ai theksoi se SHBA nuk do të kundërshtonin pranimin e Shqipërisë në rast se kjo do të pranonte rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të vitit 1948 mbi çështjen greke, e cila, e miratuar nga shumica anglo-

-amerikane, e deklaroi vendin tonë përgjegjës për gjendjen në Greqi.¹²⁸ Dhe ky pretekst i konsumuar paraqitej si pengesë për të pranuar kërkesën e Shqipërisë për anëtarësi në OKB, në një kohë kur, forcat monarko-fashiste greke, të udhëzuara nga anglo-amerikanët, kryen provokacione e ndërhyrje të armatosura në shkallë të gjerë në kufijtë e Shqipërisë. Që nga nëntori i 1944-ës deri në shtatorin e 1949-ës monarko-fashistët kishin bërë 1 565 provokacione kundër tokës shqiptare. Kulmi i kësaj politike provokuese arriti më 2 gusht 1949, kur tri batalione të ushtrisë monarko-fashiste greke, të përforcuara me artileri dhe aviacion, sulmuan në mënyrë të befasishme kufijtë e Shqipërisë së Jugut në sektorin e Bozhigradit. Repartet e ushtrisë greke vazhduan provokacionet e armatosura edhe në sektorët e Bilishtit, Leskovikut e Sarandës. Të nxitur nga këto provokacione, reaksioni i brendshëm dhe bandat diversioniste të ardhura nga jashtë e shtuan veprimtarinë e tyre armiqësore, jo vetëm në drejtim të përhapjes së parullave të ndryshme kundër pushtetit popullor, por edhe duke kryer akte terroriste. Këtë situatë e vështirësonte edhe veprimtaria provokuese dhe lëvizja e forcave ushtarake nga ana e revizionistëve jugosllavë në kufijtë veriorë e lindorë të vendit.

Në situatën e krijuar, kur po viheshin në rrezik liria, pavarësia dhe tërësia territoriale e atdheut, Partia dhe populli shqiptar u ngritën në këmbë për të mbrojtur atdheun dhe fitoret e socializmit. Kufitarët, së bashku me njësitet e Ushtrisë Popullore, jo vetëm që përballuan sulmet e monarko-fashistëve grekë, por me kundërmësymje i shpartalluan forcat agresive greke duke u shkaktuar shumë të vrarë e të plagosur.

Qeveria shqiptare protestoi në mënyrë energjike pranë OKB-së, duke i tërhequr vëmendjen sekretarit të përgjithshëm mbi përgjegjësinë e rëndë që binte mbi qeverinë e Athinës për këtë shkelje brutale të sovranitetit kombëtar të RP të Shqipërisë. Ajo theksonte se qeveria greke në mënyrë flagrante shkelte parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke vënë në rrezik mbrojtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar.¹²⁹

Qeveria jonë kishte hedhur poshtë dhe kish-te demaskuar akuzat dhe shpifjet e Uashingtonit e të Londrës. Veprimtaria e saj ishte në përputhje me parimet dhe qëllimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Ajo, që nga dita e parë e krijimit të OKB-së, kishte shprehur vullnetin e popullit shqiptar për të përfaqësuar vendin në këtë forum ndërkombëtar. Në shumë akte të njohura Qeveria jonë kishte deklaruar se prante të gjitha detyrimet e parashtruara nga Karta dhe ishte e gatshme t'i përmbushte ato. Së fundi një deklaratë të tillë ajo e pati bërë edhe në kërkesën e 13 tetorit të 1948-s për pranimin në OKB. Më 12 dhjetor Qeveria jonë ripërsëriti gatishmërinë e saj për të pranuar pa asnjë rezervë detyrimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe për t'i përmbushur ato që nga dita kur Shqipëria do të pranohet anëtare e Kombeve të Bashkuara.¹³⁰

Sesioni i tretë i Asamblesë së Përgjithshme, që i vazhdoi punimet edhe në vitin 1949, nuk arriti ta zhbllokojë ngecjen e pranimeve të anëtarëve të rinj në OKB, por e thelloi edhe më tepër gjendjen e turbullt që ekzistonte për këtë çështje. Dhe një gjë e tillë do të vazhdonte për sa kohë që SHBA-ja dhe Britania e Madhe do të zbatonin politikën e tyre obstruksioniste në

këtë forum ndërkombëtar. Organizata e Kombeve të Bashkuara pasqyrore antagonizmin klasor në shkallë ndërkombëtare, luftën midis forcave të imperializmit e të reaksionit dhe forcave të revolucionit, të socializmit e të demokracisë. Brenda pallatit prej xhami vendet kapitaliste vërtet kishin shumicën, por raporti i forcave në shkallë ndërkombëtare ishte në favor të revolucionit, të socializmit. Me fitoren e revolucionit popullor edhe në disa vende të tjera, socializmi kishte dalë nga kufiri i një vendi të vetëm. Lëvizjet nacionalçlirimtare të popujve të shtypur kishin marrë një hov të ri e të paparë. Imperializmi dhe reaksioni, nën goditjet e forcave revolucionare, ishin në tërheqje e në krizë. Kjo situatë, që ngjallte optimizëm e besim në fitoren e ardhshme, i shtynte e i frymëzonte vendet dhe forcat demokratike e revolucionare që të luftonin me vendosmëri kundër imperializmit e reaksionit në të gjitha drejtimet, të këmbëngulnin në realizimin e kërkesave të tyre të ligjshme ekonomike e politike, të brendshme e të jashtme. Me një ndjenjë të tillë besimi luftonin edhe Partia e Qeveria jonë brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare.

Sesioni i katërt i Asamblesë së Përgjithshme, si edhe sesionet e mëparshme, e pasqyruan këtë ndeshje interesash antagonistë edhe në një çështje të tillë si ajo e pranimit të anëtarëve të rinj në OKB. Kësaj radhe blloku anglo-amerikan vuri në veprim një makinacion të ri për të penguar pranimin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera demokratike popullore. Përfaqësuesit e këtij blloku propozuan që shqyrtimi i kërkesave për pranim të bëhej jo sipas rendit kronologjik domethënë, sipas vjetërsisë së kërkesës.¹³¹ Propozimi në fjalë nuk ishte thjesht një çështje pro-

cedure, por kishte të bënte me thelbin e problemit që ishte shtruar për diskutim. Shqyrtimi i kërkesave sipas rendit kronologjik sillte për diskutim para Këshillit të Sigurimit kërkesën e Shqipërisë, për të cilën anglo-amerikanët e kishin thënë fjalën e tyre prej kohësh. Ata kërkonin që t'i shmangeshin që në fillim vënies së vetos, sepse «argumentet» që kishin sjellë tashmë ishin vjetruar dhe nuk mund të mbulonin më armiqësinë e tyre ndaj Shqipërisë. Nga ana tjetër ato nuk donin që të përdornin të parët veton në një kohë kur deklarorin se ishin për heqjen e të drejtës së vetos gjatë shqyrtimit të kërkesave për pranimin e anëtarëve të rinj në OKB.

Ky propozim ishte në kundërshtim edhe me vetë rezolutën e miratuar nga Asambleja e tretë e Përgjithshme, e cila këshillonte që të gjitha kërkesat për pranim në OKB, për të cilat nuk ishte marrë ende asnjë vendim, duhej të shqyrtoheshin nga Këshilli i Sigurimit sipas rendit kronologjik. Mbi të gjitha, vetë Karta e Kombeve të Bashkuara e kishte bërë të qartë se të gjitha shtetet kandidatë duhej të trajtoheshin mbi bazën e barazisë, në masën që ato përmbushnin kushtet e parapara në nenin 4 të saj.

Bashkimi Sovjetik, në të kundërtën, bëri një propozim konstruktiv, miratimi i të cilit çonte në pranimin në OKB të shteteve që kishin bërë kërkesë. Delegati sovjetik dha mendimin që Këshilli i Sigurimit të shqyrtonte kërkesat e Shqipërisë dhe të 11 shteteve të tjera dhe t'i rekomandonte Asamblesë së Përgjithshme pranimin e tyre në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.¹³²

Propozimi sovjetik i vuri në pozitë të vështirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe fuqitë

e tjera imperialiste. Delegati amerikan Ostin u shpreh kundër projektrezolutës sovjetike, duke theksuar se «këto kërkesa duhet të shqyrtohen një nga një, sepse për secilën prej tyre ka rrethana të ndryshme që do të përcaktojnë vendimin që ne do të mund të marrim në përputhje me Kartën dhe nenin 60 të rregullores së brendshme të Këshillit të Sigurimit.»¹³³

Për të mbështetur propozimin e tyre, përfaqësuesit amerikanë iu referuan qëndrimit që mbante Bashkimi Sovjetik në çështjen e pranimi të anëtarëve të rinj në sesionin e parë të Asamblesë së Përgjithshme, kur përfaqësuesit sovjetikë ishin shprehur për shqyrtimin një nga një dhe jo në bllok të kërkesave të 8 shteteve, propozim ky i bërë në atë kohë nga delegati amerikan Xhonson. Tre vjet më vonë në pamje të parë dukej sikur qëndrimi i SHBA-së dhe i Bashkimit Sovjetik kishte ndryshuar 180 gradë. Tani Bashkimi Sovjetik mbronte pikëpamjen se pranimi i anëtarëve të rinj duhej bërë njëherësh, ndërsa SHBA mbështesnin tezën se pranimi duhej bërë një nga një.

Ky ndryshim ishte vetëm në formë. Në vitin 1946 SHBA ishin për pranimin e njëhershëm të tetë shteteve, sepse shumë prej vendeve kapitaliste që ishin propozuar nuk i përmbushnin ende kushtet e parashikuara nga Karta, dhe ndër tetë vende që kishin paraqitur kërkesë vetëm Shqipëria dhe RP e Mongolisë nuk gëzonin mbështetjen e SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe. Në vitin 1949 numri i vendeve që kishin bërë kërkesë dhe regjimi politik i të cilave nuk pëlqehet nga Uashingtoni, kishte arritur në pesë. Raporti midis këtyre shteteve dhe atyre kapitaliste, që kërkonin të pranoheshin në OKB, ishte ngushtuar shumë, (7:5).

Bashkimi Sovjetik e kishte modifikuar qëndrimin e tij në dy aspekte: ai kishte hequr dorë nga pranimi një për një i vendeve kandidatë dhe kishte përfshirë në listën për pranim edhe shtetet ish-fashiste ose përkrahëse të tyre. Ky ndryshim nuk donte të thoshte se qëndrimi i mëparshëm sovjetik ishte i gabuar. Në qoftë se Bashkimi Sovjetik këmbëngulte në sesionin e parë të Asamblesë së Përgjithshme që shqyrtimi i kërkesave të bëhej një nga një, kjo ndodhte se Këshilli i Sigurimit nuk kishte shqyrtuar veças asnjë nga 8 kërkesat për pranim. Pozita e re që mori delegacioni sovjetik nisej nga fakti se në vitin 1949 secila prej 12 kërkesave për pranim ishte shqyrtuar në mënyrë të veçantë dy herë e më shumë dhe njiheshin fare mirë meritat e gjithsecilit kandidat. Shqyrtimi i përbashkët i 12 kërkesave i vinte SHBA në një pozitë të vështirë, pse për hir të pranimit të shteteve që kishin mbështetjen e tyre, duhej të jepnin pëlqimin edhe për pranimin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore, dhe e kundërta, refuzimi për të pranuar këto vende do të kishte të njëjtat pasoja edhe për shtetet e klientelës anglo-amerikane. Shqyrtimi i kërkesave një nga një u interesonte SHBA, për faktin se ato, duke pasur shumicën në Këshillin e Sigurimit, rrëzonin kandidaturën e cilitdo shteti që nuk u pëlqente pa përdorur të drejtën e vetos.

Edhe në këtë sesion Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe fuqitë e tjera imperialiste manifestuan tendencën për ta shndërruar Organizatën e Kombeve të Bashkuara në një instrument në shërbim të qëllimeve të tyre politike për ekspansion e sundim botëror. Këto synime ata përpiqeshin t'i maskonin me deklarata e frazeologji «paqësore». Nuk kishte sesion të Asamblesë

së Përgjithshme në të cilën SHBA-ja dhe Britania e Madhe të mos bënin deklarata mbi domosdoshmërinë e shndërrimit të OKB-së në një organizatë universale. Përfaqësuesit e Departamentit të Shtetit në Këshillin e Sigurimit, në Asamble e në Komisionet e saj hiqeshin si partizanët më të zjarrtë të universalitetit të OKB. Atë nuk kishte lënë pa shprehur edhe vetë presidenti i SHBA, Truman, i cili në seancën plenare të Asamblesë së Përgjithshme më 1949 pati deklaruar se SHBA kanë bindjen «se organizata do të vazhdojë të rritet me qëllim që të përmbushë nevojat e të gjithë popujve të botës dhe shprejnë se së fundi të gjitha kombet e tokës do të jenë anëtarë të kësaj organizate.»¹³⁴

Veprimtaria konkrete e SHBA-së në OKB ishte larg objektivave të mësipërm, bile kundër tyre. Dhe kjo nuk ishte një politikë koniunkturale, por një vijë e tërë politike e përforcuar e me synime të caktuara ekspansioniste e hegjemoniste, kundër revolucionit, Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të demokracisë popullore. Për të realizuar planet e tyre sunduese imperialistët amerikanë krijuan në prillin e vitit 1949 aleancën politiko-ushtarake agresive të Atlantikut Verior. Në Evropë, me ndihmën dhe me përkrahjen e SHBA-së, revanshistët gjermanoperëndimorë shpallën formimin e Republikës Federale Gjermane. Evropa Perëndimore ndodhej e nënshtruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ato nuk mund të pajtoheshin me faktin që një pjesë e vendeve të Evropës ndodheshin jashtë sferës së tyre të sundimit dhe ecnin në rrugën e socializmit. Ndaj dhe bënin të gjitha përpjekjet që të përmbysnin pushtetin popullor të vendosur në këto vende. Këtij qëllimi i shërbente edhe politika amerikane e ku-

ndërshtimit të kërkesës së Shqipërisë për pran
nim në OKB.

Në diskutimin e kërkesës shqiptare gjatë se
sionit të katërt të Asamblesë së Përgjithshme të
OKB-së, SHBA-ja dhe Britania e Madhe, meqenë
nëse nuk ishin në gjendje të sillnin ndonjë «ar
gument» të ri për të kundërshtuar kandidaturën
shqiptare, u detyruan të shpallnin hapur motivet
që i udhëhiqnin në qëndrimin që mbanin në
çështjen e pranimit të Shqipërisë dhe të disa
vendeve të tjera demokratike. «Në qoftë se këto
shtete dëshirojnë të ndryshojnë politikën e tyre,
— tha delegati amerikan, — ... Shtetet e Ba
shkuara do të jenë të lumtura të mbështesin
kandidaturat e tyre.»¹³⁶

Kushti ishte shprehur më qartë se asnjëherë
tjetër: ndryshoni politikën tuaj të brendshme dhe
të jashtme, pranoni planin «Marshall» dhe nën
shtrojuni SHBA-së për të zënë vendin në OKB.
Duke u nisur nga koncepti dhe praktika impe
rialiste e marrëdhënieve midis shteteve, qeveria
amerikane i kërkonte Bashkimit Sovjetik që si
shtet i madh të ndërhynte dhe të ndikonte te
Qeveria shqiptare dhe vendet e tjera demokra
tike që të pranonin kërkesat e Uashingtonit.

Shteti sovjetik, i cili udhëhoqej nga J.V.Sta
lini, ndiqte një politikë të drejtë e revolucionare
në ndihmë e në përkrahje të të gjitha atyre ve
ndeve që ishin futur në rrugën e drejtë të so
cializmit. Krejt ndryshe nga qëndrimi i udhë
heqjes revizioniste të Moskës sot, për Bashkimin
Sovjetik në atë kohë ishte e huaj dhe e papaj
tueshme me politikën e tij marksiste-leniniste
ndërhyrja në punët e brendshme të vendeve të
tjera socialiste, presioni dhe shantazhi kundër
tyre. Kjo politikë e ky qëndrim pasqyrohej atë
herë edhe në Organizatën e Kombeve të Bash

kuara. Përfaqësuesi amerikan nuk e kishte të qartë dhe as që mund ta kuptonte karakterin e marrëdhënieve midis shteteve të vërteta socialiste. Këto marrëdhënie ishin ndërtuar mbi bazën e internacionalizmit proletar, të ndihmës e të respektimit reciprok, të bashkëpunimit e të miqësisë midis popujve.

Qëndrimi publik që u mbajt nga SHBA-ja e Britania e Madhe në këtë sesion të Asamblesë së Përgjithshme vërtetonte se ato nuk kishin lëvizur aspak nga pozitat e tyre antishqiptare. Dokumentet e Departamentit amerikan të Shtetit në lidhje me Shqipërinë për vitin 1949, të botuara këto vitet e fundit, zbulojnë se përmasat e veprimtarisë antishqiptare të anglo-amerikanëve kanë qenë shumë më të gjera se ç'njiheshin. Uashingtoni dhe Londra kanë qenë tepër të zënë me çështjen e rrëzimit të pushtetit popullor në Shqipëri. Politika e tyre kundër vendit tonë ishte e bashkërenduar deri në detaje. Departamenti i Shtetit rekomandonte hapur që, për të dobësuar pozitën e pushtetit popullor në Shqipëri, SHBA duhet të përdornin çdo lloj mjeti diplomatik në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si dhe ushtrimin e masave ekonomike.¹³⁶ Ai këshillonte gjithashtu që SHBA-ja dhe fuqitë e tjera perëndimore të bashkërendonin veprimet me Titon dhe të mbështetnin tradhtarët shqiptarë jashtë atdheut.¹³⁷ Çështja e përmbysjes së diktaturës së proletariatit në Shqipëri u bë objekt i veçantë shqyrtimi midis sekretarit amerikan të shtetit Açeson dhe ministrit të Jashtëm anglez Bevin më 14 shtator 1949. Të dy ministrat ranë plotësisht dakort me planin për rrëzimin e pushtetit popullor në Shqipëri dhe diskutuan edhe për llojin e qeverisë së re që do të vinin në krye të vendit. Nuk u la pa u marrë parasysh edhe mu-

ndësia e ardhjes në pushtet e «ndonjë mbreti», (me këtë nënkuptohej Zogu) apo e ndonjë qeverie të dalë nga kuislingët shqiptarë jashtë atdheut, të grumbulluar rreth të ashtuquajturit Komiteti «Shqipëria e lirë». ¹³⁸

Menjëherë pas përfundimit të planit, anglo-amerikanët nxituan ta vinin atë në jetë. Në nëntor 1949 Inteligjenc Servisi dërgoi në Shqipëri banda të armatosura agjentësh shqiptarë të stërvitura në Maltë, të cilat, sapo shkelën truallin shqiptar, u kapën e morën dënimin e merituar. Xhulian Emeri, ish-oficer i misionit anglez në kohën e luftës në Shqipëri dhe më vonë edhe ministër në njërën prej qeverive angleze të pasluftës, shprehte hapur në atë kohë shqetësimin për vonesën e Anglisë e të Amerikës për organizimin e revoltës në Shqipëri dhe sugjeronte që «me një shumë të vogël floriri mund të ngriheshin fiset e veriut duke provokuar aty një revolucion.» ¹³⁹

Uashingtoni, në vjeshtën e vitit 1949, përpunoi objektivat me afat të shkurtër e të largët të politikës së SHBA-së ndaj Shqipërisë. Ndër masat që parashikoheshin për të arritur synimet tashmë të njohura në Shqipëri bënte pjesë edhe ajo që kishte të bënte me «... mobilizimin e opinionit botëror kundër Qeverisë së sotme shqiptare për të dobësuar pozitën e saj ndërkombëtare.» ¹⁴⁰ Për këtë qëllim rekomandohej «përdorimi i influencës së SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Francës për të ndaluar pjesëmarrjen e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare.» ¹⁴¹

Me akuzat anglo-amerikane kundër Shqipërisë në sesionin e katërt u bashkua edhe qeveria jugosllave. Pas demaskimit të tradhtisë titiste dhe shkatërrimit të planeve komplotuese antishqip-

tare, Beogradi u angazhua hapur në një veprimtari të ethëshme armiqësore kundër Shqipërisë. Ashtu si SHBA-ja e Britania e Madhe, edhe Jugosllavia grumbulloi në tokën e saj agjentë kriminelë, të arratisur politikë e ordinerë, i stërviti dhe i përgatiti për t'i hedhur në Shqipëri. Duke filluar nga viti 1948 e deri në vitin 1955 titistët hodhën ose organizuan në Shqipëri 307 banda agjenturore diversioniste e kriminelësh, të cilat u kapën ose u asgjësuan të gjitha*. Ata, në rrugë nga më të ndryshmet, agjenturore e diplomatike, hynë në lidhje me anglo-amerikanët për të rrëzuar pushtetin popullor në Shqipëri. Një nga udhëheqësit e qeverisë jugosllave në atë kohë, Eduard Kardeli, i deklaroi ambasadorit anglez se «regjimi i tanishëm shqiptar duhej ndryshuar dhe do të ndryshonte...»¹⁴². Vendosmëria dhe siguria me të cilën shpreheshin titistët për përmbysjen e situatës në Shqipëri e kishte bazën në bashkëveprimin e fshehtë me SHBA-në e Britaninë e Madhe dhe në rrjetin agjenturor që punonte brenda në Shqipëri. Por ata gabuan rëndë në planet e llogaritë e tyre, si atëherë edhe më vonë.

Krahas këtij aktiviteti praktik antishqiptar, qeveria jugosllave ndërmoi edhe një propagandë të gjerë shpifëse e denigruese. Kështu në sesionin e katërt të Asamblesë së Përgjithshme ajo u shpreh se Shqipëria dhe vendet e tjera të demokracisë popullore «në asnjë mënyrë nuk mund të konsideroheshin si vende që përmbushnin kushtet e parashikuara në nenin 4 të Kartës»,¹⁴³ sepse gjoja ato kishin ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë, dhe ishin përpjekur

* Shih: Enver Hoxha, «Titistët (Shënime historike)», f. 537

«për t'i imponuar asaj një regjim të papranueshëm». ¹⁴⁴ Qëndrimi i Beogradit në OKB në lidhje me çështjen e pranimit të Shqipërisë ishte një provë tjetër që dëshmonte se Jugosllavia politiken e saj antishqiptare e kishte bërë kauzë të përbashkët me anglo-amerikanët.

KAPITULLI I TRETË

TENDENCA E PËRGJITHSHME NË FAVOR TË PRANIMIT TË SHQIPËRISË

Politika e diskriminimit humbet përkrahës

Ngecja në vend e çështjes së pranimi të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore në Organizatën e Kombeve të Bashkuara ishte pasojë direkte e politikës që ndiqnin imperialistët anglo-amerikanë jo vetëm brenda kësaj organizate, por edhe në shkallë ndërkombëtare. Situata ndërkombëtare në fillimin e viteve 50 u acarua edhe më tepër nga politika reaksionare agresive dhe luftënxitëse e SHBA-së dhe e fuqive të tjera imperialiste. Qendra e kapitalizmit botëror, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më hapur se ndonjëherë tjetër, nxorën në shesh planet e tyre të vjetra për sundim e hegjemoni, kundër revolucionit e socializmit. Reaksioni i tërbuar anti-komunist dhe antidemokratik, që arriti kulmin

në këto vite në SHBA, u shoqërua me një agresivitet të paparë në fushën e politikës së jashtme. Në qershorin e 1950-ës imperialistët amerikanë ndërmorën, në bashkëpunim me klikën që sundonte në Korenë e Jugut, agresionin kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë. Këtë veprim, në kundërshtim të plotë me parimet themelore mbi të cilat ishte krijuar OKB-ja, imperialistët amerikanë u përpoqën ta paraqitnin si një masë në mbrojtje të «botës së lirë» nga «kërcënimi» komunist. Për më tepër SHBA, duke zotëruar shumicën e votave, arritën që të miratonin dhe të përligjinin agresionin e tyre kundër popullit korean nën flamurin e OKB-së.

Në këto momente Organizata e Kombeve të Bashkuara, e krijuar për të punuar për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar, u bë vegël qorre në duart e imperializmit amerikan. Stalini, duke pasur parasysh këtë situatë, theksonte në atë kohë se «OKB-ja nuk është aq një organizatë e përbërshme sa një organizatë për amerikanët, një organizatë që vepron në interes të agresorëve amerikanë... Organizata e Kombeve të Bashkuara është duke marrë kështu rrugën e turpshme të Lidhjes së Kombeve. Në këtë mënyrë ajo po e varros autoritetin e saj moral...» Në një gjendje të tillë OKB-ja nuk mund të zgjidhte as edhe një ndër çështjet e shumta që qëndronin përpara saj, pra as atë të pranimit të anëtarëve të rinj.

Atmosfera e nderë që zotëronte situatën ndërkombëtare në gjysmën e dytë të vitit 1950 u pasqyrua edhe në punimet e sesionit të pestë

* J.V. Stalin, «Bisedë me korrespondetin e Pravdës», 1951, f. 11-12.

të Asamblesë së Përgjithshme. Çështja e agresionit imperialist kundër RDP të Koresë, që SHBA e paraqitën me kokë poshtë, si kërcënim e agresion «komunist» kundër Koresë së Jugut, mbizotëroi punimet e OKB-së dhe i la shumë pak vend diskutimit të çështjeve të tjera. Ndryshe nga sesionet e viteve të mëparshme, në sesionin e pestë të Asamblesë së Përgjithshme çështja e pranimin të anëtarëve të rinj nuk u diskutua as në Këshillin e Sigurimit, as edhe në Komisionin Politik, por drejtpërdrejt nga Asambleja e Përgjithshme. Me 1 dhjetor 1950, në seancën plenare të Asamblesë së Përgjithshme, problemi vetëm sa u shtrua për shqyrtim.

Edhe në këtë sesion përfaqësuesit e SHBA-së e të Britanisë së Madhe dhe të vendeve të tjera kapitaliste ruajtën të njëjtën pozitë; ata mbështetën projektrezolutën për pranimin e shteteve kapitaliste dhe deklaruan se do të votonin kundër projektrezolutës sovjetike, që ishte për pranimin e njëkohshëm të 13 shteteve, duke ngritur po ato «argumente» si edhe në sesionet e kaluara. Delegati amerikan Sparkman theksoi se Shqipëria nuk e kishte marrë parasysh kërkesën këmbëngulëse amerikane për të ndryshuar politikën e saj dhe për rrjedhim, deklaroi ai, «qeveria amerikane aktualisht, në këto kushte nuk mund të mbështeste pranimin e Shqipërisë».¹⁴⁵ Në emër të qeverisë amerikane ai rishfaqti edhe një herë tjetër shpresën se Shqipëria «do ta modifikonte» politikën dhe qëndrimin e saj, në mënyrë që t'i lejonte Shtetet e Bashkuara të votonin në favor të pranimin të saj. Sa më shpejt ta bënte Shqipëria këtë kthesë, po aq shpejt premtonte edhe përfaqësuesi i imperializmit

amerikan të mbështeste pranimin e saj në OKB.¹⁶⁶

Ndryshimi i politikës së Shqipërisë, për të cilin bënte thirrje Uashingtoni, nënkuptonte rrëzimin e pushtetit popullor dhe rivendosjen e sundimit të borgjezisë në formën e së ashtuquajturës demokraci borgjeze. Për t'ia arritur këtij qëllimi SHBA nuk mjaftoheshin vetëm me predikime e thirrje demagogjike nga tribuna e OKB-s, por ushtronin një politikë të hapët diversioniste kundër Shqipërisë. Me nxitjen dhe përkrahjen e drejtpërdrejtë të imperialistëve amerikanë, në vitet 1949-1950 në Shqipëri u dërguan me dhjetëra banda diversionistësh e grupe spiunësh të përbërë prej kriminelësh shqiptarë të arratisur, të cilët në bashkëpunim me armiqtë e brendshëm, kryenin sabotime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe vrisnin njerëz të Partisë dhe të pushtetit popullor.

Vigjilenca e Partisë dhe e popullit, guximi dhe trimëria e forcave të mbrojtjes dhe e organeve të Sigurimit bënë që të shkatërroheshin bandat dhe grupet diversioniste të ardhura nga jashtë. Mbeturinat e tyre i kaluan drejtësisë popullore dhe morën dënimin e merituar. Faktet e reja e të pamohueshme që dolën në shesh ngarkonin me përgjegjësi qeverinë amerikane dhe ato të vendeve fqinje për organizimin e bashkërenduar të kompleteve antishqiptare. Në dritën e tyre shihej edhe më qartë se qëndrimi diskriminues i SHBA-së dhe i pasuesve të tyre në çështjen e pranimin të Shqipërisë në OKB frymëzohej vetëm e vetëm nga urrejtja që ushqenin për regjimin politik të vendosur në vend.

Qëndrimi i paprincipitë i SHBA-së dhe i Britanisë së Madhe në çështjen e pranimin të

anëtarëve të rinj pak nga pak po humbiste edhe në sylë e disa vendeve anëtare të OKB-së. Përfaqësuesit e tyre nuk mund të bindeshin më me argumentet anakronike anglo-amerikane, që nga përdorimi i përvitshëm u kishte dalë boja fare. Nga ana tjetër këto vende kishin krijuar bindjen se në politikën e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera demokratike nuk kishte asgjë që të binte në kundërshtim me Kartën. E vetmja pengesë për pranimin e tyre në OKB ishte politika e Uashingtonit dhe e Londrës, që synonte ta shndërronte këtë organizatë në një vegël në duart e SHBA-së. Për të gjetur një zgjidhje të problemit disa vende adoptuan politikën e kompromisit dhe u përpoqën që ta vinin në jetë atë. Kështu Siria, ndonëse ishte bashkautore e projektrezolutës anglo-amerikane, nuk u pajtua me qëndrimin e SHBA-së e të Britanisë së Madhe që kundërshtonin pranimin e Shqipërisë në OKB.¹⁴⁷ Me llogaritjen e thjeshtë aritmetike që bënte, përfaqësuesi i Sirisë përpiqej t'i siguronte SHBA-në dhe Anglinë se pozitat e tyre në OKB mbeteshin të pacenuara. Ky ishte një qëndrim gjysmak dhe kontradiktor. Si i tillë ndonëse shprehte shqetësim për gjendjen e krijuar në lidhje me çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj, ai nuk ishte në përputhje me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Punimet e sesionit të pestë të Asamblesë së Përgjithshme nuk e lëvizën nga vendi çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Përsëri në këtë sesion u adoptua rezoluta e përkrahur nga shumica anglo-amerikane. Megjithatë u shfaq një ndryshim. Shumë vende filluan të mbajnë një qëndrim më realist ndaj kërkesave për pranimin e vendeve që kishin hyrë në rrugën e ndërtimit të socializmit. Ato po bindeshin se këto

shtete ishin paqedashëse dhe të afta për t'u pranuar në radhët e OKB-së. Kjo tendencë jo vetëm që u vu re gjatë diskutimeve në sesionet plenare të Asamblesë së Përgjithshme, por u manifestua edhe gjatë votimit të projektrezolutës sovjetike, që për herë të parë gjente mbështetje nga shumë vende anëtare të OKB-së.

Ndërkaq SHBA-ja dhe fuqitë e tjera imperialiste vazhdonin të bënin çmos që të pranoheshin në OKB vetëm vendet kapitaliste. Në mënyrë të veçantë ata interesoheshin për Italinë. Në prag të hapjes së sesionit të gjashtë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara SHBA-ja, Anglia dhe Franca ndërmorën një aksion diplomatik për të bërë të mundur pranimin e Italisë në OKB. Më 26 shtator 1951 qeveritë e këtyre vendeve lëshuan një deklaratë të përbashkët, që u publikua njëkohësisht në Paris, Londër dhe Uashington, në lidhje me rishikimin e Traktatit të Paqes me Italinë. Në pikën e gjashtë të kësaj deklarate nënvizohej se «secila nga tri qeveritë riafirmon vendosmërinë e saj për të bërë të gjitha përpjekjet që të sigurohet hyrja e Italisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara», ndërsa në pikën 7 të saj thuhej se «të tria qeveritë shpresojnë se kjo deklaratë do të gjejë miratim të gjerë nga ana e nënshkruesve të tjerë të Traktatit të Paqes me Italinë, të cilët do të jenë të dispozuar për të vepruar në të njëjtën mënyrë».¹⁴⁸

Deklarata e mësipërme iu dërgua të gjitha vendeve nënshkruese të Traktatit të Paqes me Italinë. Me 8 tetor 1951, nëpërmjet notës së ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, ajo iu bë e njohur zyrtarisht edhe Qeverisë së RP të Shqipërisë.¹⁴⁹

SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik, Britania e

Madhe dhe Franca patën rënë dakord që, pas nënshkrimit të traktateve të paqes me shtetet ish-aleate të Gjermanisë naziste, të mbështetnin kandidaturat e tyre për pranim në OKB. Nëse deri në këtë kohë pranimi i këtyre vendeve nuk ishte bërë fakt i kryer, arsyeja duhet kërkuar në qëndrimin diskriminues që kishin adoptuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Franca në çështjen e pranimin të disa anëtarëve të rinj. Ndërsa përkrashnin pranimin e Italisë, ata refuzonin pranimin e vendeve të tjera, që kishin qënë viktima të agresionit të saj, siç ishte Shqipëria.

Më 4 dhjetor 1951 Qeveria e RP të Shqipërisë ktheu përgjigjen e notës në lidhje me kërkesën për rishikimin e Traktatit të Paqes me Italinë. Qeveria jonë nuk pajtohej me vlerësimin që qeveritë e SHBA-së, të Britanisë së Madhe dhe të Francës i bënin qeverisë italiane. Ajo me fakte e dokumente provonte në notën e saj se «konsideratat (për Italinë) të qeverive të SHBA-së, Britanisë së Madhe dhe Francës nuk janë aspak të drejta dhe nuk pajtohen me qëndrimin dhe veprimtarinë e vërtetë të qeverisë italiane, veçanërisht për sa u përket marrëdhënieve të saj me RP të Shqipërisë.»¹⁵⁰

Në notë Qeveria jonë shprehte qëndrimin dhe pikëpamjen e saj lidhur me pranimin e Italisë në OKB. «Qeveria e RP të Shqipërisë, — thuhej aty, — nuk mund të kuptojë kurrësi pranimin e Italisë si anëtare të OKB-së pa pranimin e Shqipërisë, e cila që më 7 prill 1939 ka qënë viktima e parë e agresionit të armatosur italian në Evropë...»¹⁵¹ Qeveria e RP të Shqipërisë shumë herë kishte kërkuar që të vihej në vend padrejtësia që i ishte bërë vendit tonë, i cili meritonte të ishte ndër themeluesit e OKB-

-së. Të vije në një plan agresorin me viktimën dhe për më tepër të favorizojë të parin në çështjen e pranimit në OKB, donte të thoshte të veproje në kundërshtim me Kartën dhe me vetë vendimet që kishin marrë fuqitë e mëdha në kohën e luftës e mbas saj. Një politikë të tillë kishte vite që po ndiqnin vendet perëndimore me në krye SHBA-në. Qeveria shqiptare e kishte kuptuar që në ditët e para të Çlirimit se kush ishte i interesuar që Shqipëria të mos pranohej në OKB dhe përse. Ajo, si më parë, edhe tani deklaronte se «Shqipëria nuk është ende anëtare e OKB-së vetëm e vetëm për arsye të qëndrimit jo të drejtë të qeverive të SHBA-së Britanisë së Madhe dhe Francës dhe veçanërisht për arsye të qëndrimit armiqësor të qeverisë së SHBA-së dhe të Britanisë së Madhe, që paturpësisht, duke mohuar edhe deklaratat dhe thëniet e tyre zyrtare të mëparshme, e kanë kundërshtuar sistematikisht pranimin e RP të Shqipërisë në OKB.»¹⁵³

Qeveria e RP të Shqipërisë, për të cilën ishte e huaj dhe e papranueshme politika e diskriminimit, në notën e saj shprehte pikëpamjen se «është dakord që Italia të pranohet në OKB në rast se në të njëjtën kohë do të pranohen si anëtarë të saj edhe RP e Shqipërisë, RP e Bullgarisë, Hungarisë, Rumanisë si dhe Republika e Finlandës.»¹⁵³ Shqipërisë i takonte të pranohej në Organizatën e Kombeve të Bashkuara më parë se Italia dhe çdo shtet tjetër që kishte paraqitur kërkesë.

Në punimet e sesionit të gjashtë të Asamblesë së Përgjithshme, që filluan më 6 nëntor 1951, SHBA-ja dhe Britania e Madhe, e thelluan edhe më tej politikën e tyre të diskriminimit në çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Edhe këtu

diskutimi i kërkesës shqiptare ngjalli polemikë të mëdha. Sipas delegatit amerikan Gros, Shqipëria nuk përmbushte as kushtet më të thjeshta që duheshin për t'u bërë anëtare e Organizatës dhe se ishin aktet e saj ato që e pengonin të pranohet.¹⁵⁴ Grosi numëroi për Shqipërinë tri të tilla: Mbështetjen që ajo i jepte «agresionit» në Kore, «aktet armiqësore» ndaj Jugosllavisë dhe mungesën e marrëdhënieve normale me Greqinë. Pastaj ai vuri kushtin: Në rast se Shqipëria me veprimet e saj dëshiron të hyjë në marrëdhënie miqësore me shtetet e tjera (domethënë të pranonte pretendimet imperialiste të SHBA-së e të Britanisë së Madhe), ajo mund të fitonte mbështetjen e një shumice në Këshillin e Sigurimit dhe në Asamblenë e Përgjithshme.¹⁵⁵

Sa herë që SHBA do të kundërshtonin pranimin e Shqipërisë në OKB, do të sajnin pretekste, të mbështetura në interpretimin e mbrapshtë dhe në shikimin e fakteve dhe të ngjarjeve kokëposhtë. Kështu, Shqipëria sipas tyre mbante një pjesë të përgjegjësisë për ngjarjet në Kore, megjithëse ajo s'kishte dërguar atje forca ushtarake dhe s'kishte kryer agresion kundër popullit korean. Shqipëria akuzohej se kishte përkrahur luftën e drejtë të popullit korean dhe kishte demaskuar agresionin e ndërhyrjen ushtarake të SHBA-së në Kore nën flamurin e OKB. Kjo mjaftonte që SHBA të mbanin qëndrim kundër pranimin të Shqipërisë në OKB.

Gjithashtu Shqipëria akuzohej nga SHBA-ja për akte armiqësore në drejtim të Jugosllavisë. Klika titiste, për të fshehur politikën e saj anti-shqiptare, i kishte drejtuar më 9 nëntor 1950 Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së një ankesë plot shpifje kundër RPSH. Ajo e akuzonte Shqipërinë se gjoja ushtronte një presion agre-

siv kundër Jugosllavisë, me qëllim që të godiste sovranitetin dhe të kërcënonte integritetin e parvarësinë e saj kombëtare. Ankesa jugosllave u parashtrua në Komisionin Politik Special dhe në Asamblenë e Përgjithshme ku dhe u miratua me shumicën e votave që zotëronin SHBA dhe vendet e tjera kapitaliste.¹⁵⁶

Më shumë se çdo shtet tjetër, ajo që duhej të ankohej për veprimtarinë armiqësore të klikës titiste ishte Shqipëria. Për opinionin publik ishin bërë të njohura me kohë faktet që dëshmonin për politikën e aneksimit e të kolonializimit që kishte ndjekur për vite me radhë Jugosllavia ndaj Shqipërisë. Qeveria shqiptare disa herë i kishte tërhequr vëmendjen edhe OKB-së për aktet e vazhdueshme armiqësore të qeverisë jugosllave ndaj Shqipërisë. Ajo e bëri atë edhe në sesionin e gjashtë të Asamblesë së Përgjithshme, nëpërmjet letrës që i drejtonte kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme.¹⁵⁷ Duke fabrikuar e nxitur akuza të tilla ndaj Shqipërisë dhe vendeve të tjera socialiste, përfaqësuesit amerikanë përpiqeshin të maskonin kursin e nënshtrimit politik, ekonomik e ushtarak që SHBA ndiqnin ndaj Jugosllavisë.

Në mbështetje të akuzës së përfaqësuesit amerikan doli delegati grek Politis. Ky, për të faktuar «politikën agresive» të Shqipërisë dhe natyrën «rebele» të shtetit shqipëtar, rikujtoi incidentin famëkeq të kanalit të Korfuzit dhe kundërshtimin e Qeverisë sonë për të pranuar vendimin e padrejtë të Gjykatës së Hagës.¹⁵⁸ Asambleja e Përgjithshme pothuajse në të gjitha sesionet e saj ishte marrë drejtpërdrejt apo tërthorazi me marrëdhëniet shqiptaro-greke. Qeveria jonë kishte shprehur disa herë gatishmërinë e saj për të vendosur marrëdhënie diploma-

tike me Greqinë, por qeveria greke e asaj kohe s'kishte pranuar të hiqte dorë nga pretendimet e saj aneksioniste dhe nga e ashtuquajtura gjendje lufte midis dy vendeve.

Qeveria e SHBA-së dhe përfaqësuesit e saj në OKB ishin në dijeni për këtë qëndrim të qartë paqësor e konstruktiv të qeverisë së RPSH. Uashingtoni, me gjithë deklaratat zyrtare që lëshonte, nuk kishte asnjë interes në përmirësimin sado pak të marrëdhënieve greko-shqiptare. Ai ishte i interesuar dhe nxiste acaramin e gjendjes, krijimin e situatave të ndera në Ballkan, sepse vetëm kështu do të mund të maskohej më mirë ndërhyrja ushtarake, ekonomike dhe politike në Greqi dhe veprimtaria armiqësore kundër Shqipërisë. UNSKOB-i vazhdonte të luante një rol të veçantë në përpunimin e opinionit ndërkombëtar sipas shijes së Uashingtonit.*.

Kundërshtimi pa asnjë bazë i kërkesave për pranimin e Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore po i vinte SHBA-në Britaninë e Madhe dhe disa shtete të tjera kapitaliste kundër tendencës së përgjithshme, e cila tanimë ishte për pranimin e këtyre vendeve në OKB.

* Mbi bazën e raporteve të UNSKOB-it, shumica anglo-amerikane në Asamblenë e Përgjithshme më 18 nëntor 1949 kishte miratuar një rezolutë tjetër, në të cilën Shqipëria karakterizohej si burim kryesor i ndihmës materiale për partizanët grekë e për rrjedhim edhe përgjegjëse për situatën e nderë që ekzistonte në Greqi. Qeveria jonë e hodhi poshtë këtë rezolutë të ngritur mbi bazën e akuzave të vjetra anglo-amerikane dhe bëri përsëri të njohur mendimin e saj për veprimtarinë ilegale të UNSKOB-it.

Kandidatura e Shqipërisë në sesionin e shtatë të Asamblesë së Përgjithshme

Rritja e tensionit ndërkombëtar që karakterizon marrëdhëniet ndërkombëtare në fillim të viteve 50-të ishte pasojë e drejtpërdrejtë e politikës agresive në shkallë të gjerë që ndiqte imperializmi botëror me në krye imperializmin amerikan. Ai u pasqyrua në të gjitha strukturat e marrëdhënieve ndërkombëtare, në marrëdhëniet midis shteteve, në forume e organizma të përbotshme. Shfaqje e këtij procesi ishte edhe thellimi i krizës në të cilën po jetonte prej kohësh Organizata e Kombeve të Bashkuara. E sunduar prej SHBA-së, kjo organizatë jo vetëm që kishte mbetur larg objektivave të saj të fiksuar në Kartë, por kishte vepruar edhe kundër tyre.

Situata e ndërlikuar ndërkombëtare ndikoi në shtrëngimin e mëtejshëm të rrethimit amiqësor kapitalist e revizionist të Shqipërisë dhe në rritjen e rrezikut eventual të një agresioni kundër saj nga ana e imperializmit amerikan në bashkëpunim me shtetet fqinjë. Por shantazhet e kërcënimet imperialiste nuk e mposhtën popullin shqiptar në luftën për ndërtimin e socializmit. Kongresi i 2-të i Partisë në prill 1952 miratoi detyra të reja e më të mëdha që në fund të pesëvjeçarit të parë synonin transformimin e Shqipërisë nga një vend agrar i prapambetur në një vend agraro-industrial. Partia dhe Qeveria ishin të bindura se në rrugën e ndërtimit socialist të vendit, populli shqiptar do të ndeshte në vështirësi e pengesa të reja, si nga armiku i jashtëm ashtu edhe nga reaksioni i brendshëm. Imperialistët anglo-amerikanë do të bënin të gjitha përpjekjet, ashtu siç kishin bërë deri atëherë, për të minuar

pushtetin popullor dhe për të penguar forcimin e pozitive të RP të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Çështja e pranimit të Shqipërisë në OKB ishte njëri prej shembujve që e mbështetnin këtë përfundim.

Politika e jashtme e Partisë dhe e Qeverisë sonë është shquar kurdoherë për karakterin e saj objektiv, konsekuent e parimor. Qeveria e RPSH e shikonte realitetin në sy, ajo nuk tërhiqej para vështirësive në arenën ndërkombëtare, nuk ushqente iluzione, por zgjidhjen e problemeve e merrte mbi shpatullat e veta. Në situatën e acaruar ndërkombëtare të vitit 1952, duke patur parasysht edhe gjendjen e OKB-së në këtë kohë, Qeveria shqiptare ishte e ndërgjegjshme se çështja e pranimit të Shqipërisë në këtë organizatë kishte shumë pak shanse për të fituar, për të mos thënë aspak. Megjithatë Qeveria e RPSH në 10 korrik 1952 e përsëriti kërkesën e saj për pranim në OKB. Me këtë akt ajo shprehte vendosmërinë e saj për të mos u tërhequr nga lufta për të drejtat e ligjshme që i takonin vendit tonë. Kërkesa vinte në dukje edhe një herë ndihmesën e popullit tonë në fitoren e përbashkët mbi fashizmin, dëshirën për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe angazhimin për të pranuar Kartën dhe detyrimet që rridhnin prej saj që ditën kur Shqipëria do të pranohet në OKB. Ajo mbështeste propozimin që «Këshilli i Sigurimit t'i rekomandonte Asamblesë së Përgjithshme që të pranohen njëkohësisht si anëtarë të OKB-së të 14 shtetet që kanë kërkuar të pranohen.»¹⁵⁹

Kërkesa e re e Qeverisë shqiptare u bë një ditë pasi Këshilli i Sigurimit i kishte shtyrë për më vonë diskutimet mbi çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Më 21 gusht anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit u mblodhën me

tjëllim që të ndihmonin Këshillin, në dhënien e rekomandimeve pozitive për kërkesat e pranimit në OKB. Por, duke qenë se asnjëri nuk ndryshoi qëndrim, nuk qe e mundur të gjendej një bazë marrëveshjeje.

Përfaqësuesi amerikan në Këshillin e Sigurimit përsëri deklaroi se SHBA «i përmbahen qëndrimin të tyre të vjetër dhe se do të vazhdojnë të kundërshtojnë pranimin e Shqipërisë.»¹⁶¹

Praninë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara Shqipëria dhe Qeveria e saj kurrë nuk kishin menduar se do ta siguronin duke iu nënshtruar të, tjerëve. Qeveria shqiptare nuk i lutej dhe as i shtrinte dorën kurrkujt, sepse ishte e ndërjegjshme dhe e bindur se anëtarësinë në OKB, plotësisht të merituar, do ta fitonte vetëm me luftë dhe me përpjekje. Politika e saj e drejtë, parimore e paqedashëse kishte gjetur jehonë në mjaft qeveri e vende të huaja, ndaj edhe retorika antishqiptare e delegatëve amerikanë e anglezë në OKB kishte filluar të humbiste dëgjuesit e vet.

Ajo që të tërheq vëmendjen në grumbullin e akuzave amerikane ndaj vendit tonë në sesionin e shtatë të Asamblesë së Përgjithshme është edhe fakti se midis shpifjeve të shumta, përfaqësuesi amerikan përmendi edhe një nga parullat e propagandës borgjeze se gjoja në Shqipëri nuk ekzistonin të drejtat themelore dhe liritë elementare.¹⁶¹ Diktatura e proletariatit, e lindur nga zjarri i Luftës Nacionalçlirimtare, përfaqësonte në Shqipëri pushtetin e shumicës, të asaj shumice që në SHBA e vende të tjera kapitaliste shtypej e shfrytëzohej barbarisht dhe ishte privuar nga të drejtat më themelore. Me «liri» dhe «të drejta» të zhdukura anglo-amerikanët nënkuptonin liri dhe të drejta për armiqte, për pa-

kipicën feudoborgjeze të përmbysur, për tradhtarët e për spiunët, që dërgoheshin në Shqipëri për të rrëzuar pushtetin popullor.

Në vitet 1951-1953 fuqitë imperialiste dhe shoviniste e dendësuan edhe më shumë punën dhe veprimtarinë e tyre kundër Shqipërisë. Sekretari amerikan i shtetit, Açeson, në vitin 1951 u premtoi reaksionit shqiptar dhe bandave të armatosura që vepronin në brendësi të territorit shqiptar se Shtetet e Bashkuara do të ndihmonin në «çlirimin» e Shqipërisë nga komunistët dhe në realizimin e «pavarësisë» së këtij vendi. Dy vjet më vonë në vitin 1953 sekretari amerikan i Shtetit, antikomunisti i tërbuar Xhon Foster Dales deklaronte se qeveria amerikane do të përkrahte përpjekjet e reaksionit shqiptar në emigracion për vendosjen e «një qeverie të lirë dhe përfaqësuese» në Shqipëri. Departamenti i Shtetit e siguronte reaksionin shqiptar «për mbështetjen amerikane në luftën e tyre kundër tiranisë komuniste». ¹⁶² Rrethimi armiqësor i Shqipërisë bëhej edhe më i rrezikshëm, sepse SHBA ishin në bashkëpunim të plotë edhe me Jugosllavinë e monarkinë greke. Veprimtaria e bandave të armatosura reaksionare të ardhura nga jashtë u shoqërua me një shtim të provokacioneve të armatosura edhe nga monarko-fashistët grekë e revizionistët jugosllavë.

Anglo-amerikanët, në bashkëveprim me Beogradin e Athinën, kishin hartuar edhe planin e realizimit të komplotit kundërrevolucionar në Shqipëri në vitin 1953. Një nga figurat më të njohura politike të borgjezisë së madhe greke dhe ish-ministër e kryeministër në disa qeveri greke, Panajot Kanellopullosi, i deklaronte në

prill 1953 gazetarit amerikan e agjentit të CIA-s Sulsbergerit se «shpresohet që, brenda dy deri nëntë muajve që vijnë, do të arrijmë të kryejmë një grusht shteti me anën e të cilit do të çlirojmë Shqipërinë...» dhe «po të jetë e nevojshme trupat amerikane do të mbajnë rendin pas kryerjes së grushtit të shtetit». ¹⁶³

Por kjo veprimtari armiqësore imperialisto-revizioniste, e koordinuar me veprimtarinë e reaktionit të brendshëm, ndeshi në barrikadën e pakapërcyeshme të unitetit të popullit me Partinë, në forcën dhe qëndresën e vendosur të forcave tona të armatosura, e të organeve të Sigurimit. Në vitin 1953 bandat diversioniste pothuajse u asgjësuan, shumica e anëtarëve të tyre u kapën dhe u dënuan nga gjyqet e popullit. Shkatërrimi i bandave ishte një goditje tjetër e rëndë që i jepej imperializmit amerikan dhe armiqve të tjerë të Shqipërisë, të cilët shpresonin një përmbysje të situatës në vend. Dështimin dhe asgjësimin e bandave tradhtarë të diversantëve e spiunëve. Uashingtoni dhe pasuesit e tij e propagandonin si «mungesë» të lirive e të të drejtave të njeriut në Shqipëri..

Ishte e qartë se qeveria amerikane, e mbushur me ndjenja të thella armiqësore kundër pushtetit popullor, do të pengonte përsëri pranimin e Shqipërisë në OKB. Në përgjithësi atmosfera ndërkombëtare, në të cilën po zhvillohej diskutimi i çështjes së pranimit të anëtarëve të rinj, nuk premtonte ndonjë zgjidhje të saj. Imperialistët anglezë e amerikanë ende manipulonin shumicën e votave në OKB. Përfundimet e sesionit të shtatë të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj vërtetonin mendimin e Partisë e të Qeverisë sonë, të cilat në

atë kohë deklarorin se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e kanë bërë tash atë një vegël të politikës së tyre diktatoriale».*.

Formimi i «Komisionit të Shërbimeve të Mira»

Në sesionin e tetë të Asamblesë së Përgjithshme në vitin 1953 çështja e pranimit të anëtarëve të rinj u diskutua vetëm në Komisionin Politik. Atij iu referua raporti i Komisionit të Posaçëm për pranimin e anëtarëve të rinj që ishte krijuar me vendim të Asamblesë së Shtatë të OKB. Në të ishin parashtruar propozimet dhe sugjerimet e vendeve të ndryshme për pranimin e anëtarëve të rinj. Komisioni i Posaçëm vetë nuk ishte në gjendje të jepte asnjë rekomandim për zgjidhjen e problemit, për të cilin ai ishte krijuar. Ai paraqiti grumbullin e njohur të opinioneve të shprehura në Asamble, në Këshillin e Sigurimit e në Komisionin Politik. Për opinionet që ishin në kundërshtim me Kartën edhe vetë Komisioni i Posaçëm qe i detyruar të shprehej kundër. Në konkluzionet e tij thuhej se rregulli i unanimitetit të anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit që zbatohet në miratimin e kërkesave për pranim dhe neni 4 i Kartës nuk e lejonin Asamblenë e Përgjithshme të pranonte një shtet në Kombet e Bashkuara pa pasur rekomandimin e favorshëm të Këshillit të Sigurimit.¹⁶⁴

Komisioni i Posaçëm nuk arriti ndonjë rezultat që të përlligjte veprimtarinë e vet. Megjithatë mania e komisioneve kishte filluar të kapte shu-

* Enver Hoxha, Vepra, Vëll. 10, f. 168.

më anëtarë të OKB-së. Disa vende ishin të mendimit se komisionet do të lehtësonin disi rendin e rënduar të diskutimeve të pafund të organeve të OKB-së. Për disa të tjerë, duke përfshirë këtu edhe SHBA-në e fuqitë e tjera të mëdha imperialiste, krijimi i komisioneve hapte mundësi të gjera për zhvillimin e prapaskenave. Një numër vendesh të tjera, të prirura nga ideja e kompromisit, shihnin në veprimtarinë e komisioneve, një mundësi për gjetjen e një *modus vivendi* midis pikëpamjeve e qëndrimeve të kundërta. Sidoqoftë duhet thënë se po bëhej tendencë e përgjithshme e po fitonte përherë e më tepër terren praktika për t'i zgjidhur çështjet që preokuponin OKB-në jashtë organizmave zyrtarë të saj. Në sesionin e tetë të Asamblesë së Përgjithshme kjo ecuri do të manifestohej me forcë edhe në çështjen e pranimin të anëtarëve të rinj.

Në Komisionin Politik përfaqësuesi i Perusë, Belond, paraqiti një projektrezolutë të re. Asamblesë së Përgjithshme i kërkohej të krijonte një Komision të Shërbimeve të Mira (bons offices) për t'u konsultuar me anëtarët e Këshillit të Sigurimit, me qëllim që të rishihej mundësia e arritjes së një marrëveshjeje, e cila do të lehtësonte pranimin e anëtarëve të rinj që përmbushnin kushtet e duhura.¹⁶⁵ Komisioni i Shërbimeve të Mira, sipas Belondit, nuk do të ngarkohej të bënte fare negociata, por vetëm të procedonte me konsultime. Ai do të studionte problemin, do të informohej dhe do të përpiqej të harmonizonte pikëpamjet e kundërta. Në përfundim të fjalës së vet delegati peruan shprehu shpresën se «anëtarët e komisionit, dhe në veçanti përfaqësuesi i Bashkimit Sovjetik do ta kuptojnë frymën e drejtësisë dhe të zemërgjerësisë që frymëzon projektrezolutën e tij».¹⁶⁶

Përfaqësuesit e SHBA-së, të Britanisë së Madhe dhe të disa vendeve të tjera kapitaliste e mbështetën projektrezolutën peruane, sepse sipas tyre «klima politike ishte e favorshme për konsultime dhe afrime». ¹⁶⁷ Disa vende të tjera kapitaliste u shprehën se do të merrnin një qëndrim përfundimtar në lidhje me këtë projektrezolutë pasi të ishin njohur me opinionet e shprehura nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit për propozimin e Perusë. ¹⁶⁸ Në seancën e 2 tetorit delegati i Bashkimit Sovjetik nuk u shpreh për projektrezolutën e Perusë, por deklaroi se rezervonte të drejtën për t'u shprehur më vonë mbi propozimet e bëra gjatë kësaj seance të komisionit. Ai propozoi në këtë seancë projektrezolutën për pranimin e njëkohshëm të 14 shteteve në OKB. ¹⁶⁹

Projektrezoluta mbi pranimin e 14 shteteve gjeti një përkrahje të gjerë në komision nga delegacione të ndryshme. Delegati i Suedisë Sandler u shpreh se pranimi i shteteve të numëruara në këtë projektrezolutë ishte në përputhje me dispozitat e Kartës dhe se ajo shënonte drejtimin ku duhej gjetur me të vërtetë zgjidhja. ¹⁷⁰ Për delegatin norvegjez Eugen kjo projektrezolutë ishte «i vetmi propozim konkret i bërë nga një anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit... për të gjetur një mjet daljeje nga qorrsoakaku». ¹⁷¹ Në komision delegati i Danimarkës vuri në dukje se kjo projektrezolutë mund të ndihmonte në zbatimin e parimit të universalitetit. ¹⁷²

Mirëpo, kur kjo projektrezolutë po gjente një mbështetje të gjerë nga ana e delegacioneve, përfaqësuesi sovjetik e tërhoqi atë duke paraqitur një projektrezolutë të re për pranimin e njëkohshëm të Hungarisë, Bullgarisë, Rumanisë, Finlandës dhe Italisë. ¹⁷³ Projektrezoluta e dytë ishte

një hap prapa në krahasim me të parën. Ajo u parashtrua në një kohë kur tendenca e përgjithshme për pranimin e 14 shteteve po rritej. Edhe ato delegacione që kishin përkrahur projektrezolutën e parë nuk arritën ta kuptonin arsyen e propozimit të dytë sovjetik, të cilin as edhe nuk e mbështetën. Përfaqësuesi sovjetik e përligji atë me faktin se me sa dukej «shumica e shteteve nuk dëshironin të mbështetnin pranimin e 14 shteteve në fjalë... në qoftë se delegacionet që kanë mbështetur projektin e parë të BRSS, që kishte të bënte me pranimin e 14 shteteve, mund të garantojnë se një shumicë prej dy të tretash do të votojnë për këtë projekt, përfaqësuesi i BRSS është i gatshëm ta paraqesë atë përsëri». ¹⁷⁴

Gjatë gjithë sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme SHBA-ja, Britania e Madhe dhe disa vende të tjera kapitaliste kishin kundërshtuar të pranorin Shoipërinë dhe vendet e tjera të demokracisë popullore në OKB nër të vetmen arsye se atyre nuk u pëlqente regjimi i brendshëm politik i vendosur në këto vende. Nga ana tjetër, Bashkimi Sovietik kishte ushtruar të drejtën e tij të vetos për të penguar politikën anglo-amerikane të diskriminimit. Mirëpo në këtë sesion u vu re ulje e tensionit në marrëdhëniet midis SHBA-së e Bashkimit Sovietik. Megjithëqë të dyja palët qëndronin në pozitat e tyre të njohura, gjuha që përdornin ndaj njëri-tjetrit ishte e moderuar. Në mënyrë të vecantë delegatët sovjetikë ngurrnin të sulmonin përfaqësuesit amerikanë në diskutimet e tyre.

Fryma «e re», që u ndje në qëndrimin e delegacionit të Bashkimit Sovietik në OKB nuk ishte e rastit dhe nuk kishte të bënte me një qëndrim «elastik». Ajo ishte pasqyrim i drejt-përdrejtë i uzurpimit të udhëheqjes së PK të

Bashkimit Sovjetik dhe të shtetit sovjetik nga grupi revizionist i Nikita Hrushovit dhe i politikës së afrimit e të bashkekzistencës paqësore revizioniste që filloi të ndjekë ai në marrëdhëniet me imperializmin amerikan.

Taktika e hrushovianëve, me të ardhur në fuqi, — vë në dukje shoku Enver Hoxha, — ishte kjo: «të krijohej eufori brenda, të ngrihej prestigji i klikës në vendet e demokracisë popullore, dhe, pavarësisht nga fjalët bombastike, t'u lihej amerikanëve dhe reaksionit botëror të kuptonin se «Ne s'jemi më për revolucionin proletar botëror, duam të bashkëpunojmë ngushtë me ju, kemi nevojë për ju dhe duhet të na kuptoni se ne po ndërrojmë ngjyrë, po bëjmë një kthesë të madhe. Do të kemi vështirësi në këtë kthesë, prandaj, në një mënyrë ose në një tjetër, duhet të na ndihmoni»».* Dhe duhet thënë se imperializmi botëror e kuptoi dhe e ndjeu kthesën kundër-revolucionare hrushoviane. Mirëkuptimi i ndërsjelltë imperialisto-revizionist, ndonëse në fillimet e tij, u ndie shumë shpejt në marrëdhëniet ndërkombëtare. rrjedhimisht edhe në OKB. Kjo politikë e hrushovianëve, fillimet e së cilës u dukën që pas vdekjes së Stalinit, do të bëhet plotësisht zyrtare tre vjet më vonë në Kongresin e 20-të të PK të Bashkimit Sovjetik. Pikërisht tek ajo «frymë e re e bashkëpunimit», që nuhatën shpejt, e kishin shpresën për sukses partizanët e kompromisit në çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj.

Projektrezoluta sovjetike për pranimin e pesë shteteve, që kishin nënshkruar traktatet e paqes, ishte një përpjekje për kompromis nga ana e de-

* Enver Hoxha, «Hrushovianët» Bot. i dytë, 1982, f. 99.

legacionit sovjetik. Këtë gjë e pohonte në seancën e dhjetë të komisionit delegati polak kur deklaronte se ajo (projektrezoluta) «paraqet një përpjekje tjetër për kompromis». ¹⁷⁵ Politika e kompromisit që zbatoi delegacioni sovjetik në këtë sesion u shpreh edhe në qëndrimin e tij në favor të projektrezolutës së Perusë. ¹⁷⁶ Nuk ka dyshim se ky akt i delegacionit sovjetik ishte rezultat i marrëveshjes jashtë seancave të Komisionit Politik. Deklarata sovjetike u mirëprit nga delegacionet përrëndimore, të cilat e vlerësuan atë si një gjest që i shërben «krijimit të një atmosfere të favorshme për zgjidhjen e problemit». ¹⁷⁷ Pasi iu bënë disa rregullime, pa i ndryshuar thelbin e propozimit projektrezoluta e Perusë u miratua njëzëri. ¹⁷⁸ Përfaqësuesi sovjetik deklaroi se nuk do të këmbëngulte që Komisioni të votonte për projektrezolutën e tij, derisa Komisioni i Shërbimeve të Mira nuk do të ketë mbaruar punimet e veta. ¹⁷⁹ Në fund u caktua edhe përbërja e Komisionit të Shërbimeve të Mira me anëtarë Perunë, Holandën, dhe Egjiptin. U vendos që ky komision t'i raportonte Asamblesë së Përgjithshme mbi rezultatet e punës së tij në sesionin e nëntë të saj.

Më 2 nëntor Asambleja e Përgjithshme miratoi njëzëri pa diskutuar fare projektrezolutën mbi krijimin e Komisionit të Shërbimeve të Mira. ¹⁸⁰ Tendencë që u shfaq në sesionin e shtatë të Asamblesë së Përgjithshme për ta diskutuar çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj jashtë seancave të Këshillit të Sigurimit e të Asamblesë së Përgjithshme u thellua edhe më tepër në sesionin e tetë.

* * *

Viti 1954 shënonte vitin e dhjetë të përpjekjeve dhe të luftës këmbëngulëse të popullit dhe të Qeverisë sonë për pranimin e Shqipërisë në OKB. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e RP të Shqipërisë ishin të bindur dhe kishin shprehur me kohë pikëpamjen se Shqipëria do të pranohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, jo për hir të ndryshimit të koniunkturave politike ndërkombëtare, por për meritat e padiskutueshme të saj, për faktin se ajo plotësonte të gjitha kushtet për të qenë anëtare e saj. Qeveria shqiptare nuk ushqente asnjë iluzion për natyrën imperialiste të politikës së SHBA-së, si në marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi, ashtu edhe në marrëdhëniet me vendin tonë në veçanti. Akt-marrëveshjet demagogjike të fuqive imperialiste ajo nuk i cilësonte kurrë si ndryshim të natyrës së imperializmit. Nga kjo pikëpamje e vlerësonin situatën ndërkombëtare në vitin 1954 Partia dhe Qeveria jonë kur deklarorin se «është e vërtetë se janë arritur disa suksese të ndjeshme në uljen e tensionit ndërkombëtar, por është gabim të kujtohet se të gjitha pengesat për zgjidhjen e drejtë të çështjeve me rëndësi ndërkombëtare janë zhdukur. Qarqet imperialiste luftënxitëse, përpara disfatave të bujshme të politikës së tyre të forcës dhe të korrupsionit, po i shtojnë përpjekjet kriminale. Imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre... pengojnë pjesëmarrjen... e Shqipërisë dhe të shumë vendeve të tjera në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.»*

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 12, f. 172-174.

Partia e Punës e Shqipërisë tërhiqte vëmendjen për kuptimin drejt të situatave ndërkombëtare. Ajo kërkonte që, përballë politikës luftënxitëse të imperializmit amerikan, të rritej vigjilencia revolucionare dhe të shumëfishoheshin përpjekjet për shkatërrimin e planeve agresive imperialiste.

Në një situatë të tillë ndërkombëtare më 21 shtator 1954 i filloi punimet sesioni i nëntë i Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Me këtë rast Qeveria e RP të Shqipërisë ripërsëriti kërkesën e saj për pranimin e Shqipërisë në OKB.¹⁸¹ Kërkesa në fillim nënvizonte politikën paqësore e të bashkëpunimit ndërkombëtar që ndiqte Qeveria shqiptare, politikën e saj të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe të mirëkuptimit me të gjitha shtetet, si dhe vullnetin e popullit shqiptar për të ndërtuar në paqe jetën e tij të re dhe të lumtur dhe për të jetuar në marrëveshje me të gjithë popujt. Gjithashtu Qeveria jonë bënte të ditur se ajo që prej vitit 1946 kishte paraqitur disa herë kërkesën për pranimin e RP të Shqipërisë si anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me qëllim që të ndihmonte në zhvillimin e marrëdhënieve të mirëkuptimit midis kombeve dhe në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare me mjete paqësore. Por në kërkesë thuhej se as sakrificat e mëdha që kishte bërë populli shqiptar gjatë luftës përkrah fuqive aleate, as politika e drejtë e Qeverisë shqiptare nuk ishin çmuar gjer atëherë si duhej për t'i njohur RP të Shqipërisë të drejtën legjitime që të zinte vendin që i takonte në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Qeveria jonë deklaronte së RP e Shqipërisë kishte dhënë çdo provë se plotësonte të gjitha kushtet e Kartës si shtet sovran që ndiqte një

politikë paqësore, mirëkuptimi reciprok dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Duke ripërsëritur kërkesën e saj, ajo pranonte pa asnjë rezervë të gjitha detyrimet që rridhnin nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe ishte e gatshme t'i plotësonte ato.¹⁸² Republika Popullore e Shqipërisë kishte në këtë kohë marrëdhënie diplomatike me 15 shtete të Evropës e të Azisë. Politika e fqinjësisë së mirë që ndiqte Qeveria shqiptare kishte bërë të mundur zgjidhjen e disa problemeve me Jugosllavinë, si rifillimin e marrëdhënieve diplomatike dhe ndreqjen e piramidave të kufirit, përmirësimin e marrëdhënieve me Italinë etj. Për sa u përket marrëdhënieve me Greqinë, Qeveria shqiptare kishte bërë përpjekje për përmirësimin e tyre, por nuk kishte gjetur gatishmërinë e nevojshme nga ana e qeverisë së atëhershme greke.*

Në përfundim të kërkesës së saj, Qeveria e RP të Shqipërisë shprehte shpresën se në sesionin e saj të nëntë Asambleja e Përgjithshme do të merrte parasysh të drejtat legjitime të RP të

* Më 12 nëntor 1953 Qeveria e RP të Shqipërisë, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i propozoi qeverisë greke krijimin e një komisioni të përbashkët për ndërtimin e piramidave dhe të shenjave të tjera kufitare të prishura, të dëmtuara ose të zhdukura në vijën e kufirit shtetëror shqiptaro-grek. Me këtë propozim Qeveria jonë shfaqte bindjen se me vullnet të mirë nga të dyja palët mund të ndreqeshin lehtë piramidat e prishura në vijën e kufirit shqiptaro-grek dhe se një punë e tillë do të ndihmonte në vendosjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe mbretërisë së Greqisë, («Zëri i popullit» Nr. 247, 14 nëntor 1953).

Qeveria greke e asaj kohe u përgjigj se kjo çështje

Shqipërisë dhe do të vendoste në favor të pranimit të saj në OKB. Ajo deklaronte se një veprim i tillë ishte në pajtim me parimet e larta të Kartës, dhe me vullnetin e popujve që Kombet e Bashkuara të ishin një qendër ndërkombëtare ku të bashkoheshin dhe të bashkëpunonin të gjitha shtetet e lira dhe sovrane, pavarësisht nga sistemet e tyre politike dhe shoqërore.¹⁸³

Si në sesionin e mëparshëm edhe në sesionin e nëntë çështja e pranimit të anëtarëve të rinj u diskutua vetëm në Komisionin Politik të Posaçëm. Kryetari i Komisionit të Shërbimeve të Mira, përfaqësuesi i Perusë, Belond, paraqiti raportin. Ai shfaqti keqardhjen që «Komisioni, me gjithë përpjekjet e bëra nga anëtarët e tij dhe nga vullneti i mirë, për të cilin dhanë prova anëtarët e Këshillit të Sigurimit, nuk arriti në asnjë rezultat», dhe shtoi në të njëjtën kohë se «megjithëqë delikate, situata nuk është e pashpresë».¹⁸⁴ Belondi raportoi se komisioni i shqyrtoi në mënyrë objektive kërkesat e paraqitura nga 21 shtete kandidatë duke pasur parasysh numrin e votave që ata kishin fituar në Asamblenë e

nuk ishte e mundur të bisedohej midis përfaqësuesve të të dyja qeverive në një komision të përbashkët, por vetëm midis shtatmadhorive të të dy vendeve, sepse Greqia dhe Shqipëria ishin «në fakt vetëm në gjendje armëpushimi» dhe se nuk kishin përfunduar një traktat midis tyre që t'i jepte gjoja fund kësaj gjendjeje

Pretendimet absurde dhe të pathemelta të qeverisë monarkise greke tregonin se ajo nuk ishte e gatshme që midis të dy vendeve të vendoseshin marrëdhënie normale. Populli shqiptar dhe Qeveria e RP të Shqipërisë i hodhën poshtë me vendosmëri pretendimet tendencioze të qeverisë së atëhershme greke.

Përgjithshme dhe në Këshillin e Sigurimit, se vetë ai kishte hyrë në kontakte zyrtare me përfaqësuesit e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, gjatë të cilave kishte vënë re se «pozitat e fuqive të mëdha mbi çështjen nuk kishin ndryshuar pothuajse fare».¹⁸⁵

Raporti i Komisionit të Shërbimeve të Mira nuk jepte asnjë hollësi mbi punën e tij dhe as paraqiste ndonjë propozim për zgjidhjen e problemit. Ai nuk jepte përmbajtjen e konsultimeve dhe nuk përmendte shtetet për të cilat ishin bërë ato, çfarë përparimi e çfarë rezultatesh kishin arritur dhe shkaku përse Komisioni nuk kishte përfunduar misionin e vet. Kryetari i Komisionit të Shërbimeve të Mira e përligji mungesën e këtij informacioni me pretendimin se çështja ishte shumë sekrete dhe nuk duhej diskutuar. Ky komision nuk e përmbushi mandatin që i dha Asambleja e Përgjithshme në sesionin e tetë.

Gjatë punimeve të komisionit, nga disa delegacione të vendeve kapitaliste u paraqitën projektrezoluta, të cilat kërkonin zgjatjen e mandatit të Komisionit të Shërbimeve të Mira dhe miratimin e kandidaturave të veçanta për në OKB. Në përfundim të diskutimeve, komisioni miratoi njëzëri projektrezolutën e përbashkët të Argjentinës, Salvadorit, Kubës dhe Indisë, e cila ftonte Komisionin e Shërbimeve të Mira të vazhdonte përpjekjet e tij, ndërsa i lutej Këshillit të Sigurimit të shqyrtonte çështjen sa më shpejt që të ishte e mundur.¹⁸⁶ Komisioni miratoi edhe një projektrezolutë tjetër, në bazë të së cilës u vendos që të gjitha projektrezolutat e tjera të paraqitura aty t'i kalonin Këshillit të Sigurimit për një shqyrtim të ri.¹⁸⁷

Më 23 nëntor Asambleja e Përgjithshme miratoi pa vënë në votë, dy projektrezoluta që për-

mbante raporti i Komisionit Politik të Posa-
çëm në formën e një rezolute të vetme, me anën
e së cilës ftonte Komisionin e Shërbimeve të Mi-
ra të vazhdonte punën dhe kërkonte që Këshilli
i Sigurimit, së bashku me këtë komision, t'i ra-
portonin Asamblesë së Përgjithshme mundësisht
gjatë këtij sesiioni ose në pamundësi gjatë sesio-
nit të dhjetë.¹⁸⁸

KAPITULLI I KATËRT

PRANIMI I RP TË SHQIPËRISË NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA

Kërkesa shqiptare para Komisionit Politik të Posaçëm

Sesioni i dhjetë i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara filloi punimet më 20 shtator 1955. Situata në të cilën po zhvillonte punimet ky sesion karakterizohej nga një rritje e tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare në krahasim me një vit më parë. Fugitë imperialiste, me në krye SHBA-në, duke u maskuar prapa parullave demagogjike të uljes së tensionit dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare për Indokinën, të arritura në vitin 1954 i dendësuan përpjekjet e tyre për realizimin e synimeve agresive ekspansioniste e hegjemoniste. Në këtë kohë, nën drejtimin e SHBA-së, ishte krijuar edhe blloku agresiv i vendeve të Azisë Juglindore, i njohur me emrin SEATO, pakti i Bagdatit,

i njohur me emrin SENTO, që pavarësisht se kryesohej nga imperializmi anglez, frymëzohej dhe u shërbente qëllimeve të Uashingtonit. Në Evropë, me nxitjen dhe përkrahjen e hapët të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, po rishfaqej rreziku dhe kërcënimi i imperializmit gjermanoperëndimor. Në RF të Gjermanisë revanshistët po ecnin me shpejtësi në rrugën e riarmatimit dhe të krijimit të një ushtrie të madhe të fuqishme me synimin për të rivendosur hegjemoninë e tyre në Evropë. Hyrja e Gjermanisë Perëndimore në bllokun ushtarak agresiv të NATO-s në majin e 1955-s përbënte një kërcënim të madh për lirinë dhe pavarësinë e popujve evropianë e, në mënyrë të veçantë për vendet socialiste.

Politika agresive dhe hegjemoniste e imperializmit me në krye SHBA mund të përballohej me një luftë të vendosur nëpërmjet frontit të bashkuar antiimperialist të popujve me qëndrim konsekuent revolucionar e parimor. Por në këtë kopoviheshin re shenja gjithnjë e më të qarta të degjenerimit revizionist në Bashkimin Sovjetik, të përhapjes së tij edhe në vende të tjera. Në fund të majit të vitit 1955 Hrushovi vajti në Jugosllavi dhe kreu aktin zyrtar të bashkimit të hapët me Titon. Të kësaj kohe janë të gjitha idetë dhe veprimet hrushoviane për bashkëkzistencën paqësore revizioniste me imperializmin, për «rrugën paqësore të kalimit në socializëm», për krijimin e një bote pa ushtri, e pa luftëra». të cilat u kristalizuan dhe u bënë platformë zyrtare e revizionistëve sovjetikë në Kongresin e 20-të të PK të Bashkimit Sovjetik.

Partia e Punës e Shqipërisë ndiqte me vëmendje zhvillimet e reja të situatës ndërkombëtare. Në gjykimin e tyre ajo nisej nga interesat

e marksizëm-leninizmit, të revolucionit e të socializmit, nga interesat e mbrojtjes dhe të forcimit të diktaturës së proletariatit në Shqipëri. Në një kohë kur Hrushovi predikonte bashkëzistencën paqësore revizioniste me imperializmin, gjë që donte të thoshte largim nga pozitat e luftës revolucionare kundër tij, Partia e Punës e Shqipërisë dilte hapur në mbrojtje të parimeve marksiste-leniniste. Ajo deklaronte se «bashkëzistencën paqësore në mes dy sistemeve të ndryshme, nuk do të thotë aspak se nga ana e komunistëve ose e shteteve socialiste duhet të bëhen lëshime parimore, përkundrazi, këto do të mbrohen me vendosmërinë më të madhe».*

Studimin dhe analizën e situatës ndërkombëtare PPSH e bënte edhe në funksion të luftës dhe të detyrave për forcimin e mëtejshëm të pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë. Ajo asnjëherë nuk kishte menduar se të drejtat e vendit tonë në arenën ndërkombëtare do të zgjidheshin në rrugën e marrëveshjeve e të kompromiseve me imperializmin. Vitet që kishin kaluar ishin të ngjeshura me ngjarje që dëshmonin për të kundërtën, se çdo e drejtë ishte arritur vetëm me luftë e përpjekje kundër armiqve të brendshëm dhe imperializmit, me në krye SHBA-në. Deri në këtë kohë vendit tonë i mohohej ende e drejta e tij e ligjshme për të qenë anëtar i OKB-së. Në nëntë sesione të Asamblesë së Përgjithshme çështja e pranimit të Shqipërisë ishte diskutuar, por pa rezultat, për shkak të qëndrimit armiqësor antishqiptar të SHBA-së, të Britanisë së Madhe dhe të pasuesve të tyre. Me rastin e hapjes së sesionit të dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme, Qeveria e RP të Shqipërisë i dër-

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 281.

goi një telegram kryetarit të saj, në të cilin ripërsëritej kërkesa e Shqipërisë për pranim në OKB.

Në këtë kërkesë të re Qeveria e RPSH riafirmonte edhe një herë tjetër përpjekjet e saj të vazhdueshme për të vënë në jetë politikën e saj të fqinjësisë së mirë, të paqes e të miqësisë në marrëdhëniet e saj me shtetet e tjera, theksonte faktin se Republika Popullore e Shqipërisë ishte bërë një faktor paqeje dhe stabiliteti në Ballkan dhe se ndiqte një politikë që i përgjigjet më së miri qëllimeve të statutit të Kombeve të Bashkuara.¹⁸⁹ Qeveria jonë kërkonte, që meqenëse i përmbushte kushtet e kërkuara nga Karta, Shqipërisë t'i njihej e drejta e saj legjitime për t'u pranuar në gjirin e Kombeve të Bashkuara, duke deklaruar edhe një herë tjetër me këtë rast se ajo ishte e gatshme të kryente detyrimet e statutit që u takonin anëtarëve të Kombeve të Bashkuara.¹⁹⁰

Parashtrimi i kërkesës së Qeverisë shqiptare për pranim në OKB në sesionin e dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme bëhej në rrethana kur pozitat e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë ishin shumë më të forta nga çdo herë tjetër. Pushteti popullor, në luftë kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm, i kishte forcuar edhe më tepër pozitat e veta. Partia kishte marrë një varg masash që kishin çuar në demokratizimin e tij të mëtejshëm dhe në rritjen e fuqisë mbrojtëse të atdheut. Bandat diversioniste të ardhura nga jashtë dhe ato që vepronin brenda vendit pothuajse ishin shkatërruar. Diktatura e proletariatit në Shqipëri u forcua edhe më shumë. Faktori kryesor në këtë drejtim ishte udhëheqja e drejtë e Partisë, uniteti i çeliktë i popullit rreth Partisë e pushtetit popullor, gjë që u shpreh edhe në li-

kuidimin e rrymës oportuniste armiqësore të Tuk Jakovës e Bedri Spahiut. Në fushën ekonomike në vitin 1955 ishin arritur rezultate të rëndësishme në ndërtimin socialist të vendit. Detyra kryesore ekonomike e pesëvjeçarit të parë në përgjithësi ishte realizuar, industria ishte zhvilluar me ritme të kënaqshme dhe prodhimi bujqësor e kolektivizimi i bujqësisë në fshat po ecte edhe më përpara.

Kërkesa e re e Qeverisë së RP të Shqipërisë për pranimin e vendit tonë në OKB bëhej në një kohë kur shumica e vendeve anëtare të kësaj organizate, të bindura se Shqipëria ishte e denjë për të qenë në radhët e këtij forumi, kishte mbështetur kandidaturën e saj. Politika e drejtë dhe paqedashëse e Partisë dhe e Qeverisë sonë në arenën ndërkombëtare kishte bërë të shtohesh numri i shteteve, të cilat kishin marrëdhënie diplomatike me vendin tonë dhe kishte thyer opinionin për të ashtuquajturin izolim të Shqipërisë që predikonin prej kohësh imperialistët anglezë e amerikanë. Politika e diskriminimit që ndiqnin SHBA-ja ndaj Shqipërisë, mohimi i të drejtave të saj të ligjshme në arenën ndërkombëtare, pra edhe në OKB, nuk sollën rezultatet që shprejonin në Uashington e në Londër. «Këto qëndrime të tyre të padrejta, — theksonte në atë kohë shoku Enver Hoxha, — bënë në opinionin botëror efektin e kundërt nga ai që prisnin ata. Këto qëndrime vunë më shumë në dukje padrejtësinë dhe politikën arbitrare të këtyre shteteve kundrejt të drejtave sovrane dhe të ligjshme të popujve, ndërsa popullit shqiptar iu rrit prestigji ndërkombëtar dhe iu shtuan miqtë nga të katër anët e botës.»*

Në OKB dhe jashtë saj po bëhej gjithnjë e

* Enver Hoxha, Vepra, vëll, 13, f, 292.

më qartë se kundërshtimi për të pranuar Shqipërinë dhe një varg shtetesh të tjera në këtë organizatë po e paralizonte atë, po e bënte gjithnjë e më të paaftë për të realizuar qëllimet që i kishte caktuar vetes dhjetë vjet më parë. Pozita e zënë nga SHBA-ja dhe fuqitë e tjera imperialiste në çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj nuk mund të mbahej më tutje. Politika e diskriminimit, që ata kishin ndjekur për vite me radhë, nuk pati sukses. Duke vazhduar bllokimin e pranimit të anëtarëve të rinj qeveria amerikane dhe ato që e pasonin, rrezikonin të demaskoheshin edhe më hapur si shkaktarët e vetëm të gjendjes kritike në të cilën ndodhej OKB për këtë çështje. Uashingtoni filloi të manovronte, sepse shumë shtete që dikur e ndiqnin verbërisht, tani nuk pajtoheshin me politikën e tij në çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Nga ana tjetër, në një kohë kur numri i vendeve kapitaliste që kërkonin të pranoheshin në OKB kishte arritur në 13, SHBA ishin të interesuara që të futnin në organizatë anëtarë, që do të shtonin klientelën e tyre me «besnikë» të tjerë në vend të atyre që kishin filluar t'i braktisnin.

Tërheqjen e tyre të detyruar nga pozitat e mëparshme, SHBA dhe pasuesit e tyre e propagandonin si një kompromis gjoja në emër të realizimit të universalitetit të OKB-së. Në të vërtetë kjo tërheqje ishte rezultat i luftës së gjatë shumëvjeçare të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë, që kërkonin të drejtat e tyre të ligjshme në arenën ndërkombëtare. Në këtë ndryshim të qëndrimit të Uashingtonit, të kushtëzuar kryesisht nga faktorët e mësipërm, ka ndikuar në një farë mase edhe ulja e tensionit në marrëdhëniet midis SHBA-së e Bashkimit Sovjetik pas ardhjes në fuqi të revizionistëve hrushovianë. Me ra-

stin e mbledhjes përkujtimore të OKB-së në qershorin e 1955-s në San — Francisko dhe në prag të sesionit të dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme, SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Franca kishin lënë të kuptohej se ekzistonte mundësia për një marrëveshje kompromisi. Bashkimi Sovjetik kishte pranuar në qershor, që listës së 14 shteteve, për të cilat ai propozonte pranim të njëkohshëm, t'i shtoheshin Laosi dhe Kamboxhia, ndërsa në shtator edhe Japonia e Spanja. Nga ana e tyre fuqitë imperia-liste nuk kundërshtonin më pranimin e njëkohshëm të të gjitha këtyre vendeve në OKB.

Në punimet e Komisionit Politik të Posaçëm, që filluan më 1 dhjetor 1955, klientela anglo-amerikane, për t'i shpëtuar «nderin» Uashingtonit, i cili më në fund, nga rrethanat e krijuara, u detyrua të mbante një qëndrim tjetër, filloi të propagandonte idenë e kompromisit. Në seancat e Komisionit dëgjoheshin thirrjet: «Kompromisi ofron të vetmen mundësi për zgjidhje» (Martin i Kanadasë), «Situata ndërkombëtare kërkon kompromis dhe koncensione» (Xhamali, Irak), «I vetmi mjet për të rregulluar këtë problem është pranimi i kompromisit» (Palamas, Greqi).¹⁹¹ Edhe vetë veprimtaria e Komisionit të Shërbimeve të Mira, për raportin e të cilit filloi të diskutonte Komisioni Politik, i bënte jehonë parullës anglo-amerikane dhe ishte orientuar drejt gjendjes së një zgjidhjeje «kompromisi». Kryetari i këtij komisioni, Belond, deklaroi në këtë seancë se detyra e tij ishte «të gjente një zgjidhje politike të problemit, pa dëmtuar pozitat juridike, dhe të çonte në një afrim midis Bashkimit Sovjetik dhe fuqive perëndimore». Sipas tij, në raportin e paraqitur nga komisioni viresh në dukje se «pozitat

e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit mbi çështjen pranimit nuk ishin të pandryshueshme dhe se këta anëtarë ishin të predispozuar të kishin parasysh ndryshimet e ndodhura në marrëdhëniet ndërkombëtare.»¹⁹²

Në Komisionin Politik përfaqësuesi i Kanadasë, Martin, bëri të ditur projektrezolutën e tij, me të cilën ishin bashkuar edhe 27 shtete të tjera. Sipas kësaj projektrezolute i kërkohej Këshillit të Sigurimit të shqyrtonte kërkesat për pranim të cilat kishin mbetur pezull, nën dritën e opinionit të përgjithshëm që ishte në favor të përbërjes së më të gjerë që të ishte e mundur të Organizatës. Ajo rekomandonte pranimin e 18 vendeve, duke përfshirë edhe kandidaturën e Spanjës, që sapo i ishte paraqitur Asamblesë së Përgjithshme.¹⁹³

Në lidhje me këtë projektrezolutë, gjatë kësaj seance shfaqën opinionin e tyre dy anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe. Përfaqësuesi sovjetik pranoi «pa asnjë rezervë pranimin e përgjithshëm të 18 vendeve që kërkojnë të bëhen anëtare të Organizatës».¹⁹⁴ Delegati anglez Dikson shfaqti pikëpamjen e qeverisë britanike, e cila sipas tij «është gati të pranojë të 18 shtetet kandidatë, megjithëse, ka disa rezerva për disa prej tyre.»¹⁹⁵

Shumica e delegacioneve miratuan projektrezolutën e 28 shteteve dhe deklaruan se do të votonin në favor të saj. Vetëm dy përfaqësues, ai i klikës së Çan Kai Shisë dhe i Kubës, u shprehën kundër saj. Gjatë seancave të Komisionit Politik përfaqësuesit e SHBA-së, të klikës së Çan Kai Shisë dhe të Kubës, ndërsa kishin kërkuar pranimin e të gjitha vendeve të tjera kapitaliste, në mes të cilave edhe të Vietnamit të Jugut dhe

të Koresë së Jugut, nuk kishin ngurruar që t'u bënin thirrje anëtarëve të tjerë për të mos mbështetur kandidaturën e Shqipërisë.

Më 7 dhjetor në komision përfunduan diskutimet mbi projektrezolutën e 28 vendeve. Të gjitha diskutimet linin të kuptonin se për pranimin e 18 shteteve nuk do të kishte më pengesa. Më 8 dhjetor Asambleja e Përgjithshme mori në shqyrtim çështjen e pranimin të anëtarëve të rinj. Në përputhje me nenin 68 të rregullores së brendshme të Asamblesë u vendos të mos diskutohej raporti i Komisionit Politik të Posaçëm.¹⁹⁶ Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme i ftoi anëtarët të jepnin vetëm shpjegim për votën. Përfaqësuesi grek përfitoi nga rasti për të ripërsëritur akuzat e njohura ndaj Shqipërisë. Sipas tij, Shqipëria nuk i përmbushte kushtet e parashikuara nga neni 4 i Kartës, se Qeveria shqiptare nuk ishte as e aftë t'i përmbushte detyrimet e Kartës, as e gatëshme që t'i zbatonte ato.¹⁹⁷

Në mbështetje të kësaj teze ai solli argumentet e konsumuara të së kaluarës se Shqipëria nuk ka pranuar rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme mbi të ashtuquajturin kërcënim të pavarësisë politike dhe të integritetit territorial të Greqisë, se midis dy vendeve vazhdon gjendja e luftës dhe se asnjë akt ndërkombëtar nuk i ka dhënë fund një situatë të tillë. Normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, përfaqësuesi grek e kushtëzonte me vendosjen e gjendjes së «paqes», me përfundimin e një marrëveshjeje që do të zgjidhte të gjitha kontradiktat dhe çështjet e mbetura pezull midis tyre.¹⁹⁸ Duke shprehur së fundi edhe një herë tjetër kundërshtimin për pranimin e Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ai theksoi në emër të qeverisë greke se pranimi në atë moment i Shqipërisë nuk do të

mund të modifikonte nga pikëpamja juridike, si dhe nga ajo praktike, gjendjen e marrëdhënieve ekzistuese midis dy vendeve.¹⁹⁹

Qëndrimi i qeverisë greke të asaj kohe në çështjen e pranimit të Shqipërisë në OKB ishte pjesë përbërëse e politikës antishqiptare që ajo vazhdonte të ndiqte prej vitesh. Qeveria shqiptare kishte bërë disa herë përcapje për vendosjen e marrëdhënieve normale e të fqinjësisë së mirë midis dy vendeve. Për herë të fundit një veprim të tillë ajo e kishte bërë në verën e vitit 1955. Në 30 qershor Qeveria e RPSH, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i kishte propozuar qeverisë greke vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve.²⁰⁰

Përpjekjet dhe vullneti i mirë i Qeverisë sonë nuk gjetën jehonë te qeveria e atëhershme greke. Për më tepër ajo manifestonte një qëndrim të hapët armiqësor ndaj Shqipërisë kudo që mundte, duke përfshirë këtu edhe OKB. Por qëndrimi i qeverisë greke dhe i disa qeverive të tjera, me në krye atë të SHBA-së, në çështjen e pranimit të Shqipërisë nuk përputhej me opinionin e shumicës së anëtarëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Shqipëria ishte njëri prej 18 shteteve të propozuara nga shumica për pranim dhe që Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtin numër votash, miratoi përsëri në fund të seancës së saj me 8 dhjetor.²⁰¹

Fundi i një padrejtësie dhjetëvjeçare

Po më 8 dhjetor 1955 Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, nëpërmjet një letre drejtuar Këshillit të Sigurimit, i transmetonte atij rezolutën

e Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën kërkohet që Këshilli i Sigurimit të shqyrtonte kërkesat për pranim të paraqitura nga 18 vende. Asambleja e Përgjithshme i lutej gjithashtu Këshillit të Sigurimit që t'i bënte asaj një raport mbi këto kërkesa për pranim gjatë sesionit të dhjetë.²⁰²

Më 10 dhjetor Këshilli i Sigurimit u mbledh për të shqyrtuar çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj, sipas rezolutës të paraqitur nga Asambleja e Përgjithshme. Anëtarët e Këshillit të Sigurimit në përgjithësi shprehën kënaqësinë për rrugën që kishte marrë kjo çështje. Përfaqësuesi i Britanisë, Dikson, e vlerësoi situatën në të cilën po zgjidhej kjo çështje si «një moment të rëndësishëm të ekzistencës së Kombeve të Bashkuara»,²⁰³ ndërsa delegati sovjetik si një «atmosferë të re, që ndryshon shumë nga ajo e viteve të fundit.»²⁰⁴

Në Këshillin e Sigurimit u zhvilluan diskutime të gjera në lidhje me procedurën dhe rendin sipas të cilave do të shqyrtoheshin propozimet për pranimin e anëtarëve të rinj, se si do të votohej në Këshillin e Sigurimit e në Asamblenë e Përgjithshme. Mirëpo, kur u zgjidh ky problem dhe në një kohë kur u duk se gjithçka po shkonte drejt zgjidhjes përfundimtare u fut në lojë përfaqësuesi çankaishist. Ai parashtrroi në fillim 13 projektrezoluta të veçanta, në bazë të të cilave kërkohet që të pranoheshin në OKB vetëm vendet kapitaliste, duke përfshirë këtu edhe regjimet reaksionare të Koresë së Jugut e të Vietnamit të Jugut.²⁰⁵ Projektrezolutat e delegatit çankaishist ishin një orvatje e re për të penguar përsëri pranimin e anëtarëve të rinj në OKB. Nuk kishte asnjë dyshim se prapa përfaqësuesit të klikës së Tajvanit qëndronin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Delegati çankaishist ishte rezervë e Uashin-

gtonit për realizimin e synimeve të këtij të fundit në çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj. Qëndrimi i tij në momentet e fundit ishte më tepër një presion që ushtronin SHBA për t'i shtuar listës së pranimit ndonjë nga regjimet kukulla të Koresë së Jugut e të Vietnamit të Jugut.

Edhe kur, pas debatesh të shumta, u arrit që në votë të vihej e para projektrezoluta e paraqitur nga Zelanda e Re dhe Brazili për pranimin e njëkohshëm të 18 vendeve, delegati çan-kaishist doli përsëri në skenë. Ai e gjeti «të arsyeshme» të mos e pranonte projektrezolutën e Zelandës së Re dhe të Brazilit, pasi «zbuloi» se në listën e 18 vendeve që ajo përmbante, nuk përfshiheshin as Koreja e Jugut e as Vietnami i Jugut. Me këtë rast ai kërcënoi se «në qoftë se paragrafi i dytë i projektrezolutës së përbashkët interpretohet në mënyrë të tillë që dy projektrezolutat e mia në lidhje me Korenë e Vietnamin (Koreja e Jugut e Vietnami i Jugut — PM) të mos vihen në votë, unë nuk do të mund t'i jap asaj mbështetjen time» dhe se «jam i autorizuar të deklaroj hapur se unë këmbëngul që Këshilli të shqyrtojë kërkesat e Koresë e të Vietnamit dhe të votojë për këto dy projektrezoluta.»²⁰⁶

Pasi parashtroi gjatë e gjerë pikëpamjet e tij mbi çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj dhe pasi «argumentoi» se Shqipëria dhe vendet e tjera demokratike popullore nuk meritonin të pranoheshin në OKB, përfaqësuesi i Tajvanit paraqiti një amendament për projektrezolutën e Zelandës së Re dhe të Brazilit, në bazë të së cilës kërkohej që emrat e Koresë së Jugut dhe të Vietnamit të Jugut të figuronin në krye të listës së kërkesave për pranim, të numëruara në paragrafin e dytë të projektrezolutës.²⁰⁷ Amendamenti çan-kaishist u mbështet menjëherë nga delegati ame-

rikan LloXH, për të cilin «propozimi ishte krejt i përshtatshëm», si dhe nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe e të Francës.²⁰⁸ Mirëpo kur u vu në votë, amendamenti çankaishist u hodh poshtë, sepse kundër kandidaturave të Koresë së Jugut dhe të Vietnamit të Jugut vuri veton Bashkimi Sovjetik.²⁰⁹

Pas kësaj filloi votimi për 18 vendet që përmbante projektrezoluta e Zelandës së Re dhe e Brazilit, sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre. Këshilli i Sigurimit do të procedonte së pari në votimin për Shqipërinë. Gjatë diskutimit të përgjithshëm të çështjes në seancat e mëparshme anëtarët e Këshillit të Sigurimit kishin shprehur opinionet e tyre edhe për kandidaturën e Shqipërisë. Delegati amerikan LloXH kishte deklaruar se nuk do ta mbështeste kërkesën e pranimit të paraqitur nga Shqipëria, se do të abstenonte gjatë votimit për kandidaturën e saj, gjoja sipas frymës së rezolutës «Vandenberg», të pranuar më 1948 nga Senati i SHBA-së, me qëllim që të mos përdorej e drejta e vetos në çështjen e pranimit.²¹⁰ Përfaqësuesi anglez, Dikson, shfaqti «rezerva të veçanta» në lidhje me Shqipërinë. Këto rezerva ai i mbështeste në dyshimet që gjoja kishte Britania e Madhe për karakterin paqësor të Shqipërisë, «dyshime këto që ushqeheshin nga e kaluara jo e largët e këtij vendi».²¹¹ Diksoni në këtë rast i referohej incidentit të kanalit të Korfuzit në vitin 1946. «Ne, — tha delegati britanik, — nuk e kemi të lehtë ta quajmë Shqipërinë një vend paqësor dhe të votojmë për pranimin e saj.»²¹² Dhe me një demagogji të stërholluar, Diksoni ringriti akuzat e vjetra angleze kundër Shqipërisë, duke u dhënë atyre ngjyrën e moderimit, të «shpirtmadhësisë» e të «bujarisë» së kurorës britanike për popujt e vegjël. «Populli

britanik, — thoshte ai, — është nga natyra i duruar dhe i butë, dhe ne shpresojmë se do të mund ta përdorim moderimin në interes të përgjithshëm, sado e fortë që të ketë qenë zemëratat jonë përpara këtij atentati... Ne do të votojmë për pranimin e Shqipërisë. Vota jonë do të jetë një akt besimi për qëndrimin e ardhshëm të Qeverisë shqiptare.»²¹³

Deklaratat e mësipërme nuk shënonin asnjë ndryshim në qëndrimin armiqësor të SHBA-së e të Anglisë ndaj Shqipërisë. Ato ishin të detyruara të zinin një pozitë të tillë në çështjen e pranimin të Shqipërisë. Opinioni i përgjithshëm i anëtarëve të OKB ishte për pranimin e Shqipërisë, SHBA dhe Anglia ruheshin t'i kundërviheshin këtij opinioni, sepse do të demaskoheshin hapur si shkaktarët kryesorë të situatës së rëndë që ishte krijuar në OKB për çështjen e pranimin të anëtarëve të rinj.

Votimi për Shqipërinë dha këto përfundime: 7 vota pro dhe 4 abstenime. Votuan në favor Brazili, Irani, Zelanda e Re, Peruja, Turqia, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe. Abstenuan Belgjika, klika e «Çan Kai Shisë, Franca dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.»²¹⁴ Me rezultatin e mësipërm kandidatura e Shqipërisë në projektrezolutë u miratua. Mirëpo, kur pas saj u votua për RP të Mongolisë, delegati çankaishist, vuri veton dhe kandidatura e saj nuk u miratua.²¹⁵ Pas kësaj përfaqësuesi sovjetik votoi kundër kandidaturave të vendeve kapitaliste. Në fund, kur u hodh në votë gjithë paragrafi i dytë, që përmbante vetëm kërkesat për pranim të Shqipërisë, Hungarisë, Rumanisë dhe Bullgarisë, ai u hodh poshtë nga shumica e anglo-amerikanëve me 4 vota, një kundër dhe 6 abstenime.²¹⁶ Me një përfundim të tillë, projektrezoluta e Zelandës së Re dhe e

Brazilit u hodh poshtë. Kryetari i Këshillit të Sigurimit propozoi që projektrezolutat e tjera të paraqitura në Këshill të mos viheshin në votë. Dhe kështu u vendos. Rezultati i votimeve ngjalli pakënaqësi e shkaktoi një zhgënjim të të gjithë atyre që kishin shpresuar për një zgjidhje të drejtë të çështjes së pranimit të anëtarëve të rinj. Nga ana tjetër, ai tregoi se për pranimin e Shqipërisë në OKB nuk kishte më asnjë pengesë. Duke votuar në favor të kandidaturës shqiptare apo duke abstenuar, SHBA-ja dhe Britania e Madhe pohuan në fakt dështimin e politikës së tyre shumëvjeçare armiqësore dhe antishqiptare përballë luftës dhe përpjekjeve të vendosura të popullit dhe Qeverisë së RP të Shqipërisë për sigurimin e të drejtave të tyre të ligjshme në arenën ndërkombëtare.

Në fakt Shqipëria fitoi të drejtën e rekomandimit të Këshillit të Sigurimit për t'u pranuar në OKB, mirëpo zyrtarisht rekomandimi për të nuk mundi t'i kalonte Asamblesë së Përgjithshme, sepse çështja e pranimit të saj u lidh me atë të pranimit të RP të Mongolisë. Për të zhbllokuar ngecjen e problemit dhe për t'i dhënë një zgjidhje çështjes së pranimit të RP të Mongolisë përfaqësuesi sovjetik i dërgoi më 14 dhjetor 1955 një letër urgjente kryetarit të Këshillit të Sigurimit. Letra kërkonte që po atë ditë Këshilli i Sigurimit të mblidhej urgjentisht në një seancë për çështjen e pranimit të anëtarëve të rinj.²¹⁷

Në mbledhjen urgjente të Këshillit të Sigurimit, që u mbajt në mbasditen e 14 dhjetorit, përfaqësuesi sovjetik deklaroi se ai do ta tërhiqte votën e tij negative kundrejt shumicës së vendeve, me përjashtim të Japonisë. Ai propozoi që kandidatura e saj, së bashku me atë të RP të Mongolisë, për të cilën Këshilli i Sigurimit nuk

formuloi një rekomandim të favorshëm, të shqyrtoheshin në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme. Delegati sovjetik shfaqti pikëpamjen e delegacionit të vet se midis dy sesioneve mund të arrihej në një marrëveshje të përbashkët për të siguruar pranimin e këtyre dy vendeve në sesionin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme.²¹⁸ Në lidhje me pranimin e 16 vendeve të tjera, delegati sovjetik parashtroi para Këshillit të Sigurimit projektrezolutën, që i rekomandonte Asamblesë së Përgjithshme pranimin e tyre në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.²¹⁹

Me propozimin e kryetarit të Këshillit të Sigurimit mbledhja u shty për gjysmë ore, me qëllim që t'u jepej mundësia anëtarëve të Këshillit të studionin propozimin e rëndësishëm, që atyre iu bë i njohur. Pas rifillimit të seancës, delegati amerikan Llosh propozoi që emri i Japonisë t'i shtohej paragrafit të dytë të projektrezolutës së re të paraqitur nga delegacioni sovjetik.²²⁰ Për amendamentin amerikan votoi kundër delegati sovjetik dhe si rrjedhojë ai nuk u miratua.²²¹

Pas kësaj kryetari i Këshillit të Sigurimit vuri në votë kërkesën e Shqipërisë. Në favor të saj votuan: Brazili, Franca, Irani, Zelande e Re, Peruja, Turqia, Bashkimi Sovjetik dhe Britania e Madhe, abstenuan: Belgjika, klika e Çan Kai Shisë dhe SHBA-ja. Me 8 vota pro, asnjë kundër dhe 3 abstenime kandidatura e Shqipërisë u miratua.²²² Pastaj u miratuan me radhë kandidaturat e 15 shteteve të tjera. Në fund u hodh në votë e gjithë projektrezoluta sovjetike, e cila u miratua me 8 vota dhe 3 abstenime (Belgjika, klika e Çan Kai Shisë dhe SHBA-ja).²²³

Po atë ditë u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Një projektrezolutë e paraqitur nga 41 vende kërkonte pranimin

në OKB të 16 shteteve që kishin fituar rekomandimin e Këshillit të Sigurimit. Me propozim të përfaqësuesit të Kubës, u vendos të votohej veç e veç për çdo kandidaturë. Votimi në Asamble filloi me kandidaturën e Shqipërisë. Në favor të saj votuan 48 delegacione, kundër 3 (Kuba, Greqia dhe klika e Çan Kai Shisë), dhe abstenuan 5 (Republika Domenikane, Holanda, Filipinet, SHBA-ja dhe Belgjika).²²⁴ Të gjitha kandidaturat që u parashtruan në Asamble u miratuan prej saj. Projektrezoluta e 41 vendeve në tërësi u miratua me votat e të gjithë anëtarëve të Asamblesë, me përjashtim të përfaqësuesit të Kubës, i cili abstenoj.²²⁵

Gjatë shpjegimit të votës dhe pas votimit, shumë delegacione shprehën kënaqësinë e tyre për pranimin e 16 vendeve në OKB dhe deklaruan se 14 dhjetori i vitit 1955 do të mbetej si një nga datat më të rëndësishme në analet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Pranimi i 16 vendeve ishte një hap i madh përpara drejt vënies në jetë të parimit të universalitetit të OKB-së, ai forconte autoritetin e saj dhe kontribuonte në zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Më 15 dhjetor 1955 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së përfundoi diskutimet mbi çështjen e pranimi të anëtarëve të rinj. Po këtë ditë Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Dag Hamarskjoldi, i njoftoi Qeverisë së RP të Shqipërisë vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme më 14 dhjetor për pranimin e saj në OKB.²²⁶ Në të njëjtën ditë, në përgjigjen që i ktheu Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Qeveria jonë shprehu kënaqësinë «për këtë vendim të drejtë të Asamblesë së Përgjithshme» dhe theksonte se së shpejti do të bënte të ditur edhe emrin e përfaqësuesit zyrtar të saj në Kombet e Bashkuara.²²⁷ Tri ditë më vonë Qeveria

shqiptare njoftoi për caktimin e delegacionit të saj zyrtar në sesionin e dhjetë të Asamblesë së Përgjithshme.²²⁸

Me rastin e pranimit të Shqipërisë në OKB, Qeveria jonë botoi më 16 dhjetor një deklaratë. Në të thuhej: «Pranimi i Republikës Popullore të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara i jep fund një padrejtësie që zgjati shumë kohë. Në të vërtetë kontributi i popullit tonë në fitoren e përbashkët mbi fashizmin, pra edhe në vetë krijimin e kushteve për formimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe pozita e tij si aleat në Luftën e Dytë Botërore, i jepnin të drejtë vendit tonë që të pranohej që në fillim. Por kjo e drejtë iu mohua deri tani për shkak të pengesave artificiale të nxjerra nga qeveritë amerikane dhe angleze. Është për të ardhur keq që qeveria amerikane edhe në votimin e fundit nuk u shpreh në favor të pranimit të RP të Shqipërisë». Deklarata nënvizonte se Qeveria dhe populli shqiptar kanë qenë kurdoherë të bindur për të drejtën e pamohueshme të Shqipërisë për anëtarësi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, e drejtë që triumfoi në sajë të politikës parimore dhe të vendosur të Partisë dhe të Qeverisë sonë.

Në deklaratë vlerësohej se pranimi i RP të Shqipërisë në OKB ishte një fitore e re për popullin dhe Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë në luftën për paqe e socializëm, në forcimin e pozitës ndërkombëtare të vendit dhe një disfatë tjetër për armiqtë e jashtëm e të brendshëm të popullit shqiptar. Në fund të saj thuhej se Qeveria e RP të Shqipërisë do të respektonte si gjithmonë parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe detyrimet që rridhnin prej saj, do të merrte pjesë aktive në punimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe nuk do të kursente

përpyjekjet e saj përkrah gjithë qeverive të tjera paqedashëse për të realizuar qëllimet e larta të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të ruajtur dhe për të forcuar paqen dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.²²⁹

Delegacioni i RP të Shqipërisë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së nuk arriti të marrë pjesë në sesionin e dhjetë të saj për shkak të vonësës së shkaktuar nga autoritetet amerikane, të cilat shtynë për disa ditë dhënien e vizave. Qeveria amerikane edhe në këto momente shfaqti qëndrimin e saj armiqësor kundër Shqipërisë. Ajo shkeli marrëveshjen ndërkombëtare mbi statusin e përfaqësuesve diplomatikë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara duke i mohuar vizën diplomatike delegacionit shqiptar. Qeveria amerikane donte ta trajtonte përfaqësuesin e vendit tonë si një person pa atdhe, t'i mohonte të drejtat e tij si përfaqësues i ligjshëm i një vendi sovran e të pavarur. Por këto përpjekje dështuan, ashtu siç dështuan ato të mëparshmet për të penguar Shqipërinë të zinte vendin që i takonte si anëtare e OKB. Delegacioni shqiptar, me të mbërritur në Nju-Jork, bëri në OKB në emër të Qeverisë së RP të Shqipërisë një deklaratë. Në të theksohej edhe një herë tjetër se Republika Popullore e Shqipërisë, si anëtare e re e Kombeve të Bashkuara, merrte përsipër zbatimin me përpikmëri të detyrave që përmbaheshin në Kartën e Kombeve të Bashkuara, se Qeveria shqiptare si kurdoherë edhe në të ardhmen do të përkrahte çështjen e paqes dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar me të gjitha vendet, si edhe parimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.²³⁰

Pranimi i RP të Shqipërisë në OKB u prit me kënaqësi nga populli shqiptar. Masat punonjëse të vendit tonë e vlerësuan atë si një fitore tjetër

të politikës së jashtme revolucionare të Partisë dhe të Qeverisë sonë, si forcim të mëtejshëm të pozitave ndërkombëtare të Shqipërisë dhe si një dështim tjetër të veprimtarisë armiqësore anti-shqiptare të SHBA-së e fuqive të tjera imperia-liste. «Kjo ngjarje, — theksonte në atë kohë shoku Enver Hoxha, — ka një rëndësi të madhe, sepse vendi ynë ka luftuar dhe ka derdhur gjak për lirinë, pavarësinë e sovranitetin; ai i ka mbrojtur me të gjitha forcat e tij parimet dhe Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara edhe pa qenë anëtar i saj... Me pranimin e Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, armiqve të popullit tonë iu dogj edhe një kartë, që e përdornin për pretendimet e tyre të mbrapshta dhe shpifëse».*

*

*

*

Qëkurse u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara Shqipëria ka ushtruar aty një veprimtari aktive në përputhje të plotë me politikën e saj të jashtme dhe me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. RPS e Shqipërisë ka luftuar me të gjitha forcat që kjo organizatë të veprojë brenda qëllimeve dhe parimeve që janë fiksuar në Kartë, si faktor i rëndësishëm për krijimin e kushteve më të mira ndërkombëtare në favor të çështjes së lirisë, të paqes dhe të sigurimit botëror. Por, duke qenë anëtare e OKB-së, Shqipëria socialiste nuk ka ushqyer iluzione se kjo organizatë do të ishte e aftë të përmbushte ato detyra që ajo mori për-

* Enver Hoxha, Vepra, vëll. 13, f. 295.

sipër me krijimin e saj. Dhe kjo për të vetmen arsye se OKB-ja, që kur u krijua, u manipulua nga SHBA-ja, se ajo, në vend që t'u vinte në ndihmë viktimave të agresionit, e ka përlyer flämurin e saj në agresione e ndërhyrje të palejueshme kundër popujve e vendeve sovrane. Qeveria shqiptare, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, ka demaskuar përpjekjet dhe synimet imperialiste të SHBA-së për ta përdorur OKB-në «si një instrument në favor të politikës së tyre grabitqare, të shtypjes e të agresionit kundër popujve e vendeve liridashëse.»²³¹

Politika e ndjekur nga vendi ynë në OKB ka synuar gjithnjë që të pengojë dhunimin e dispozitave themelore të Kartës, marrjen nëpër këmbë të interesave të popujve e të vendeve të vogla nga SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik dhe fuqitë e tjera të mëdha imperialiste. Qeveria jonë vazhdimisht u ka tërhequr vëmendjen anëtarëve të tjerë të OKB-së se «Organizata jonë duket e paralizuar dhe e goditur në vetë themelet saj», se ajo «ndodhet tani në një rrugë pa krye».²³² se politika e dy superfuqive, e SHBA-së dhe e Bashkimit Sovjetik, «ka goditur rëndë autoritetin dhe aftësinë e saj për t'iu përgjigjur rolit që i takon në bazë të Kartës».²³³

Të dy superfuqitë përpiqen që të zgjerojnë klientelat e tyre në OKB. Aktualisht SHBA-ja e Bashkimi Sovjetik e përdorin këtë organizatë si tribunë të oratorisë «paqësore», për të maskuar politikën e tyre të hegjemonisë, të ekspansionit e të përgatitjeve për një luftë tjetër botërore.

Në çdo sesion të saj Uashingtoni dhe Moska kanë paraqitur propozime për paqen e sigurimin për marrëdhënie të drejta ndërkombëtare, për respektimin e sovranitetit, të lirisë e të pavarësisë së popujve e të shteteve të ndryshme, për shkëmbime të barabarta ekonomike, për «ndihmat» që u du-

hen dhënë vendeve të prapambetura të Azisë, Afrikës e të Amerikës Latine etj. RPS e Shqipërisë hapur e me fakte ka zbuluar e demaskuar falsitetin e politikës së SHBA e të Bashkimit Sovjetik, synimet e saj reale që janë në kundërshtim me interesat e paqes e të sigurimit të vërtetë, të lirisë, pavarësisë së popujve, të përparimit shoqëror të tyre.

Qëndrimi parimor dhe i vendosur i Shqipërisë në mbrojtje të dispozitave të Kartës, të autoritetit dhe të ekzistencës së OKB-së, ka fituar përkrahjen dhe mbështetjen e shumë vendeve e qeverive të ndryshme të botës, që nuk duan të bëhen lodra në duart e fuqive imperialiste. Politika e drejtë, e hapët dhe revolucionare e Qeverisë sonë në OKB ka pasur gjithnjë një jehonë të gjerë ndërkombëtare. Nëpërmjet tribunës së OKB Qeveria jonë ka bërë të njohur politikën e saj revolucionare për ruajtjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar. Ajo ka demaskuar propozimet dhe parullat demagogjike imperialiste e socialimperialiste për «uljen e tensionit», për «paqen», «vendosjen e harmonisë e të mirëkuptimit», të cilat SHBA-ja, Bashkimi Sovjetik, Kina e fuqitë e tjera imperialiste i propagandojnë si veprime në shërbim të paqes e të sigurimit të popujve. Në OKB e jashtë saj Qeveria jonë ka shprehur me kohë pikëpamjen e saj se ulja e tensionit dhe siguri i vërtetë i paqes në Evropë apo në botë «nuk mund të arrihen me iluzionet dhe shpërsat e bazuara në premtimet e imperialistëve dhe të socialimperialistëve, por duke demaskuar e penguar manovrat e tyre diplomatike mashtruese».²³⁴

RPS e Shqipërisë kurrë nuk është bashkuar me ato fuqi, qeveri e vende që u hedhin lule e u thurin lëvdata dy superfuqive, që rrojnë nën hi-

jen e tyre e zbukurojnë realitetin. Qeveria jonë në mënyrë realiste ka tërhequr vëmendjen e popujve e të vendeve paqedashëse për gjendjen e rëndë dhe të ndërlikuar në të cilën ndodhet sot bota, për kërcënimet dhe rreziqet që kanosin lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tyre. Nga tribuna e OKB-së Shqipëria ka paralajmëruar se «situata politike ndërkombëtare, që vazhdon të keqësohet dhe të ngarkohet me konflikte të reja, objektivisht është rezultat i intensifikimit të kursit militarist e agresiv të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, i rivalitetit të tyre për sundim e hegjemoni».²³⁵

